VEPRIMTARIA E INSTITUCIONIT TË PREFEKTIT TË QARKUT GJIROKASTËR

2017 - 2018

JANAR 2019

Parimet e organizimit dhe funksionimit të Institucionit të Prefektit bazohen në Kushtetutën e Republi ligjin nr. 107/201 *rkut*", në legjislac i dhe në akte ligj Këshillit të Ministrave, të cilat ndihmojnë në veprimtarinë e tij mbikqyrëse, kontrolluese dhe bashkërenduese në veprimtarinë e degëve territoriale e institucioneve të tjera shtetërore si dhe veprimtarinë e tyre me organet e njësive të Vetëqeverisjes Vendore, duke pasqyruar parimet themelore të qeverisjes vendore. Prefekti i Qarkut Gjirokastër në mbështetje të misionit

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT GJIROKASTËR

VEPRIMTARIA E INSTITUCIONIT TË PREFEKTIT TË QARKUT GJIROKASTËR

2017 - 2018

Janar 2019

INSTITUCIONI I PREFEKTIT TË QARKUT GJIROKASTËR

Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastër është organi përfaqësues i Këshillit të Ministrave në njësinë administrativo-territoriale Qarku Gjirokastër, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 115/2014 *"Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të Vetëqeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë"*.

Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastër, me seli në qytetin Gjirokastër është krijuar në bazë të *VKM nr.373, datë 26.03.1993* dhe funksionon në përputhje me ligjin nr. 107/2016 *"Për Prefektin e Qarkut"*.

Në Prefekturën e qarkut Gjirokastër përfshihen shtatë bashki: Bashkia Gjirokastër, Bashkia Dropull, Bashkia Libohovë, Bashkia Tepelenë, Bashkia Memaliaj, Bashkia Përmet dhe Bashkia Këlcyrë.

Brenda juridiksionit të institucionit të Prefektit të Qarkut Gjirokastër funksionojnë shtatë bashki, si niveli i parë i Vetëqeverisjes Vendore dhe Këshilli i Qarkut si niveli i dytë i Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.

Parimet e organizimit dhe funksionimit të Institucionit të Prefektit bazohen në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 107/2016 "*Për Prefektin e Qarkut*", në legjislacionin shqiptar në fuqi dhe në akte ligjore dhe nënligjore të Këshillit të Ministrave, të cilat ndihmojnë në veprimtarinë e tij mbikqyrëse, kontrolluese dhe bashkërenduese në veprimtarinë e degëve territoriale e institucioneve të tjera shtetërore si dhe veprimtarinë e tyre me organet e njësive të Vetëqeverisjes Vendore, duke pasqyruar parimet themelore të qeverisjes vendore.

Prefekti i Qarkut Gjirokastër në mbështetje të misionit dhe rolit që ka në rajon, ka si objekt pune verifikimin administrativo-ligjor të akteve të organeve të Vetëqeverisjes Vendore, kontrollin ligjor, monitorimin dhe bashkërendimin e veprimtarisë së degëve territoriale, institucioneve shtetërore në nivel vendor, midis tyre edhe me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore të rajonit si dhe përgjigjet para Këshillit të Ministrave për detyrat që i janë ngarkuar dhe për zbatimin e politikës qeveritare në qarkun e Gjirokastrës.

Në institucionin e Prefektit të qarkut, për ushtrimin e funksioneve dhe plotësimin e përgjegjësive e të detyrave, Prefekti ka aparatin e tij administrativ.

Struktura dhe numri organik i punonjësve të institucionit të Prefektit të Qarkut Gjirokastër, miratohet me Urdhër të Kryeministrit "*Për miratimin e strukturës dhe organikës së administratës së Prefektit të Qarkut Gjirokastër"*.

ORGANIKA E ADMINISTRATËS SË PREFEKTIT TË QARKUT GJIROKASTËR

I. **PREFEKTI**

II. **SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

III. **NËNPREFEKTI (2)**

IV. **SEKTORI JURIDIK**

V. **SEKTORI I MONITORIMIT TË KOMPETENCAVE VENDORE DHE FUNKSIONEVE TË DELEGUARA**

VI. **SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN**

VII. **SEKTORI I PLANIFIKIMIT, PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE**

VIII. **SEKTORI I FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**



Fig. 1. Struktura e Institucionit të Prefektit të Qarkut Gjirokastër

Bazuar në VKM-në nr. 1269, datë 17.09.2008 "*Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore*" i ndryshuar, në varësi të Prefektit të qarkut Gjirokastër deri më 31 dhjetor 2018 ka funksionuar Drejtoria e Verifikimit të Titujve të Pronësisë. Kjo drejtori rregullonte veprimtarinë e saj bazuar në VKM-në nr. 1269, datë 17.09.2008, të ndyshuar dhe i përgjigjej rregullores së brendshme të institucionit të Prefektit.

ADMINISTRATA E INSTITUCIONIT TË PREFEKTIT TË QARKUT GJIROKASTËR

PREFEKT
Z. ASTRIT ALIAJ

SEKRETAR
ZNJ. ROMINA HASKA

NËNPREFEKT
Z. AVNI LALA

NËNPREFEKT
Z. ANASTAS NAQE

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
Z. ARIAN KORKUTI

SEKTORI JURIDIK

PËRGJEGJËS SEKTORI
ZNJ. SILVANA SHEHU

SPECIALIST JURIST
Z. EDMOND GJOKA

SEKTORI I MONITORIMIT TË KOMPETENCAVE VENDORE DHE FUNKSIONEVE TË DELEGUARA

PËRGJEGJËS SEKTORI
Z. ERION XHAXHIU

SPECIALIST PËR KOORDINIM ZHVILLIMIN
ZNJ. ARJETA PAÇELI

SPECIALIST PËR SHËRBIMET PUBLIKE
Z. GENTIAN KOTONI

SPECIALIST PËR SIGURINË PUBLIKE DHE SHËRBIMIN ZJARRFIKËS
ZNJ. NERTILA MENI

SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

PËRGJEGJËS SEKTORI
Z. JORGJI THANO

SPECIALIST PËR TERRITORIN DHE INFRASTRUKTURËN
Z. VASIL SHUNDRI

SPECIALIST PËR MBROJTJEN E MJEDISIT
ZNJ. EDLIRA SHEHU

SEKTORI I PLANIFIKIMIT, PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE

PËRGJEGJËS SEKTORI
Z. THOMA KOTE

SPECIALIST I EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE
Z. MUHARREM GUÇE

SPECIALIST I EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE
Z. FADIL GUCI

SEKTORI I FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

PËRGJEGJËS SEKTORI
Z. KLODIAN KORE

SPECIALIST FINANCE
Z. NIKOLLA KONOMI



SPECIALIST PËR BURIMET NJERËZORE DHE MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN
ZNJ. VASILIKA PAPA

SPECIALIST ARKIVË-PROTOKOLL
ZNJ. EVIOLA LAPA

SHOFER
Z. LEFTER TARE

SANITARE
ZNJ. NEZAQET KOÇI

KOMISIONI VENDOR I VLERËSIMIT TË TITUJVE TË PRONËSISË

DREJTOR
Z. MELEQ KARABINA

SPECIALIST JURIST
Z. LEDION QËNDRO

TEKNIK TOPOGRAF
Z. SHEFQET ALIKAJ

ZYRAT E GJENDJES CIVILE

SPECIALIST I GJENDJES CIVILE GJIROKASTËR
ZNJ. PAVLINA KORBECI

SPECIALIST I GJENDJES CIVILE TEPELENË
Z. LAERT RAMA

SPECIALIST I GJENDJES CIVILE PËRMET
ZNJ. PRANVERA LAPAJ

AKTIVITETET E INSTITUCIONIT TË PREFEKTIT TË QARKUT GJIROKASTËR

04.11.2017

Është prezantuar në Gjirokastër Prefekti i ri i qarkut, z. Astrit Aliaj në ceremoninë e organizuar në institucionin e Prefektit të qarkut Gjirokastër, me praninë e dy ministrave znj. Mirela Kumbaro dhe z. Pandeli Majko ku ish-Prefekti z. Flamur Bime, i ka dorëzuar detyrën Prefektit të ri të qarkut z. Astrit Aliaj.

15.11.2017

Takimi i Komisionit të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave për Qarkun Gjirokastër, me qëllim koordinimin e punës për të monitoruar, reaguar dhe përballuar në kohë dhe me kosto sa më të ulët, situatat emergjente që mund të paraqiten në të gjithë territorin e qarkut. Prefekti i qarkut z. Astrit Aliaj kërkoi vlerësim dhe angazhim maksimal nga të gjitha institucionet pjesëmarrëse si gjatë planizimit të masave, ashtu edhe gjatë reagimit në çdo situatë për parandalimin, shmangien dhe minimizimin e dëmeve nga situatat e mundshme emergjente që mund të krijohen.

16.11.2017

Prefekti i qarkut z. Astrit Aliaj ka inspektuar mjediset e punës të Drejtorisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi si dhe të Detashmentit të Mbështetjes Rajonale për t'u njohur nga afër me gadishmërinë e burimeve njerëzore dhe mjeteve që ato kanë në dispozicion për përballimin e situatave emergjente në të gjithë territorin e qarkut Gjirokastër.

17.11.2017

Ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka në një takim me 12 prefektët e sapoemëruar në vend, kërkoi një planifikim të qartë masash për parandalimin dhe për menaxhimin e Emergjencave Civile. Ministrja e Mbrojtjes kërkoi nga prefektët veprim të shpejtë dhe të zhdërvjellët sipas pikave të një plani të qartë veprimi, të konceptuar si një Protokoll Tip Veprimesh në situata të jashtëzakonshme. Sipas ligjit "Për emergjencat civile" dhe akteve nënligjore përkatëse në dhe për zbatim të tij, Komisioni i Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile, ka si kryetar prefektin e qarkut. Ndërkohë, Zyra Qendrore e Emergjencave Civile, është parashikuar të funksionojë këtej e tutje si strukturë e Ministrisë së Mbrojtjes.

19.11.2017

Për shmangien e situatave të rrezikshme nga mundësia e rrëshkitjes së një masivi të madh shkëmbi mbi qytetin e Përmetit, me kërkesë të Prefektit të qarkut Gjirokastër, specialistë xhenierë të Ministrisë së Mbrojtjes kane marre te gjithat masat duke ndërhyrë në zonë për të evituar rrezikshmërinë e këtij shkëmbi masiv.

24.11.2017

Prefekti i qarkut z. Astrit Aliaj gjatë takimit që u organizua në Tiranë me të gjithë prefektët e qarqeve për të diskutuar në lidhje me çështje të rëndësishme të aktualitetit si dhënia e shërbimeve për qytetarët në shëndetësi, arsim, mbështetje sociale si dhe për marrjen e masave paraprake nga ana e institucioneve shtetërore në nivel vendor e njësive të vetëqeverisjes vendore për shmangien e situatave emergjente gjatë dhe pas stinës së dimrit.

25.11.2017

Në institucionin e Prefektit të qarkut Gjirokastër është zhvilluar takimi me drejtues të Autoritetit Rrugor Jugor, Sektorit të Policisë Rrugore në Drejtorinë Vendore të Policisë Gjirokastër dhe përfaqësues të firmave kontraktore të mirëmbajtjes së rrugëve nacionale dhe rurale të qarkut Gjirokastër. Prefekti i qarkut kërkoi nga të dyja palët angazhimin maksimal

në marrjen e masave paraprake për sigurimin e të gjitha materialeve të nevojshme në mënyrë që të gjitha rrugët gjatë stinës së dimrit të jenë në gjëndje dhe të mos bëhen pengesë për qarkullimin e lirë dhe pa probleme për të gjithë përdoruesit e rrugëve. Në mënyrë të veçantë Prefekti kërkoi sigurimin e kripës, skojeve dhe pajisjen në vazhdimësi me sinjalistikën e nevojshme vertikale dhe horizontale për ta bërë lëvizjen e qytetarëve sa më të sigurtë.

26.11.2017

Prefekti i qarkut z. Astrit Aliaj i ftuar në parkun e Antigonesë vizitoi nga afër ambientet e parkut, një pasuri e çmuar e trashëgimisë tonë kulturore. Ekspozitë nga gërmimet dhe zbulimet, vizitë në ambjentet e parkut dhe një koncert nga ansambli Antigonea ishin disa nga veprimtaritë që shoqëruan këtë ditë. Z. Astrit Aliaj vlerësoi punën e bërë deri tani në këtë destinacion turistik të trashëgimisë tonë kulturore, por njëkohësisht inkurajoi të gjitha institucionet për detyrimin që ne të gjithë kemi për evidentimin, zbulimin, ruajtjen dhe promovimin e këtyre vlerave të trashëgimisë kulturore.

28.11.2017

Dita e themelimit të Shtetit Shqiptar!
Prefekti i qarkut z. Astrit Aliaj me rastin e 105 vjetorit të shpalljes se Pavarësisë vendos kurorë tek busti i Çerçiz Topullit. Në këtë event Prefekti i qarkut uroi të gjithë banorët e qarkut Gjirokastër kremtimin e ditës së flamurit.

29.11.2017

Dita e Çlirimit të Atdheut!
Urimi i parë sot është për 29 Nëntorin, në këtë datë të shënuar për të gjithë shqiptarët. Prefekti i qarkut z. Astrit Aliaj vlerësoi këtë ditë si ditën e përvjetorit të çlirimit dhe të fitores së Aleancës së shqiptarëve me antifashizmin.

30.11.2017

Nisur nga parashikimi i Institutit të Gjeoshkencës, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit për situatën e rreshjeve në të gjithë territorin e Shqipërisë dhe veçanërisht në territorin e Qarkut Gjirokastër, Prefekti i qarkut z. Aliaj thirri mbledhjen e jashtëzakonshme të Komisionit të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave për Qarkun Gjirokastër. Në këtë takim Prefekti kërkoi nga të gjitha institucionet pjesëmarrëse në këtë komision por gjithashtu edhe nga të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore të qarkut Gjirokastër, raportimin dhe dhënien e informacionit në kohë reale, bashkëpunimin ndërinstitucional si dhe gatishmërinë e burimeve njerëzore e të mjeteve në dispozicion. Gjithashtu drejtuesit e njësive të vetëqeverisjes vendore pjesëmarrëse në këtë takim, raportuan mbi masat e marra dhe gatishmërinë e strukturave të tyre për përballimin e situatave të pritshme në territorin nën juridiksionin e tyre.

02.12.2017

Në Institucionin e Prefektit të Qarkut Gjirokastër është mbledhur Komisioni i Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave për qarkun Gjirokastër ku kanë qënë të pranishëm edhe deputetët e këtij qarku, ministrja Mirela Kumbaro dhe deputeti

Flamur Golemi. Në këtë mbledhje të jashtëzakonshme është raportuar dhe analizuar situata problematike e krijuar për qarkun e Gjirokastrës, për të garantuar masat që do të merren për orët dhe ditët në vazhdim. Qëllimi kryesor është koordinimi i punëve ndërinstitucionale për të bërë të mundur ndërhyrjet në terren për rregullimin e dëmeve të shkaktuara nga rreshjet intesive të ditëve të fundit.

02.12.2017

Prefekti i qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj ka ndjekur nga afër punimet për zhbllokimin e urës pranë varrezave publike në rrugën nacionale Gjirokastër - Kakavie. Puna me intensitet të plotë me tre skrepave dhe një eskavator për zhbllokimin dhe normalizimin e qarkullimit në këtë zonë të prekur nga përmbytjet.

04.12.2017

Dita e ngritjes së flamurit në Gjirokastër! Prefekti i qarkut z. Astrit Aliaj, me rastin e 105-vjetorit të ngritjes së flamurit në kalanë e qytetit të Gjirokastrës, ka marr pjesë në ceremoninë e organizuar për kremtimin e kësaj dite historike duke ngritur në mënyrë simbolike flamurin kombëtar, në prezencën e autoriteteve të tjera lokale dhe nëpunësve civilë. Nderime janë kryer edhe pranë bustit të patriotit Hasan Xhiku, i cili 105 vjet më parë së bashku me patriotë të tjerë gjirokastritë, hoqi flamurin turk nga kalaja dhe valëviti flamurin tonë kombëtar në shenjë lirie dhe pavarësie.

04.12.2017

Në kuadër të një takimi sensibilizues për "Ditën ndërkombëtare të personave me aftësi të kufizuara", Prefekti i qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj ka vizituar ambientet e "Qendrës së trajtimit të fëmijëve me autizëm" për të parë nga afër funksionimin e kësaj qëndre dhe për t'u takuar me drejtuesit dhe 40 fëmijët që marrin kujdes të specializuar që prej vitit 2013 kur dhe është çelur për herë të parë.

Duke premtuar mbështetje dhe kujdes të veçantë në vazhdimësi në emër të institucionit që ai drejton, Prefekti përgëzoi propozimin e Bashkisë Gjirokastër dhe Këshillit të Qarkut për të mbështetur financiarisht ambiente të reja për funksionimin e kësaj qëndre në kuadër të përmirësimit të shërbimeve dhe nevojave speciale që këto fëmijë kanë.

05.12.2017

Në institucionin e Prefektit të Qarkut Gjirokastër është mbledhur Komisioni i Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave. Prefekti i qarkut z. Astrit Aliaj paraqiti një briefing të gjendjes aktuale në të gjithë territorin e qarkut si dhe rekomandoi detyra konkrete në evidentimin dhe vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga rreshjet e shiut për të gjitha njësitë vendore dhe institucionet shtetërore që operojnë në qarkun Gjirokastër.

06.12.2017

Prefekti i qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj ka vizituar familjet e prekura nga përmbytjet për të dëgjuar nevojat e tyre dhe për të kontribuar me ndihma ekonomike në minimizimin sadopak të këtyre dëmeve. Me anë të mobilizimit të Forcave të Detashmentit të Mbrojtjes është bërë e mundur ndërhyrja për pastrimin dhe lehtësimin e dëmeve në një prej familjeve, shtëpia e së cilës ishte e bllokuar nga balta. Ndërhyrje emergjente do të realizohet në të dy pritat e përroit të Ficos dhe atij të Çullos për pastrimin e shtratit duke filluar nga dita e nesërme nga ana e Bashkisë Gjirokastër. Vizita përmbyllëse është bërë pranë ambienteve të Spitalit Rajonal "Omer Nishani" për të parë nga afër gatishmërinë e këtij institucioni në përballimin e emergjencave si ato që u përjetuan javën e kaluar.

08.12.2017

Me kerkesë të Prefektit të qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj drejtuar Drejtorisë Rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit në Tiranë, janë shpërndarë ndihma sipas nevojave në bashkitë e qarkut Gjirokastër për të gjitha familjet e prekura nga përmbytjet.

12.12.2017

Prefekti i qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj organizoi takimin e një tryeze në qytetin e Tepelenës, nisur nga situata e gjëndjes aktuale të rrugëve nacionale në qarkun e Gjirokastrës, pas problematikave të shkaktuara nga rënia intesive e rreshjeve të shiut. Në këtë takim pune morën pjesë përfaqësues të Autoritetit Rrugor Jugor, Supervizorë të Bankës Botërore, përfaqësues të firmës kontraktore konçesionare si dhe drejtuesit kryesorë të Bashkive Tepelenë dhe Memaliaj. Për periudhën në vazhdim Prefekti i Qarkut kërkoi raportimin mbi masat e marra dhe hartimin e planit të masave veçanërisht për pikat e dobëta të akseve nacionale në këtë qark, për të përballuar çdo situatë emergjente që mund të krijohet gjatë dimrit nga rënia e rreshjeve të shiut, dëborës apo ngricave. Në mbyllje të takimit,

Prefekti kërkoi bashkëpunimin e drejtuesve të firmës kontraktore dhe bashkëveprimin me drejtuesit e njësive vendore dhe institucioneve shtetërore në nivel vendor.

13.12.2017

Falë donacionit të "Elkos Group" dhe me ndihmën e mjeteve të Forcave të Detashmentit të Mbrojtjes Rajonale në Gjirokastër, nën mbikqyrjen e stafit të Prefekturës Gjirokastër është realizuar shpërndarja e ndihmave me ushqime për banorët e prekur nga dëmtimet e përmbytjeve në Bashkinë Dropull dhe Libohovë të Qarkut Gjirokastër.

15.12.2017

Një staf i specializuar mjekësh kanë qënë të pranishëm ditën e sotme në Gjirokastër për të kryer vizita mjekësore falas për të gjithë qytetarët. Me iniciativë të Ministrisë së Mbrojtjes në kuadër të emergjencave civile, mjekët në uniformë i kanë nisur vizitat në bashkinë Libohovë për të vijuar përgjatë një jave, duke nisur nga dita e hënë, në të gjitha bashkitë e Qarkut Gjirokastër.

19.12.2017

Prefekti i Qarkut z. Astrit Aliaj mori pjesë në takimin e organizuar në Këshillin e Qarkut për pritjen e znj. Claudia Hinzer, Oficere Politike dhe Ekonomike, përfaqësuese e Ambasadës Kanadaze në Romë. Duke e falenderuar në kuadër të ndihmave humanitare të ofruara nga qeveria kanadeze për familjet e prekura nga përmbytjet, z. Astrit Aliaj premtoi bashkëpunime të tjera të frytshme të ketij lloji në ndihmë të komunitetit.

19.12.2017

Falë interesimit të veçantë të Prefektit të qarkut Gjirokastër në cilësinë e Kryetarit të Shtabit të Emergjencave Civile, mbështetjes dhe angazhimit të forcave xhenjere të Ministrisë së Mbrojtjes u bë realitet ndërtimi i urës BEJL në Njësinë Administrative të Dropullit të Sipërm bashkia Dropull, urë kjo që bën të mundur komunikimin e tetë fshatrave të kësaj njësie.

21.12.2017

Prefekti i qarkut z. Astrit Aliaj zhvilloi takimin me përfaqësuesit e subjekteve kontraktore që janë përgjegjëse për mirëmbajtjen e rrugëve nacionale të qarkut Gjirokastër. Në këtë takim firmat kontraktore raportuan për masat e marra për përballimin e situatave emergjente që mund të krijohen gjatë periudhës së dimrit. Në përfundim të takimit Prefekti ju kërkoi subjekteve kontraktore të marrin të gjitha masat për sigurimin e bazës materiale të mirëmbajtjes dimërore (kripë, skorje, granil), gatishmërinë e makinerive borëpastruese dhe që fuqia punëtore të jetë e specializuar dhe e përhershme në mirëmbajtjen e rrugëve nacionale dhe atyre dytësore.

21.12.2017

Në prani të personelit drejtues të shërbimit spitalor është prezantuar drejtori i Spitalit Rajonal Gjirokastër mjekut kirurg z. Roland Karalli nga Prefekti i qarkut z. Astrit Aliaj.

21.12.2017

Në takimin e organizuar midis përfaqësueses të Shoqatës së Invalidëve Para dhe Tetraplegjikë Gjirokastër mjekes rheumatologe Vjollca Koko dhe Prefektit të qarkut Gjirokastër është diskutuar për problematikat e trotuarëve dhe rrugëve për personat me aftësi të kufizuara. Prefekti i qarkut ka shprehur

mbështetjen e Institucionit që ai drejton dhe gatishmërinë për të qënë sa më afër nevojave të p.a.k.

22.12.2017

Prefekti i qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj ka pritur në zyrën e tij deputetin e qarkut z. Bledi Çuçi, ku sëbashku me të dhe me zëvëndësministren për Europën dhe Punët e Jashtme shkuan për të vizituar urën Bejl në njësinë administrative të Dropullit të Sipërm në bashkinë Dropull. Kjo urë, e rindërtuar nga ushtria menjëherë pasi u shkatërrua nga shirat e disa javëve më parë, bën të mundur komunikimin e tetë fshatrave të kësaj njësie.

27.12.2017

Në institucionin e Prefektit të Qarkut Gjirokastër u zhvillua një takim analizë për situatën emergjente në qarkun Gjirokastër. Midis të gjitha problemeve të trajtuara, një rëndësi të veçantë iu kushtua çështjes së kompletimit, trajtimit dhe dëmshpërblimit të banorëve të prekur nga përmbytjet në qarkun Gjirokastër.

29.12.2017

Në Shtëpinë e të Moshuarve Gjirokastër me prezencën e Ministres së Kulturës, njëkohësisht edhe deputete e qarkut Gjirokastër znj. Mirela Kumbaro dhe deputetit të qarkut z. Flamur Golemi, Prefekti iu uroi të gjithë banorëve të kësaj strehe festa të gëzuara, vit të mbarë, shëndet dhe jetë të gjatë. Me këtë rast u shpërndanë edhe pako me veshmbathje për të gjitha moshat mundësuar nga Rezervat e Shtetit.

30.12.2017

Falë interesimit të veçantë të Prefektit të qarkut në cilësinë e kryetarit të Shtabit të Emergjencave Civile, mbështetjes dhe angazhimit të forcave xheniere të Ministrisë së Mbrojtjes u bë realitet ndërtimi i urës BEJL në Njësinë Administrative të Dropullit të Sipërm bashkia Dropull. Me pjesëmarrjen e Ministres së Mbrojtjes znj. Xhaçka dhe deputetëve të qarkut Gjirokastër është bërë perurimi i kësaj ure, e cila bën të mundur komunikimin e tetë fshatrave.

04.01.2018

Në takimin e Prefektit të qarkut Gjirokastër me Rektorin e Universitetit "Eqrem Çabej" z.Bektash Mema u diskutua për problematikat që shoqërojnë këtë institucion dhe për zgjidhjet e mundshme që lehtësojnë zhvillimin e programit mësimor.

04.01.2018

Në institucionin e Prefektit të qarkut është zhvilluar takimi me drejtuesit e degëve territoriale dhe institucioneve vendore për ecurinë e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe për përcaktimin e objektivave për vitin 2018.

08.01.2018

Në Institucionin e Prefektit të Qarkut Gjirokastër është zhvilluar takimi i punës me përfaqësues të Qëndrës Koordinuese kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe përfaqësues të DAR/ZA të Qarkut Gjirokastër në kuadër të projektit "Me shkollat për Komunitete më të sigurta" i cili ndodhet në fazën e fundit të kaskadës së trajnimeve të të gjitha shkollave dhe mësuesve të ciklit para-universitar në rang Shqipërie. Prefekti i qarkut z. Astrit Aliaj ka shprehur mbështetjen e Institucionit që ai drejton për kontributin e rëndesishëm të këtij projekti mbarëkombëtar në mënyrë që fëmijët shqiptar të mos bien pre e sjelljeve antishoqërore, radikale dhe ekstremiste në shkolla.

09.01.2018

Në kuadër të bashkëpunimit Institucional, Prefekti i Qarkut Gjirokastër zhvilloi një takim pune me pjesëmarrjen e drejtuesve të Zyrave Vendore të Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të Qarkut Gjirokastër për t'u njohur me problematikat, shqetësimet dhe rezultatet e punës të këtyre zyrave. Prefekti i qarkut kërkoi nga ana e drejtuesve të këtyre zyrave bashkëveprimin ndërinstitucional, rritjen e kërkesës së llogarisë ndaj punonjësve të administratës së tyre për të bërë të mundur zgjidhjen e të gjitha problematikave që kanë qytetarët me pronat, respektimin e afateve të kthimit të përgjigjeve të shkresave zyrtare si dhe organizimin e punës në grup në institucionet ku ata veprojnë.

10.01.2018

Në Institucionin e Prefektit të Qarkut Gjirokastër është zhvilluar mbledhja me Kryetaren dhe stafin e specialistëve të fushës të Bashkisë Gjirokastër për të diskutuar për masat dhe rekomandimet sipas studimit mbi kushtet gjeologo-inxhinierike të rrëshqitje-shembjes në lagjen "Punëtori" dhe lagjen "Cfakë" të qytetit të Gjirokastrës.

01.01.2018

Është zhvilluar takimi i punës me drejtuesit qëndrorë dhe lokalë të Rrethit Tepelenë në Institucionin e Nënprefektit Tepelenë për analizimin e problematikave dhe ecurisë së punës përgjatë vitit 2017. Prefekti i qarkut z. Astrit Aliaj ndër të tjera theksoi rritjen e përgjegjësisë së drejtuesve për realizimin e detyrave për vitin 2018; reforma e ujit të jetë prioritet në zbatim të vendimit të Qeverisë; mbarëvajtjen e strukturës së shkollave, verifikimin e godinave dhe sigurisë së tyre si dhe ti kushtohet rëndësi e veçantë përballimit në kohë dhe me sukses të emergjencave që mund të krijohen në vazhdim. Në kuadër të këtij takimi Prefekti vizitoi ambjentet e Repartit Zjarrfikës në Tepelenë, Drejtorinë e Policisë dhe Gjimnazin "Abaz Fejzo".

13.01.2018

Me rastin e 105-Vjetorit të Policisë së Shtetit, Prefekti i qarkut ka uruar uniformat e Policisë së Shtetit dhe familjet e tyre që të jenë krenarë për punën që ata kryejnë. Shembulli i tyre dhe sidomos i atyre që kanë rënë në krye të detyrës do të mbeten burim frymëzimi për të gjithë ne dhe për të gjithë ata që shërbejnë nën uniformën e policisë.

16.01.2018

Prefekti i Qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj është takuar me Konsullin e Përgjithshëm grek në Gjirokastër z. Vasileios Tolios, për të diskutuar mbi gërmimet që do të kryhen në fshatin Dragot të rrethit Tepelenë.

Në zbatim të marrëveshjes dypalëshe midis Qeverisë Shqiptare dhe asaj Greke "Për kërkimin, zhvarrimin, identifikimin dhe varrimin e ushtarëve grekë të rënë në luftën Greko-Italiane të viteve 1940-1941", Prefekti theksoi se nga pala shqiptare janë marrë të gjitha masat që ky proces të kryhet konform ligjit dhe rregullave të përcaktuara.

Në takim ishin prezent edhe Atasheu Ushtarak grek në Tiranë z. Baqirtzis, Majori në rezervë z. Qirgos, përfaqësues të Ministrisë së Brendshme dhe përfaqësues të Bashkisë Tepelenë.

18.01.2018

Në institucionin e Prefektit të Qarkut Gjirokastër u zhvillua takimi informues nga Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Çështje të Luftës kundër Trafikimit të Personave në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare për Migracionin (IOM), me anëtarët e Tryezës Teknike të Qarkut Gjirokastër në zbatim të projektit "Mbi parandalimin e migracionit të parregullt". Qëllimi i këtij takimi ishte sensibilizimi dhe ndërgjegjësimi lidhur me parandalimin e migracionit të parregullt drejt Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian me sloganin "Zgjidhni mundësitë, jo migracionin e parregullt!"

18.01.2018

Prefekti i qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj ka marr pjesë në takimin e punës me drejtuesit qëndrorë dhe lokalë të Rrethit Përmet në Institucionin e Nënprefektit Përmet për analizimin e problematikave dhe ecurisë së punës për vitin 2017.

23.01.2018

Në Institucionin e Prefektit të Qarkut Gjirokastër u zhvillua takimi me përfaqësuesit e strukturave qëndrore në nivel qarku për të diskutuar për reformën në sektorin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura si edhe zhvillimi i fazës së parë të vlerësimit të problematikave në lidhje me venddepozitimet e mbetjeve për qarkun tonë. Thelbi i diskutimeve ishte ngritja e grupeve të punës me specialistë të fushave të ndryshme për kontrolle dhe monitorime në terren, pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Gjirokastër.

25.01.2018

Prefekti i Qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj bashkë me Ministren e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale znj. Ogerta Manastirliu dhe deputeten e qarkut Gjirokastër znj. Mirela Kumbaro kanë vizituar Spitalin Rajonal të Gjirokastrës ku panë nga afër ambjentet e shërbimeve shëndetësore të specializuara, në të cilat u kryen vizita nga një ekip mjekësh të spitaleve universitare të Tiranës. Në takimin me mjekët e spitalit rajonal të Gjirokastrës ju garantua mbështetje maksimale dhe fuqizim të spitalit me aparatura të reja të cilat do të rritin cilësinë e shërbimit ndaj të sëmurëve.

26.01.2018

Gjatë analizës vjetore të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Gjirokastër për vitin 2017, me pjesëmarrjen e Prefektit të Qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj, si dhe faktorëve të punësimit në rajonin tonë. Arritjet përgjatë vitit 2017 dhe përvoja e fituar janë baza më e mirë për të përballuar detyrat dhe sfidat për vitin 2018, siç është ulja e numrit të punëkërkuesve që trajtohen me ndihmë ekonomike nëpërmjet: kualifikimit të tyre në profesione të ndryshme për ti bërë të aftë për tregun e punës; pjesëmarrje më e gjerë e punëkërkuesve në programet e nxitjes së punësimit; ndërmjetësimi i sa më shumë punëkërkuesve në bashkëpunim të ngushtë me sipërmarrjen private.

26.01.2018

Prefekti i Qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj i shoqëruar nga Drejtori i Komisionit Vendor të Verifikimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore zhvilloi një takim pune në

Ministrinë e Bujqësisë me drejtoreshën e Sekretariatit Teknik të Tokës znj. Majlinda Bozgo. Qëllimi i këtij takimi ishte shkëmbimi i eksperiencës dhe marrja e asistencës ligjore në procesin e hetimit administrativ të akteve të marrjes së tokës në pronësi. Në përfundim të këtij takimi, Prefekti i qarkut shprehu angazhimin e tij për organizimin e një takimi rajonal me drejtues të njësive të Vetëqeverisjes Vendore dhe të ZVRPP-ve të qarkut për të harmonizuar punën e të gjithë hallkave shtetërore në mënyrë që procesi i verifikimit të AMTP-ve dhe më pas rregjistrimi i këtyre pronave të bëhet brenda afateve ligjore.

29.01.2018

Është zhvilluar ditën e sotme analiza vjetore e Zyrës Rajonale/ADISA Gjirokastër me pjesëmarrjen e Prefektit të Qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj, ku gjatë periudhës qershor-dhjetor 2017 janë kryer 57, 653 aplikime nga 339 shërbime që ofrohen nga kjo zyrë.

Përgjatë kësaj periudhe 6-mujore u vu re një trend rënës përsa i përket ankesave nga 10.1% në 5.0%; Kthim përgjigje e lartë nga ana e institucionit, gati 94% e të gjitha kërkesave kanë marrë zgjidhje dhe 97.7% persona të kënaqur me shërbimin, organizimin e punës, punonjësit, ambientet që ofron ADISA (matur kjo nga formulari i Zërit të Qytetarit).

Disa nga problematikat e konstatuara përgjatë vitit 2017 ishin: komunikimi me institucionet bashkëpunuese i cili duhet të jetë më i shpejtë. Respektimi i afateve e përgjigjeve dhe për çdo vonesë të ketë njoftim; Informim më i gjerë duke filluar që nga shkollat për të drejtën e marrjes së shërbimit dhe transformimi i mënyrës së ofrimit të shërbimit në Shqipëri përmes qasjes me në qëndër qytetarin.

30.01.2018

Është zhvilluar analiza vjetore për vitin 2017 e Drejtorisë Rajonale të Rrugëve, me pjesëmarrjen e Prefektit të Qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj dhe nën drejtimin e z. Aristotel Ndoni, si drejtor i kësaj drejtorie. Gjatë analizës së aktivitetit të punës një-vjeçare të kësaj drejtorie, theksi u vendos tek monitorimi i punës së çdo kompanie mirëmbajtëse si dhe tek bashkëveprimi i ngushtë me policinë rrugore kur ka probleme në rrugë e sidomos në rastet e rrëshqitjeve masive. Prefekti i qarkut përshëndeti punën e kryer deri më tani dhe kërkoi që të kryhen me shpejtësi tenderat për

rrugët pa mirëmbajtje dhe të rriten kontrollet në rrugë në mënyrë që të eleminohen sa më shpejt nga firmat, problemet e ndryshme që krijohen nga emergjencat.

31.01.2018

Gjatë analizës së punës të Drejtorisë Arsimore Rajonale Gjirokastër, me pjesëmarrjen e Prefektit të qarkut z. Astrit Aliaj, u prezantuan arritjet e synuara përgjatë vitit 2017.

Gjatë monitorimeve në Institucionet Arsimore vlen të theksohet fakti se risitë e kurrikulës së re ishin përthithur dhe zbatoheshin duke plotësuar prioritetin e DAR Gjirokastër për 2017 për shtrirjen e reformës së kurrikulës së re në klasat III, VII dhe X. Gjatë vitit 2017 u realizua vlerësimi i 43 fëmijëve me aftësi të kufizuara nga Komisioni Multidisiplinor ku DAR plotësoi me mësues ndihmës të gjithë fëmijët në nevojë. Gjithashtu nga monitorimet e kryera në IA është vënë re rritja e numrit të nxënësve romë që frekuentojnë AF në kuadër të zbatimit të Planit Kombëtar për integrimin e romëve dhe egjiptianëve. Sigurisht që mbetet ende shumë për të bërë në këtë drejtim dhe nevojitet bashkëpunim ndërinstitucional për përmirësimin e kushteve të shkollimit dhe jetesës së tyre.

01.02.2018

Në institucionin e Prefektit të Qarkut Gjirokastër është zhvilluar takimi i punës me pjesëmarrjen e përfaqësuesit të Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve z. Andi Baka, drejtuesit e Ujësjellës Kanalizimeve për qarkun e Gjirokastrës dhe përfaqësuesit e bashkive të këtij qarku. Këto të fundit kanë ngritur task forcat dhe që nga sot kanë filluar punën për kontrollin e lidhjeve të kontratave të reja për institucionet dhe bizneset. Gjithashtu është ngritur edhe grupi i punës të monitorimit dhe koordinimit në zbatim të aksionit në sektorin e furnizimit me ujë të pijshëm.

02.02.2018

Në Institucionin e Prefektit të Qarkut Gjirokastër është zhvilluar takimi i punës me aktorët e biznesit të huaj dhe partnerët e tyre që zhvillojnë aktivitetet e biznesit në këtë qark. Pjesë e këtij takimi u bënë sipërmarrës të huaj që operojnë në qarkun e Gjirokastrës, Dhoma e tregëtisë, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit si dhe përfaqësues të

strukturave qëndrore në nivel qarku. Në fokus të takimit ishin bisedimet për zhvillimin ekonomik të rajonit, ulja e papunësisë si një nga prioritet kyçe të qeverisë dhe krijimi i një klime të sigurtë biznesi e cila do të gjenerojë punësim dhe të ardhura.

02.02.2018.

Në kuadër të nismës për një Shqipëri më të pastër të ndërmarrë nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, është zhvilluar takimi i punës në Institucionin e Prefektit të Qarkut Gjirokastër me Zv/Ministren e MTM znj. Ornela Çuçi dhe z. Rezart Fshazi, koordinator për qarkun e Gjirokastrës për çështjen e mbetjeve urbane.

Qëllimi i këtij takimi ishte ngritja e grupit teknik të punës që do të realizojë për këtë fazë të dytë, vlerësimin e të gjithë venddepozitimeve të mbetjeve sipas Metodologjisë për reduktimin e riskut në këto venddepozitimeve dhe për të propozuar nje plan-masash për ndërhyrje emergjente si pjesë e strategjisë kombëtare të qeverisë për menaxhimin e mbetjeve urbane.

04.02.2018

Në Institucionin e Prefektit të Qarkut Gjirokastër është zhvilluar paraditen e sotme në orën 11:30 mbledhja e jashtëzakonshme e Komisionit të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave për të analizuar situatën problematike të krijuar në qarkun e Gjirokastrës si rrjedhojë e rënies së rreshjeve të shiut me intesitet të lartë në 48 orët e fundit.

Prefekti i Qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj ka koordinuar ndarjen e detyrave ndërinstitucionale për të vlerësuar dëmet e shkaktuara nga rrëshkitja e dherave në lagjen "Kodra e Shtufit" në qytetin e Gjirokastrës dhe nga bllokimi i disa akseve rrugove si pasojë e prurjeve të mëdha. Në lidhje me situatën emergjente të evakuimit të banorëve të pallatit në lagjen "Kodra e Shtufit" është duke u pritur raporti i ekspertëve nga Tirana që janë duke zhvilluar studimin për shkaqet e dëmeve të pësuara në pallatin e rrezikuar.

Nga raporti përfundimtar që do të përcillet nga Drejtoria e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar do të bëhet i mundur edhe lëshimi i deklaratës zyrtare për shtyp nga ana e Institucionit të Prefektit. Është e ndaluar zyrtarisht çdo komunikatë tjetër për shtyp e lëshuar nga persona të paautorizuar.

11.02.2018

Është përkujtuar një nga datat më të shënuara të qytetit të Libohovës, ajo e çlirimit nga pushtuesit fashistë më 11 Shkurt 1943 andaj ju përulemi me mirënjohje të gjithë heronjve libohovitë që dhanë jetën për të fituar lirinë që ne të gjithë sot e gëzojmë. Gëzuar 75-vjetorin e Çlirimit Libohovë!

18.02.2018

Falë një bashkëpunimi të frytshëm midis deputetit të qarkut Gjirokastër z. Golemi, Kryetarit të Këshillit të Qarkut z. Hila, Prefektit të qarkut Gjirokastër z. Aliaj dhe mbështetjes së njerëzve e bizneseve që i janë përgjigjur kërkesës sonë, vazhdojnë punimet për rregullimin e rrugës së fshatit Zhulat nën drejtimin e z. Aristotel Noni dhe z. Niko Liçi.

19.02.2018

Ditën e sotme në Institucionin e Prefektit të Qarkut Gjirokastër është zhvilluar Analiza e Veprimtarisë së këtij institucioni për vitin 2017, me pjesëmarrjen e z. Sandër Lleshi, Këshilltar për Mbrojtjen dhe Sigurinë pranë Kryeministrit, drejtuesve të njësive të Vetëqeverisjes Vendore dhe të institucioneve shtetërore në nivel vendor.

Gjatë kësaj analize u evidentuan mangësitë, arritjet dhe sukseset në përmbushjen e detyrimeve për të garantuar zbatimin e programit politik të Këshillit të Ministrave në nivel qarku.

Prioriteti i punës së Institucionit të Prefektit të Qarkut Gjirokastër për vitin që lamë pas ka qënë ngritja në një shkallë më të lartë e frymës së bashkëpunimit, bashkërendimit dhe koordinimit të organeve të qeverisjes vendore, degëve territoriale dhe institucioneve të tjera që veprojnë në qark. Drejtimin e strukturave për parandalimin, menaxhimin, rehabilitimin e pasojave në rastet e emergjencave civile, drejtimin e task forcave, kontrollin dhe monitorimin e zbatimit në nivel qarku të politikave sektoriale të Këshillit të Ministrave në bujqësi, arsim, shëndetësi, mjedis, shërbim zjarrfikës, ndihmë dhe përkrahje sociale, turizëm dhe kulturë.

Një vëmendje të madhe i është kushtuar ndjekjes së kërkesave dhe ankesave të shtetasve deri në zgjidhjen e tyre ligjore.

Për këtë vit të ri që kemi hyrë përpos përparësive të përmendura mbetet si detyrë edhe nxitja e zhvillimi i marrëdhënieve dhe veprimtarive me institucione homologe ndërkufitare, për të mirën e komuniteteve të vendeve tona.

20.02.2018

Për të parë nga afër gjendjen aktuale si dhe për të vlerësuar situatën në vazhdim pranë pallatit të dëmtuar në lagjen "Kodra e Shtufit" me kërkesë të Prefektit të qarkut erdhën nga Tirana z. Shemsi Prençi, drejtor i Emergjencave Civile dhe z. Viktor Doda, drejtor i Shërbimit Gjeologjik.

Pas vlerësimit të gjendjes në terren, diskutimi u zhvendos në një takim pune në Institucionin e Prefektit të Qarkut Gjirokastër ku i pranishëm ishte edhe z. Sandër Lleshi, Këshilltar për Sigurinë dhe Mbrojtjen pranë Kryeministrit.

Nga ana e dy drejtuesve u vlerësua puna e bërë për studimin mbi kushtet gjeologo - inxhinierike të zonës ku ka ndodhur rrëshkitja dhe u lanë detyra konkrete për Bashkinë Gjirokastër. Gjithashtu përgatitja e projektit të përbashkët duhet të përfshijë inxhinierë ndërtimi, inxhinierë gjeolog dhe do të realizohet në një kohë shumë të shpejtë nga këta specialistë të Drejtorisë së Studimit dhe Projektimit në bashkëpunim edhe me specialistë të Ministrisë së Mbrojtjes.

20.02.2018

Në Institucionin e Prefektit të Qarkut Gjirokastër është zhvilluar takimi me pjesëmarrjen e koordinatorit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë z. Andi Baka, koordinatorit të institucionit të Prefektit dhe përfaqësuesit e grupeve të monitorimit për pasqyrimin e situatës të aksionit të ujit të pijshëm për gjysmën e parë të muajit Shkurt.

Gjatë kësaj periudhe janë kryer verifikime nga inspektorët përgjegjës të qarkut Gjirokastër për identifikimin e lidhjeve të paligjshme të institucioneve shtetërore dhe të bizneseve private të cilët janë pa kontratë dhe matësa shërbimi.

22.02.2018

Në zbatim të detyrave të lëna në takimin e datës 19 shkurt me Këshilltarin për Mbrojtjen pranë Kryeministrit z. Sandër Lleshi, Drejtorin e Përgjithshëm të Emergjencave Civile z. Shemsi Prençi dhe Drejtorin e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar z. Viktor Doda, ditën e sotme ka filluar puna për marrjen e kampioneve në masivin e dheut të rrëshkitur në lagjen "Kodra e Shtufit" nga ana e firmës fituese të tenderit të shpallur nga Bashkia Gjirokastër. Keto të dhëna do të nevojiten për hartimin e projekt-zbatimit si dhe fillimin sa më parë të punimeve në terren.

26.02.2018

Në Institucionin e Prefektit të Qarkut Gjirokastër është zhvilluar takimi i punës me drejtues e përfaqësues të Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve Gjirokastër, Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor Dega Rajonale Gjirokastër, Drejtorisë Rajonale të Shëndetësisë Gjirokastër dhe drejtorin e Ujësjellës Kanalizime Sh.a Gjirokastër mbi masat e marra nga institucionet përkatëse sipas përgjegjësive në lidhje me sigurinë, cilësinë dhe standartet e ujit të pijshëm.

Qëllimi i këtij takimi ishte që krahas aksionit në sektorin e ujit të pijshëm për formalizimin e këtij shërbimi, njëkohësisht nga institucionet përkatëse të punohet për rritjen e cilësisë së këtij shërbimi i cili duhet të jetë brenda të gjitha standarteve.

Nga pjesëmarrësit u raportua mbi punën e deritanishme dhe masat e marra ku janë lënë edhe rekomandimet përkatëse në fund të takimit në drejtim të përmirësimit të punës.

Sensibilizimi i qytetarëve nëpërmjet mediave mbi masat e marra dhe kontrollet që ushtrohen në drejtim të sigurisë dhe cilësisë së ujit të pijshëm. Gjithashtu të kërkohet nga ana e bashkisë të gjejë rrugët ligjore për marrjen e masave për heqjen e depozitave të ujit të qytetarëve në zonat ku ofrohet shërbimi 24 orësh i furnizimit me ujë.

27.02.2018

Në kuadër të riorganizimit të skemës së ndihmës ekonomike, Prefekti i qarkut Gjirokastër z. Aliaj dhe drejtori i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit z. Pesha, kanë organizuar ditën e sotme takime pune pranë ambjenteve të ndërmarrjeve fasone me drejtues të këtyre bizneseve për të parë nga afër mundësitë e ofruara nga ky treg pune. Sipërmarrësit fasonë janë shprehur se janë të gatshëm të rrisin kapacitetet e punësimit dhe përmirësimin e kushteve në punë në qoftë se do të kishte më tepër interes dhe kërkesa nga persona të aftë për punë, qoftë me ofrimin e transportit për rrethet e tjera të qarkut por edhe me ofrimin e kujdesit për fëmijët me ndërtimin e kopshteve dhe çerdheve pranë bizneseve të tyre. Në fjalën e tij z. Pesha premtoi se Drejtoria e Shërbimit Kombëtar të Punësimit është e gatshme të zhvillojë kurse kualifikimi me shpenzime të mbuluara për punonjësit pranë sipërmarrjeve fasone.

28.02.2018

Në Institucionin e Prefektit të qarkut Gjirokastër është nënshkruar kontrata për kryerjen e shërbimeve postare midis këtij institucioni dhe filialit të Postës Shqiptare Sh.A Gjirokastër. Me anë të kësaj marrëveshje do të bëhet i mundur pranimi, përpunimi, transporti dhe dorëzimi në destinacion nga ana e filialit të kësaj poste, i çdo korespodence zyrtare përkatëse që lidhet me shërbimin që ofron institucioni i Prefektit për vërtetimin e dokumentave të lëshuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.



01.03.2018

Në kuadër të zbatimit të skemës së re të ndihmës ekonomike në Institucionin e Prefektit të Qarkut Gjirokastër është organizuar takimi për implementimin e kësaj skeme, duke marrë shkas edhe nga ankesat e përsëritura të komunitetit pretendues për ndihmën ekonomike.

Në këtë takim morën pjesë nënprefektët e Tepelenës dhe Përmetit, drejtuesi i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, drejtuesi i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, drejtuesi i Degës së Sigurimeve Shoqërore Rajonale, përfaqësuesi i Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional Publik dhe administratorët shoqërorë të njësive të vetëqeverisjes vendore të qarkut Gjirokastër.

Fokusi i këtij takimi ishte pasqyrimi i deritanishëm i ecurisë së kësaj reforme, diskutimi i të gjitha fazave që do të kalojë proçesi i skemës së re të ndihmës ekonomike si dhe masat që duhet të merren për analizimin e shkaqeve të mospërfshirjes së familjeve përfituese ku nuk përjashtohen edhe gabimet në aplikime, të cilat do të rivlerësohen edhe njëherë përmes sistemit elektronik dhe verifikimeve në terren me ndihmën e institucioneve të tjera në vartësi të MSHMS.

07.03.2018

Në Institucionin e Prefektit të qarkut Gjirokastër është zhvilluar mbledhja e parë e Organit Këshillues të Prefektit. Në këtë organ marrin pjesë drejtues të njësive të vetëqeverisjes vendore, drejtues të degëve territoriale të qarkut, përfaqësues të shoqërisë civile si dhe përfaqësues të biznesit të cilët operojnë në rajonin tonë. Për implementimin dhe realizimin e reformave dhe investimeve të qeverisë shqiptare në qarkun Gjiokastër, kërkohet bashkëpunimi i të gjitha institucioneve shtetërore vendore dhe veçanërisht i njësive të vetëqeverisjes vendore. Në këtë kontekst pjesëmarrësit në këtë organ dhanë mendime, sugjerime, këshillime dhe diskutuan për mbarëvajtjen e çdo problematike dhe specifike që lidhet me zhvillimin e rajonit tonë.

08.03.2018

"Urime 8 Marsin, ditën ndërkombëtare të gruas" me këto fjalë i ka pritur të gjitha punonjëset femra, Prefekti i qarkut z. Astrit Aliaj në zyrën e tij, duke ju uruar fat e lumturi të gjitha nënave dhe motrave në këtë ditë të vecantë dedikuar femrës. Nga Prefekti i qarkut nuk kanë munguar as vlerësimet për punonjëset e institucionit qe ai drejton duke shprehur mirënjohjen e tij me dhurimin e luleve.

16.03.2018

Në kuadër të luftës kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit, në zbatim të detyrimeve ligjore, Prefekti i qarkut mblodhi Task Forcën Vendore për këtë qëllim, pranë institucionit të Prefektit të qarkut të Gjirokastrës. Kjo Taskë Forcë Vendore përbëhet nga drejtues të strukturave të veçanta të pushtetit vendor si dhe kryetarët e bashkive të këtij qarku.

Nisur nga objektivat dhe prioritetet strategjike si dhe përpjekjet e vazhdueshme që po bën Qeveria Shqiptare për tu integruar në familjen europiane, Task Forca Vendore pranë Prefektit të qarkut ka hartuar Planin e Veprimit Vendor për parandalimin dhe luftën kundër kultivimit të bimëve narkotike.

Qëllimi i këtij plani është të parashikojë masat, detyrat dhe veprimet që do të merren dhe zbatohen nga strukturat përkatëse që janë pjesë e Task Forcës Vendore veçanërisht strukturave të Policisë Vendore dhe atyre të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të kultivimit të kanabisit si dhe vënien para përgjegjësive ligjore të autorëve.

19.03.2018

Në kuadër të plan-kalendarit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit është zhvilluar takimi rajonal në nivel qarku për sensibilizimin e komunitetit për parandalimin e kultivimit të bimëve narkotike.

Pjesëmarrës në këtë takim ishin znj. Aida Hajna, N/Drejtore e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, drejtues të policisë vendore të qarkut, drejtues të njësive të vetëqeverisjes vendore, të institucioneve shtetërore rajonale si dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Prefekti i qarkut z. Aliaj kërkoi mbështetjen dhe bashkëpunimin e të gjitha institucioneve shtetërore vendore, njësive të vetëqeverisjes vendore, organeve ligjzbatuese, institucioneve arsimore, të mediave lokale dhe qëndrore për sensibilizimin e komunitetit të rajonit tonë në luftën kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit.

05.04.2018

Në Institucionin e Prefektit të qarkut Gjirokastër është mbajtur takimi i punës me sekretarët e këshillave bashkiakë, specialistë të njësive të vetëqeverisjes vendore, drejtorin e DAMT në Këshillin e Qarkut z. Bekim Sinani dhe drejtoresha e Shërbimit Social Shtetëror në qark znj. Magdalena Margariti për problematikat e dala gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së akteve vendore si dhe proçesit të verifikimit për dhënien e akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi.

Qëllimi kryesor i këtij takimi ishte konsultimi dhe bashkëpunimi në drejtim të unifikimit dhe standartizimit të këtyre akteve.

06.04.2018

Në Institucionin e Prefektit të qarkut Gjirokastër u zhvillua mbledhja e Organit Këshillues të Prefektit për të prezantuar punën përgatitore në lidhje me aksionin e pastrimit të segmenteve lumore të ndotura nga qeset plastike për javën e tokës, 16 - 22 prill.

Përpos anëtarëve të këtij organi, ishin të ftuar edhe përgjegjësi i Bordit të Kullimit për qarkun, drejtori i Autoritetit Rrugor Jugor, drejtori i ADZM dhe Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve Gjirokastër.

Gjatë këtij takimi është kërkuar nga Prefekti i qarkut z. Aliaj marrja e të gjitha masave organizative dhe sensibilizuese, sigurimi i bazes së nevojshme materiale, mjeteve dhe

punonjësve nga institucionet përgjegjëse për mbarëvajtjen sa më të suksesshme të këtij aksioni.

12.04.2018

Në prag të sezonit turistik, Prefekti i qarkut Gjirokastër z. Aliaj zhvilloi një takim pune me drejtues të Policisë Rrugore për marrjen e masave të nevojshme të cilat garantojnë sigurinë e akseve rrugore si dhe evidentimin e segmenteve rrugore problematike në mënyrë që nga këta drejtues të hartohet një studim i detajuar për përmirësimin e infrastrukturës rrugore në akset nacionale.
Gjithashtu në këtë takim u diskutua edhe mbi propozimet që duhen bërë për ndryshimet në kodin rrugor për sa i përket sanksioneve plotësuese për drejtuesit e mjeteve me leje drejtimi të shteteve të huaja.

12.04.2018

Në prag të sezonit turistik, Prefekti i qarkut Gjirokastër ka organizuar një takim pune me drejtuesit e Autoritetit Rrugor Jugor, përfaqësues të firmave konçesionare "Salillari", "Shkëlqim 07", me pjesëmarrjen e supervizorëve të Bankës Botërore dhe drejtuesit e Policisë Rrugore. Objekti i këtij takimi ishte raportimi nga aktorët pjesëmarrës mbi masat e marra për rritjen e sigurisë rrugore për këtë sezon turistik.

16.04.2018

Në institucionin e Prefektit të qarkut Gjirokastër është zhvilluar takimi i punës me drejtues të institucioneve rajonale dhe përfaqësues të bashkisë Gjirokastër ku është diskutuar për mënyrën e përfshirjes së këtyre institucioneve, në bashkëpunim edhe me bashkitë e qarkut, për mbarëvajtjen sa më të suksesshme të aksionit kombëtar të pastrimit të segmenteve lumore më problematike për qarkun tonë.

Gjithashtu Prefekti i qarkut ka zhvilluar një kafe pune me gazetarët e mediave vizive dhe atyre të shkruara lokale e kombëtare, ku është kërkuar që në vazhdimësi të kemi sensibilizim të të gjithë opinionit të qarkut Gjirokastër për rëndësinë e këtij aksioni pastrimi si dhe i inkurajoi mediat për pasqyrimin në vazhdimësi të problemeve dhe realitetit me qëllim që sezoni i ri turistik në këtë qark të jetë një sezon i suksesshëm.

16.04.2018

Fillimi i aksionit kombëtar për pastrimin e segmenteve lumore më problematike për javën e tokës, në qarkun Gjirokastër. Aksioni i pastrimit në bashkinë Gjirokastër është përqëndruar në zonën e Urës së Kordhocës i kryer nga forcat e Detashmentit të Mbrojtjes Rajonale nën drejtimin e z. Stefani.

Në bashkinë e Përmetit kanë kontribuar për aksionin e pastrimit edhe 250 nxënës të shkollave për pastrimin e hyrjes së qytetit ndërkohë që në Këlcyrë aksioni i pastrimit është përqëndruar në shtratin e lumit Dëshnicë poshtë urës së qytetit. Ndërsa në bashkinë e Dropullit aksioni i pastrimit është përqëndruar në zonën e Dervicianit dhe Urës së Goranxisë.

Gjatë inspektimit në terren të kryerjes së këtij aksioni, nga Prefekti i qarkut z. Aliaj janë zhvilluar takime me kryetarët e bashkive Dropull dhe Libohovë si dhe përgjegjësit e këtyre bashkive për mbarëvajtjen sa më të suksesshme të këtij aksioni, ku është kërkuar gjithashtu të

punohet edhe në drejtim të sensibilizimit të qytetarëve për hedhjen e kontrolluar të mbetjeve dhe që këto mbetje të menaxhohen sa më mirë nga ana e bashkive.

17.04.2018

Prefekti i qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj ka zhvilluar takimin e punës me drejtorin dhe nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Koto Hoxhi" për sensibilizimin e brezit të ri për hedhjen sa më të kontrolluar të mbetjeve, duke theksuar që edukimi i tyre fillon që në familje dhe vazhdon në ambientet e mësimit.

Pjesëmarrës në këtë takim ishte edhe Drejtori i Policisë Vendore z. Dafa i cili theksoi rëndësinë e parandalimit të risqeve që vinë nga jashtë si drogërat apo dhuna dhe konfliktet me përdorimin e thikave dhe mjeteve të tjera të ftohta. Në fjalën e tyre të dy drejtuesit i mëshuan rëndësisë që duhet të jemi një hap përpara dhe të insistojmë për parandalimin e këtyre fenomeneve.

Në takimin e zhvilluar në Drejtorinë Arsimore me të gjithë drejtorat e shkollave të rrethit Gjirokastër u diskutuan mënyrat e operimit dhe pjesëmarrjes së shkollave në aksionin e pastrimit për javën e tokës në ambientet përreth shkollave dhe zonave të tjera të qytetit. Prefekti i qarkut z. Aliaj i konsideroi shkollat si institucionet më të rëndësishme në qark që edukojnë brezin e ri dhe që kanë kontribut të drejtëpërdrejtë në sensibilizimin e të rinjve për mbajtjen pastër të qytetit ku jetojmë.

18.04.2018

Në kuadër të aksionit të pastrimit për javën e tokës që vazhdoi prej disa ditësh në qarkun Gjirokastër si dhe ditës ndërkombëtare të monumenteve të kulturës dhe siteve arkeologjike, Prefekti i qarkut z. Aliaj bashkë me zv. Ministren për Evropën dhe Punët e Jashtme kanë inspektuar dhe vlerësuar sot punën e bërë në terren nga Forcat e Detashmentit të Mbështetjes Rajonale për pastrimin e një gjatësie të konsiderueshme të shtratit të lumit Drino në zonën e urës monument kulture në Kordhocë.

Kjo ditë është një ditë e rëndësishme qoftë për mesazhet që percjell për një mjedis të pastër por edhe kthen vëmendjen nga mbrojtja e monumenteve të trashëgimisë kulturore si dhe sensibilizon komunitetin për mbrojtjen dhe promovimin e këtyre vlerave.

18.04.2018

Aksioni i pastrimit të segmenteve lumore, në prag të sezonit të ri turistik, për javën e tokës hyri në ditën e tretë të tij duke përfshirë gjithë bashkitë e qarkut Gjirokastër.

20.04.2018

Në ditën e pestë të tij, aksioni i pastrimit të segmenteve lumore më të ndotura të qarkut Gjirokastër mblodhi bashkë institucionet në nivel vendor të këtij qarku.

Pjesëmarrës në këtë aksion ishin edhe zv. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit znj. Çuçi, deputeti i qarkut Gjirokastër z. Golemi dhe Prefekti i qarkut Gjirokastër z. Aliaj. Në qytetin e Gjirokastrës aksioni është përqëndruar në të dy anët e lumit Drino në zonën e parkut të Viroit me ndërhyrjen edhe të Forcave të Armatosura dhe mjeteve të firmës "Salillari", gjithashtu edhe në zonën e urës së lumit.

Në këtë aksion u angazhuan administrata e Prefektit të qarkut, Shërbimi Social Shtetëror, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, AKU, Drejtoria Rajonale e Bujqësisë dhe Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave.

22.04.2018

Më 22 prill në Ditën e Tokës, më shumë se 1 bilion njerëz në 192 shtete të botës marrin pjesë në atë që mund të quhet dita më e rëndësishme e aksionit qytetar për mbrojtjen e planetit ku jetojmë.

Me qëllimin e mirë dhe të domosdoshëm për të ndaluar ndotjen e mjedisit, për Javën e Tokës, është zhvilluar aksioni mbarëkombëtar për pastrimin e zonave përreth shtretërve të lumenjve në të gjithë Shqipërinë.

Institucioni i Prefektit të qarkut Gjirokastër nën drejtimin e Prefektit z. Astrit Aliaj ka ndjekur mbarëvajtjen e këtij aksioni ku për një javë janë larguar rreth 110 ton mbetje në të gjithë qarkun e Gjirokastrës.

Si institucion përgjegjës është shprehur mirënjohja për të gjitha forcat e Detashmentit të Mbrojtjes Rajonale, bashkive të qarkut, institucioneve rajonale vendore dhe shkollave për angazhimin e tyre përgjatë këtyre ditëve në pastrimin e segmenteve problematike përgjatë lumenjve Vjosë, Drino, Dëshnicë e Bënçës.

24.04.2018

Prefekti i qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj priti në një takim të veçantë Ambasadorin italian në Tiranë z. Cutilio dhe Konsullin Italian të nderit në Gjirokastër z. Theodhori Bilushi. Gjatë këtij takimi z. Aliaj vlerësoi kontributin e veçantë të shtetit italian në fusha të ndryshme në gjithë territorin e qarkut si dhe nevojën për vazhdimin e këtij bashkëpunimi në fushën e arsimit, turizmit, trashëgimisë kulturore, turizmit të agrokulturës por edhe në ndihmën dhe ekspertizën për sa i përket krijimit të strukturave të reja të emergjencave civile në të gjithë rajonin tonë.

09.05.2018

Në institucionin e Prefektit të qarkut Gjirokastër është zhvilluar takimi i punës me drejtuesit rajonal të institucioneve shtetërore në nivel vendor.

Fokusi i këtij takimi ishte raportimi nga ana e drejtuesve për realizimin e detyrave për 4-mujorin e parë të vitit 2018, marrdhënia me qytetarët, zgjidhja e problemeve të tyre, shërbimet, realizimi i investimeve dhe rekomandimet e drejtuesve për ministritë e linjës dhe Këshillin e Ministrave.

Ndër të tjera Prefekti i qarkut z. Astrit Aliaj theksoi rëndësinë e ndërgjegjësimit të secilit prej funksionarëve për rolin që ata kanë në institucionin që drejtojnë, përgjegjësinë maksimale në realizimin e detyrave dhe objektivave të përcaktuara, luftën kundër informalitetit dhe krijimin e një fryme besimi tek punonjësit duke intesifikuar përpjekjet për ngritjen e tyre profesionale.

Kjo mbledhje i paraprin turit të llogaridhënies në takimet që do të zhvillohen nga ana e ministrave, zv/ministrave dhe drejtuesve të lartë në qarkun e Gjirokastrës lidhur me veprimtarinë e punës së institucioneve shtetërore vendore në qarkun tonë.

11.05.2018

Në Institucionin e Prefektit të qarkut Gjirokastër është zhvilluar ditën e sotme takimi mujor i Organit Këshillues pranë Prefektit.

Në këtë takim ishin të pranishëm Drejtoresha e Çështjeve Vendore dhe Funksioneve të Deleguara në Ministrinë e Brendshme znj. Alma Mele, përfaqësues të Drejtorisë Rajonale të AKU-së, drejtues të Drejtorisë Rajonale të Shëndetit Publik Gjirokastër si dhe drejtues të spitaleve Përmet dhe Tepelenë.

Gjatë këtij takimi janë trajtuar problematikat e shërbimit shëndetësor në qarkun e Gjirokastrës, gjendja e infrastrukturës spitalore dhe shëndetësore si dhe rritja e nivelit të shërbimit mjekësor në qendrat shëndetësore në të gjithë territorin e qarkut.

Gjithashtu në këtë takim janë diskutuar edhe masat e marra për parandalimin e fenomenit të therjes dhe tregëtimit të mishit jashtë kushteve normale në zbatim të Aktit Normativ të KM nr. 4 dt. 16.8.2012.

Gjithashtu Prefekti i qarkut kërkoi një bashkëpunim institucional midis njësive të vetëqeverisjes vendore dhe institucioneve përgjegjëse për marrjen e masave dhe krijimin e kushteve të favorshme për tregëtimin e produkteve blegtorale, bujqësore dhe shtazore në të gjithë territorin e rajonit tonë.

Në fund të këtij takimi, në fjalën e tij Prefekti i qarkut z. Astrit Aliaj kërkoi zgjidhjen e problemit të mungesës së mjekëve 24-orësh në qendrat shëndetësore në të cilat nuk ofrohet shërbimi spitalor.

16.05.2018

Nderime dhe respekt dëshmorëve të atdheut!

Prefekti i qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj ka nderuar me rastin e 21 vjetorit, oficerët e rënë në krye të detyrës në vendin e quajtur Ramanxa, njësia administrative Picar, bashkia Gjirokastër.

16.05.2018

Në ambientet e Zyrës Arsimore të rrethit Tepelenë është zhvilluar mbledhja e punës për shqyrtimin e ankesës së bërë nga një ish arsimtare në lidhje me lirimin e saj nga detyra.

Në këtë mbledhje kanë qënë të pranishëm Prefekti i qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj, Nënprefekti Tepelenë z. Avni Lala, përgjegjësi i ZA Tepelenë dhe punonjës të tjerë të institucionit të Prefektit ku dhe janë sqaruar nga përgjegjësi i kësaj zyre për proçedurat e ndjekura për lirimin nga detyra të ish mësueses për të cilën do të paraqitet edhe relacioni përkatës sëbashku me dokumentat shoqëruese.

16.05.2018

Në institucionin e Prefektit të qarkut Gjirokastër është zhvilluar takimi i punës i organizuar nga Kryetari i Këshillit të Basenit të Vjosës, njëkohësisht edhe Prefekt i qarkut Vlorë z. Flamur Mamaj, me pjesëmarrjen edhe të Prefektit të qarkut Fier z. Baki Balaj dhe Prefektit të qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj.

Gjithashtu të pranishëm në këtë takim ishin edhe Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, përfaqësuesi i Drejtorisë së Policisë Vendore drejtuesit e Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit dhe Inspektoriatit Shtetëror të Ujrave, si dhe përfaqësues të firmave ndërtimore që shfrytezojnë inertet e lumenjve të basenit Vjosë.

Në këtë takim është ngritur grupi i punës i cili do të punojë ditët e ardhshme për evidentimin e të gjithë firmave të ligjshme dhe të paligjshme që shfrytëzojnë materialet inerte në basenin e Vjosës si dhe llogaritjen e pagesës së rentës minerare në Drejtorinë e Tatimeve nga këto subjekte.

17.05.2018

Në Intitucionin e Prefektit të qarkut Gjirokastër është zhvilluar mbledhja e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit me temë diskutimi hapjen e sezonit të ri turistik 2018 dhe planin e masave përgatitore të marra nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore dhe institucionet rajonale për mbarëvajtjen e këtij sezoni të ri turistik. Në këtë takim ishte i pranishëm edhe Zv. Ministri i Turizmit dhe Mjedisit z. Hajrulla Çeku.

Në kuadër të promovimit dhe rritjes së turizmit në qarkun e Gjirokastrës, institucioni i Prefektit ka realizuar Projektin "Krijimi i rrjetit dhe promovimi i kështjellave" (Net Castle) i cili është zbatuar në bashkëpunim me Qendrën UET nga pala shqiptare dhe Rajonin e Ishujve Joniane nga pala greke. Ky projekt ka bërë të mundur që për herë të parë 12 kështjella të qarkut Gjirokastër të dixhitalizohen dhe të projektohen në sistemin 3D, për tu vizituar tashmë virtualisht në ëebsiten e projektit nga çdo i interesuar. Ky projekt ka si objekt përforcimin e bashkëpunimit dhe të shkëmbimeve ndërkufitare sikundër edhe rritjen e turizmit në zonë, diferencimin e kalave nga monumentet klasike antike si dhe fuqizimin dhe azhornimin e metodave informuese për të gjithë banorët dhe vizitorët, nëpërmjet përdorimit të teknologjive të reja, çka është dhe një kontribut në trajnimin kulturor të të rinjve.

Në fjalën e tij Prefekti i qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj ka dhënë sugjerimet për këtë sezon të ri turistik duke u nisur edhe nga problematikat e hasura gjatë vitit 2017. Nëpërmjet strukturave përkatëse të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të qarkut duhet të punohet për liçensimin e të gjitha biznesve të vogla të hotelerisë, ndriçimin e objekteve muzeale, kulturore e historike, përpilimin e të dhënave të sakta për numrin e turistëve vendas

e të huaj që vizitojnë qarkun si dhe të krijohen zyra turistike pranë të gjitha bashkive ku vizitorët të marrin të gjithë informacionin e duhur.

19.05.2018

Me rastin e përfundimit të klasës së parë dhe lëndës së abetares, klasa e I C e shkollës 9-vjeçare "Koto Hoxhi" ka zhvilluar aktivitetin "Pasarela e fjalëve" i ndjekur edhe nga Prefekti i qarkut z. Astrit Aliaj. Në fjalën e tij përshëndetëse Prefekti i qarkut ka përgëzuar mësuesen dhe fëmijët për aktivitetin e larmishëm por edhe për mesazhet motivuese të përcjella për ne të rriturit që të punojmë më fort për brezat e rinj.

28.05.2018

Në institucionin e Prefektit të qarkut Gjirokastër është zhvilluar mbledhja e punës e Task Forcës Rajonale për marrjen e masave parandaluese në përballimin e emergjencave për zjarret në pyje dhe kullota gjatë periudhës qershor – shtator 2018.
Në fjalën e tij Prefekti i qarkut z. Astrit Aliaj ka kërkuar përkushtim e vlerësim maksimal, koordinim e bashkëpunim permanent ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore, degëve territoriale dhe strukturave shtetërore në të gjitha fazat me prioritet: parandalimin, shmangien dhe minimizimin e dëmeve në situatat që mund të krijohen për shkak të zjarreve të natyrave të ndryshme.

01.06.2018

Në kuadër të ankesave drejtuar institucionit të Prefektit të Qarkut Gjirokastër nga banorë të bashkisë Libohovë, Prefekti i qarkut z. Astrit Aliaj ka zhvilluar një takim ballafaques në bashkinë e Libohovës me Kryetaren e kësaj bashkie znj. Luiza Mandi dhe stafin, në prani edhe të qytetarëve, për trajtimin dhe zgjidhjen e problemeve të paraqitura.

Prefekti i qarkut z. Astrit Aliaj ka lënë rekomandimet përkatëse për bashkinë Libohovë, që konsistojnë në ngritjen e një grupi pune për verifikimin në vend të të gjitha problematikave të paraqitura nga qytetarët.

01.06.2018

Në kuadër të mbarëvajtjes për zhvillimin e Maturës Shtetërore 2018, në institucionin e Prefektit të qarkut Gjirokastër është mbajtur sot takimi i punës për trajnimin e përfaqësuesve të Prefektit, në lidhje me njohjen dhe zbatimin e Rregullores së Maturës Shtetërore 2018.

Në këtë takim kanë qënë të pranishëm edhe drejtoresha e Drejtorisë Arsimore Rajonale Gjirokastër si dhe drejtuesit e Zyrave Arsimore Tepelenë dhe Përmet. Përfaqësuesit e Prefektit në provimet e MSH –së do të monitorojnë zbatimin e Rregullores së Maturës Shtetërore 2018 në qendrat e provimeve të MSH-së.

12.06.2018

Në institucionin e Prefektit të qarkut Gjirokastër është zhvilluar takimi i rradhës i Organit Këshillues të Prefektit me tematikë "Marrja e masave për parandalimin e zjarreve në stinën e verës, bashkëpunimi i ngushtë i Inspektoriatit shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve me organet e vetëqeverisjes vendore dhe komunitetit në përgjithësi dhe ruajtja e objekteve të rëndësisë së veçantë në qark".

Prefekti i qarkut z. Astrit Aliaj, në fjalën e tij si drejtues i Organit Këshillues, në funksion të marrjes së masave efektive për përballimin me sukses të situatave të mundshme emergjente, kërkoi përkushtim e vlerësim maksimal, koordinim e bashkëpunim permanent ndërmjet

njësive të vetëqeverisjes vendore, degëve territoriale dhe strukturave shtetërore në të gjitha fazat me prioritet: parandalimin, shmangien dhe minimizimin e dëmeve në situatat që mund të krijohen për shkak të zjarreve të natyrave të ndryshme.

18.06.2018

Prefekti i qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj ka zhvilluar takimet e punës në bashkinë Tepelenë dhe bashkinë Memaliaj për të diskutuar për vijimin e masave të marra në luftën kundër kultivimit të bimëve narkotike. Të pranishëm në këto takime kanë qënë kryetarët e bashkive, Drejtori i Policisë së Qarkut dhe shefat e Komisariateve, inspektorët dhe vrojtuesit pyjor pranë bashkive si dhe administratorët e njësive administrative të këtyre bashkive.

Në fjalën e tij Prefekti i qarkut është shprehur për tolerancë zero ndaj kultivimit të kanabisit, duke kërkuar raportim të përditshëm në institucionin e Prefektit të qarkut Gjirokastër nga administratorët dhe rojtarët e pyjeve si për kontrollin e territorit të tyre për bimë narkotike ashtu edhe për vatra zjarri duke dhënë edhe rekomandimet përkatëse.

18.06.2018

Gjatë inagurimit të xhamisë së Dunavatit e ringritur me ndihmën e donatorëve të huaj nga Kuvajti, Prefekti i qarkut z. Astrit Aliaj ka shprehur falenderimet e tij për investimin e kryer në këtë objekt të rëndësisë së veçantë dhe për ndihmën e ofruar për 30 fëmijët jetim dhe për dy familjet që i kanë shtëpitë e dëmtuara nga zjarri.

25.06.2018

Në bashkinë Dropull është zhvilluar takimi me personelin e shërbimit mjekësor dhe pjesëmarrjen e Prefektit të qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj, Kryetarit të Bashkisë Dropull z. Arqile Deçka, Drejtorit Rajonal të Shërbimit Shëndetësor z. Shpëtim Novi, përfaqësueses së Avokatit të popullit në këtë bashki, mjek dhe ndihmësmjek të qëndrave shëndetësore. Gjatë këtij takimi janë trajtuar problematikat që dalin nga mungesa e mjekëve dhe gjetja e mundësive për një organizim të ri brenda numrit të mjekëve, ndihmësmjekëve dhe infermierëve me qëllim mbulimin me shërbim të të gjithë fshatrave.

Nga Prefekti i qarkut Gjirokastër është theksuar rëndësia e një kujdesi të shtuar nga shërbimi mjekësor gjatë këtij sezoni turistik kundrejt turistave që do të vizitojnë zonën e Dropullit.

27.06.2018

Ceremonia e 75-vjetorit të betejës së Dervenit!

Në bashkinë Memaliaj në ditën përkujtimore në nderim të partizanëve të rënë në betejën e Dervenit janë vendosur kurora lulesh nga Prefekti i qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj, Nënprefekti i Tepelenës z. Avni Lala dhe kryetari i bashkisë Memaliaj z. Durim Rroshi si dhe nga zyrtarë e figura të tjera të shquara.

27.06.2018

Prefekti i qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj ka qënë i pranishëm në takimin e mbajtur në Drejtorinë Vendore të Policisë me efektivët e Policisë Rrugore në rang qarku. Në këtë takim ishin të pranishëm edhe Drejtori i Policisë Vendore z. Vatoci, zv. Drejtori z. Dafa dhe Shefi i Qarkullimit të Policisë Rrugore z. Veliu. Në fokus të këtij takimi ishin rritja e masave në drejtim të qarkullimit të sigurtë të mjeteve në akset rrugore të qarkut Gjirokastër përgjatë këtij sezoni turistik veror si dhe zbatimi me korrektësi i kodit rrugor shoqëruar me një prezantim të denjë të çdo efektivi të policisë rrugore në kryerjen e detyrës së ngarkuar.

28.06.2018

Në institucionin e Prefektit të qarkut Gjirokastër është zhvilluar mbledhja e dytë e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit për vitin 2018 ku i pranishëm ka qënë edhe Zv. Ministri i Turizmit dhe Mjedisit z. Hajrulla Çeku. Në këtë takim është diskutuar mbi masat e marra nga institucionet përkatëse përgjegjëse për mbarëvajtjen e sezonit turistik veror 2018, ecuria e deritanishme dhe problematikat e hasura.

Në fjalën e tij Prefekti i qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj ka falenderuar Zv. Ministrin e Turizmit z. Çeku për kontributin e dhënë me rekomandimet përkatëse të cilat janë vendosur në zbatim gjatë kësaj periudhe. Gjithashtu gjatë këtij takimi, Prefekti i qarkut është informuar në mënyrë të detajuar mbi lëvizjen e turistëve vendas dhe të huaj për periudhën janar - qershor 2018 për qarkun e Gjirokastrës.

06.07.2018

Prefekti Qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj ka marrë pjesë në demostrimin e helikopterëve te Forcave Ajrore për fikjen e zjarrit nga ajri me dy kovat e reja me kapacitet 2500 litra.

Të pranishëm gjithashtu kanë qënë 12 Prefektët e qarqeve, Ministria e Mbrojtjes znj. Olta Xhaçka, Shefi Shtabit të përgjithshëm FA Gjen. Maj. Bardhyl Kollcaku, Komandanti i Forcave Ajrore Gjen. Brig. Vladimir Avdiaj Drejtori i përgjithshëm i emergjencave civile z. Haki Çako, Deputeti përfaqësues nga Komisioni i sigurisë z. Xhemal Qefalia, z. Shpëtim Sina, drejtues të Forcave Zjarrfikëse dhe drejtues të tjerë të Emergjencave Civile dhe Forcave të Armatosura.

06.07.2018

Në institucionin e Prefektit të qarkut Gjirokastër është zhvilluar takimi i tretë i Forumit të Dialogut në sektorin e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta.

Iniciativë e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit e mbështetur nga Agjencia Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim, bashkoi sot përfaqësues nga qeveria qëndrore, njësitë e vetëqeverisjes vendore, shoqatat e kompanive private të riciklimit dhe shoqatat e operatorëve që ofrojnë shërbimin e menaxhimit të mbetjeve për të ndarë informacionin dhe për të ndërtuar konsensus në sektorin e Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta.

07.07.2018

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka çelur projektin "Smile Albania" përmes të cilit do të punësohen 1000 të rinj. Kjo nismë e ministrisë është shtrirë edhe në qarkun e Gjirokastrës.

Zv. Ministria znj. Ornela Çuçi së bashku me Prefektin e qarkut z. Astrit Aliaj dhe me dhjetra të rinj e të reja nga pika e kalimit kufitar në Kakavijë kanë dhënë mesazhe sensibilizuese për të gjithë turistët e huaj dhe ata vendas, mbi orientimin e tyre drejt destinacioneve kryesore ndërkohë që do të kenë dhe një rol promovues për të rritur përgjegjësinë e qytetarëve për një mjedis sa më të pastër. Zv. Ministria e Mjedisit ju është drejtuar të rinjve me fjalët se për ata është përgjegjësi dhe detyrë ta shndërrojnë vendin në një destinacion europian të turizmit.

Kjo periudhë punësimi do t'ju shërbej të rinjve edhe si praktikë pune pranë administratës shtetërore të zonave të mbrojtura.

10.07.2018

Në institucionin e Prefektit të qarkut Gjirokastër është zhvilluar takimi i punës me drejtuesit e organeve ligjzbatuese dhe organizatave humanitare që veprojnë në qark me objekt veprimtarie mbrojtjen e kufirit dhe migracionin.

Pjesëmarrës në këtë takim ishin Drejtori i Koordinimit të Unionit "Stop Krimit" z. Toska, Drejtori i këtij Unioni për qarkun Gjirokastër z. Ngjelo, Drejtori Vendor i DVKM z. Hoxha, Shefi i Migracionit të DVKM Gjirokastër z. Çumani, Shefi i Hetimit të DVKM Gjirokastër z. Ruçi, Drejtori i A.K.I Athinë z. Selamaj si dhe përfaqësues të UNCR-së znj. Luzo dhe të CARITAS Albania znj. Çerepi.

Në fjalën e tij Prefekti i qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional në shkëmbimin e informacionit të nevojshëm për luftimin e problematikave të nxehta në lidhje me kufirin dhe migracionin si azilkërkuesit që kalojnë në mënyrë të paligjshme për në tokën shqiptare. Qëllimi i vetëm për një bashkëpunim të suksesshëm ndërinstitucional është rritja dhe garantimi i sigurisë kombëtare që është një detyrim dhe përgjegjësi për gjithësecilin prej nesh, tha në fjalën e tij Prefekti i qarkut Gjirokastër.

10.07.2018

Prefekti i qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj ka pritur në një takim të veçantë Ambasadorin e Turqisë në Tiranë z. Murat Ahmet Yörük.

Gjatë këtij takimi Prefekti i qarkut ka vlerësuar kontributin e veçantë të shtetit turk në fusha të ndryshme në gjithë territorin e qarkut si dhe nevojën për vazhdimin e këtij bashkëpunimi

në fushën e arsimit, turizmit, trashëgimisë kulturore, turizmit të agrokulturës dhe biznesit në të gjithë qarkun tonë.

11.07.2018

Prefekti i Qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj ka zhvilluar një takim sqarues me banorët e fshatit Bulo të bashkisë Libohovë, me pjesëmarrjen edhe të Kryetares së Bashkisë Libohovë znj. Luiza Mandi, Administratorit dhe kryepleqësisë ku është diskutuar rreth problemeve të shfaqura me nisjen e proçesit të verifikimit të AMTP-ve nga ana e KVVTP-së Gjirokastër.

Në fjalën e tij Prefekti i qarkut ka evidentuar problemet e këtij proçesi që duhen trajtuar në bashkëpunim me ish-komisionin e ndarjes së tokës, KVVTP-në dhe bashkinë Libohovë duke qënë se proçesi i ndarjes së tokës bujqësore ka filluar vetëm në vitin 2001, pasi deri atëherë ka ekzistuar një marrëveshje bashkëpunimi midis fshatit Bulo dhe një shoqërie greke.

Prefekti i qarkut ka lënë si detyrë të filloj menjëherë depozitimi i dokumentacionit të grumbulluar nga ish-komisioni i ndarjes së tokës dhe vendosja në dispozicion e tij pranë KVVTP-së Gjirokastër.

11.07.2018

Në kishën e Shën Mërisë në Labovën e Kryqit, prefekti i qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj është takuar nga afër me një grup nxënësish amerikanë të moshave 17-18 vjeç të ardhur nga shtete të ndryshme të SHBA-së.

Ky program edukativ 4 javor me qëllimin për të njohur më mirë vendin tonë, organizohet nga Shoqata Experiment Albania me seli në Tiranë. Pjesë integruese e këtij programi është edhe qëndrimi një javor i këtyre nxënësve në familjet libohovite si pjesë e bashkëpunimit të Shoqatës Experiment Albania me Bashkinë Libohovë. Gjatë qëndrimit të tyre, nxënësit do të njihen nga afër me jetën e komunitetit, traditat dhe kulturën e tyre duke vizituar edhe vende të ndryshme historike të qytetit të Gjirokastrës.

12.07.2018

Në institucionin e Prefektit të qarkut Gjirokastër është zhvilluar takimi i rradhës i Organit Këshillues të Prefektit me temë "Marrdhëniet e Prefektit të qarkut me organet dhe institucionet e administratës shtetërore, organet e njësive të vetëqeverisjes vendore, degët territoriale dhe institucione të tjera shtetërore që veprojnë në qark".

Anëtarët e Organit Këshillues kanë diskutuar mbi problematikat që lidhen me marrdhëniet midis këtyre institucioneve, vlerësimin e punës së kryer si dhe kanë bërë propozime konkrete për mbarëvajtjen e bashkëpunimit mes institucioneve, në funksion të përmirësimit të punës dhe shërbimeve që i ofrohen komunitetit.

13.07.2018

Institucioni i Prefektit të qarkut Gjirokastër në bashkëpunim me Shoqatën e Invalidëve Para dhe Tetraplegjikë Gjirokastër ka mbajtur sot tryezën e rrumbullakët me tematikë "Aksesueshmëria për P.A.K në infrastrukturën rrugore & infrastrukturën e godinave që ofrojnë shërbime publike në qarkun Gjirokastër."

Qëllimi i këtij takimi ishte për sensibilizimin mbi legjislacionin që siguron shfrytëzimin e hapësirave publike nga ana e p.ak; ndërgjegjësimin rreth barrierave të ndërtuara nga mosrespektimi i legjislacionit; frenimin e ndërtimeve dhe rikonstruktimeve të hapësirave publike pa standarte për p.a.k në qarkun Gjirokastër; inicimin e marrjes së masave për eliminimin e barrierave në infrastrukturën rrugore dhe në godinat që ofrojnë shërbime për publikun në qarkun Gjirokastër.

Prefekti i qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj theksoi se institucionet shtetërore dhe shoqëria civile duhet t'i kushtojnë vëmendje maksimale krijimit të kushteve thelbësore për integrimin dhe funksionimin e plotë në shoqëri të personave me aftësi të kufizuara. Detyra jonë është të ndihmojmë në ngritjen e mirëqënies së tyre dhe mbulimin e shërbimeve bazë që p.a.k kanë nevojë, tha në fjalën e tij Prefekti i qarkut.

18.07.2018

Prefekti i qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj ka marrë pjesë në ceremoninë e përurimit të bustit të patriotit Bajram Ligu ose siç njihet ndryshe Bajram Prongjia, në fshatin Prongji të bashkisë Gjirokastër, në kuadër të 110 vjetorit të luftës së Mashkullorës.
Bajram Ligu, pjesë e çetës së Çerçiz Topullit ku bashkë me Hito Lekdushin në mars të vitit 1908 në Gjirokastër kryen vrasjen e Binbashit Turk. Ky ishte një aksion që bëri bujë jo vetëm në Gjirokastër por edhe përtej kufijve shqiptarë, duke e lartësuar figurën e Bajram Ligut për të gjithë brezat që do të pasonin.

25.07.2018

Në institucionin e Prefektit të qarkut Gjirokastër është zhvilluar takimi i Komitetit Rajonal të luftës kundër trafikimit të personave. Gjatë këtij takimi është diskutuar në lidhje me marrjen e masave dhe angazhimin e institucioneve në luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore në qarkun Gjirokastër.

Për herë të parë në këtë takim kanë marr pjesë edhe drejtues të institucioneve jo qeveritare pjesë e Unionit "Stop krimit", z. Maksim Fera, Drejtori Egzekutiv Tiranë, z. Ylli Toska, Filiali Durrës, z. Stavri Bobo, filiali Berat dhe z. Arben Hoxha, filiali Gjirokastër.

Në fjalën e tij Prefekti i qarkut z. Astrit Aliaj vlerësoi rezultatet e arritura në këtë drejtim si dhe vuri theksin në instensifikimin e punës së të gjitha institucioneve shtetërore, pjesë e këtij Komiteti, pasi qarku jonë për shkak të pozicionit gjeografik është i ekspozuar më së shumti ndaj këtij fenomeni.

26.07.2018

Në institucionin e Prefektit të qarkut Gjirokastër është zhvilluar mbledhja e jashtëzakonshme e Komisionit të Planifikimit, Përballimit të Emergjencave dhe Krizave për qarkun Gjirokastër. Duke marrë shkas nga situata e rëndë e ndodhur si pasojë e zjarreve të mëdha në shtetin fqinj Greqi, në hapje të këtij takimi Prefekti i qarkut propozoi mbajtjen e një minutë heshtje në nderim të viktimave të kësaj tragjedie. Në vazhdim të takimit, Prefekti i qarkut z. Astrit Aliaj ka vënë në dukje disa problematika të krijuara në qarkun e Gjirokastrës si pasojë e zjarreve.
Në zbatim të planit të masave, Prefekti i qarkut kërkoi angazhimin e të gjitha strukturave shtetërore dhe njësive të vetëqeverisjes vendore për marrjen e masave të nevojshme për menaxhimin e situatave të mundshme që mund të krijohen nga zjarret në pyje dhe kullota. Është konsideruar si domosdoshmëri përshpejtimi i masave tekniko-organizative të strukturave monitoruese dhe vepruese për parandalimin, shmangien dhe minimizimin e dëmeve nga situatat e mundshme emergjente.

26.07.2018

Në institucionin e Prefektit të qarkut Gjirokastër u zhvillua një takim me oficeren e mbrojtjes për UNHCR znj. Lorena Isla dhe me përfaqësues nga UNHCR. Në këtë takim u diskutua për kalimi e paligjshëm të kufirit nga ana e refugjatëve që vijnë nga shtete si: Siria, Pakistani etj. U diskutua për mënyrën e bashkëpunimit në kuadër të përpjekjeve, kalimit të kufijve nga ana e këtyre refugjatëve të cilët duan kalimin në Europë. Si detyrë u la që të miratohet një plan i përgjithshëm ku do të përfshijë një bashkëpunim me Prefekturat. Prefekti i qarkut kërkoi një standartizim të planeve të Njësive të qeverisjes Vendore për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve.

27.07.2018

Prefekti i qarkut Gjirokastër z.Astrit Aliaj zhvilloi një takim me përfaqësues të Autoritetit Rrugor Jugor dhe përfaqësues të firmës Caushi sh.p.k e cila po zbaton fazën e dytë të projektit të shtrirjes së linjës elektrike 20 kw për pjesën e mbetur të qytetit të Gjirokastrës. Gjatë këtij takimi Prefekti kërkoi angazhimin maksimal të firmës që rehabilitimin e plotë të situatës së rrugëve të brendshme dhe kryesore të qytetit. Gjithashtu, ju la si detyrë Autoritetit Rrugor për zgjdhjen përfundimtare të situatës për kujdesjen e bimëve dekorative në rrugët nacionale të qarkut Gjirokastër.

27.07.2018

Prefekti i qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj zhvilloi një takim pune me Drejtorin e Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë Gjirokastër, z. Kostandin Rapi për të diskutuar rreth disa problematikave shqetësuese në drejtim të sigurisë ushqimore. Drejtuesi i Drejtorisë së Bujqësisë kërkoi mbështetjen e institucionit të Prefektit të qarkut për zbatimin e masave profilaktike për vaksinimin e bagëtive të imëta kundër plasjes dhe brucelozës. Nga ana e Prefektit u dha e gjithë mbështetja institucionale për koordinimin e të gjitha veprimeve me njësitë e vetëqeverisjes vendore.

30.07.2018

Më datë 18 qershor 2018 në qytetin e Janinës u zhvillua takimi i parë teknik i të gjithë partnerëve të Projektit THEMA, "Teknologjitë e reja në shërbim të zhvillimit të rrugëve ndër-rajonale tematike", bashkëfinancuar nga "Programi Ndërkufitar INTERREG Greqi - Shqipëri 2014-2020"

Institucioni i Prefektit të qarkut Gjirokastër është partner në këtë projekt së bashku me Agjencinë e Zhvillimit të Epirit, Qendrën për Bashkëpunim dhe Zhvillim Rajonal RCDC dhe Agjensinë Kombëtare të Turizmit në Shqipëri, Shoqatën e Hoteleve të Rajonit të Janinës,. Projekti THEMA synon promovimin e formave kulturore dhe atyre alternative të turizmit në të dy pjesët e zonës ndërkufitare Greqi - Shqipëri, si dhe rritjen e fluksit të turistëve për qëllime të turizmit tematik, nëpërmjet përdorimit të teknologjive të reja dhe inovative.

31.07.2018

Prefekti i qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj ka zhvilluar takimin e punës me Drejtorin të Ujësjellës Kanalizimeve Sh.a. Dropull z. Alqi Kazaqi për problematikat e hasura në Bashkinë Dropull. Nga ana e drejtorit janë raportuar disa probleme si ndarja e aseteve midis dy ndërmarrjeve Ujësjellës Kanalizimeve Sh.a. Libohovë dhe Dropull.
Në përfundim të takimit Prefekti i qarkut Gjirokastër Z.Astrit Aliaj la si detyrë ditën e premte dt.03.08.2018 të zhvillohet në bashkinë Libohovë një takim me kryetarët e bashkive Dropull dhe Libohovë si dhe me përfaqësuesit e Ujësjellës Kanalizimeve Sh.a. të të dy bashkive, për zgjidhjen sa më të shpejtë të problemit të krijuar.

01.08.2018

Në institucionin e Prefektit të qarkut Gjirokastër është zhvilluar një takim pune në lidhje me raportimin mbi situatën epidemiologjike për kafshët në qarkun Gjirokastër si dhe masat e marra për kontrollet e kullotave dhe zbatimi i ligjshmërisë në lidhje me idenifikimin dhe regjistrimin e kafshëve. Në këtë takim morrën pjesë drejtori i Bujqësisë, drejtori i AKU-së, përfaqësues nga Policia Rrugore, përfaqësues nga Drejtoria e Tatimeve si dhe përfaqësues nga Agjencitë e Shërbimit Pyjor pranë njësive të Vetëqeverisjes Vendore.

Gjatë këtij takimi është diskutuar në lidhje me marrjen e masave dhe angazhimin e strukturave përgjegjëse për sigurinë ushqimore. Të gjitha njësitë e Vetëqeverisjes Vendore të bashkëpunojnë me drejtorinë e Bujqësisë dhe agjencitë e saj për vendosjen e detyrimeve ndaj fermerëve dhe blegtorëve në kontratat kullosore për marrjen e çertifikatës veterinare të lëshuar nga veterineri zyrtar dhe të pajisur me çertifikatë elektronike të matrikullimit të kafshës, të lëshuar nga përfaqësuesi i sistemit RUDA.

Në fjalën e tij Prefekti i qarkut z. Astrit Aliaj vlerësoi punën e mirë që është bërë nga strukturat përgjegjëse, ku në fund të takimit janë dhënë disa rekomandime për të rritur në një shkallë më të lartë sigurinë ushqimore në qarkun e Gjirokastrës.

02.08.2018

Prefekti i qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj ka marrë pjesë në ceremoninë e 75-vjetorit të masakrës së Glinës për të përkujtuar e nderuar 28 dëshmorët e rënë heroikisht në luftë nga pushtuesit fashistë italianë të vendosur pranë fshatit Jorgucat të Dropullit të Sipërm. Në këtë ceremoni ishin të pranishëm përfaqësues të Këshillit të qarkut, nënkryetari i bashkisë Dropull, kryetari i veteranëve etj. Prefekti i qarkut z. Aliaj bëri homazhe dhe vendosi kurora nderimi pranë memorialit të të rënëve.

09.08.2018

Në qytetin e Janinës është zhvilluar takimi i parë midis Prefektit të Qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj dhe Prefektit të Rajonit të Epirit z. Aleksandros Kahrimanis me praninë dhe të Konsullit të Përgjithshëm Shqiptar në Janinë z. Pervin Gjikuria.

Në këtë takim Prefekti i qarkut z. Astrit Aliaj falenderoi për ftesën z. Kahrimanis si dhe për kontributin e tij për bashkinë Dropull me një mjet zjarrfikës dhe një mjet pastrimi.

Prefekti Kahrimanis është shprehur se është i gatshëm që së bashku me stafin e tij të kontribuoj në fusha me interesa të përbashkëta si ajo e emergjencave civile, në fushën e turizmit dhe të agroturizmit dhe në realizimin e projekteve me fondet e Bashkimit Europian.

24.08.2018

Në ambientet e Hotel Çajupit është zhvilluar trajnimi i anëtarëve të Komitetit Rajonal dhe Tryezës Teknike Antitrafik, punonjësve të policisë së kufirit dhe emigracionit, punonjësve të Drejtorisë Vendore të Policisë, punonjësve të administratës të Institucionit të Prefektit, përfaqësuesve të Këshillit të qarkut, bashkive, shërbimit social shtetëror dhe organizatave jopublike që veprojnë në territorin e qarkut Gjirokastër.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte ngritja e kapaciteteve të profesionistëve në drejtim të identifikimit, referimit, mbrojtjes dhe asistencës së grupeve vulnerabël të evidentuara në flukset migratore.

Ky trajnim është zhvilluar në kuadër të projektit "Ngritja e kapaciteteve dhe mekanizmat për indentifikimin e grupeve vulnerabël migrantë në Ballkanin Perëndimor", me iniciativën e Koordinatorit Kombëtar për Çështjet e Luftës kundër Trafikimit të Personave në Ministrinë e Brendshme në bashkëpunim me Institucionin e Prefektit të qarkut Gjirokastër dhe Organizatën Ndërkombëtare për Migracionin (IOM).

29.08.2018

Janë zhvilluar respektivisht mbledhjet e Këshillave Bashkiakë Gjirokastër dhe Dropull. Në këto mbledhje ishin të pranishëm Prefekti i qarkut z. Astrit Aliaj dhe përfaqësues të Institucionit të Prefektit Gjirokastër. Në këtë mbledhje në përfundim të shqyrtimit të projektvendimeve sipas tematikës së përcaktuar, këshilltarët diskutuan edhe për problematika të tjera që kishin lidhje kryesisht me marrëdhëniet e qeverisjes vendore me qeverisjen qëndrore. Këshilltarët ngritën shqetësimet e tyre në lidhje me çështje të ndryshme për të cilat konsideronin të nevojshme mbështetjen e qeverisë në funksion të zgjidhjes së tyre dhe

përmirësimit të shërbimeve që i ofrohen komunitetit në këto bashki. Prefekti i qarkut dëgjoi me vëmendje çdo problematikë të ngritur, të cilat do t'i përcjellë pranë institucioneve përkatëse qëndrore.

29.08.2018

Prefekti i qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj, duke marrë shkas nga disa problematika të ngritura nga qytetarët, në mënyrë të veçantë nga banorët e bashkisë Dropull dhe këshilltarët e këshillit të kësaj bashkie, ka organizuar sot një takim me drejtuesit e Zyrës Vendore te Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, ALUIZNI-t dhe juristin e bashkisë Dropull. Të pranishëm në takim ishin punonjës të institucionit të Prefektit si dhe qytetarë të interesuar.

Nga ky takim është arritur në konkluzionin se shumë nga shqetësimet e ngritura do të zgjidhen së shpejti me fillimin e zbatimit te VKM Nr. 442, datë 18.07.2018 "Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë e të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri me 10.08.1991 dhe të truallit funksional të tyre" i cili me procedurat e reja do të sjellë shumë lehtësime për qytetarët.

Nga ana e Prefektit është kërkuar rritje e përgjegjësisë nga ana e të gjitha institucioneve qëndrore në nivel vendor dhe njësive të vetëqeverisjes vendore për ofrimin e ndihmës ndaj qytetarëve, brenda kuadrit ligjor në fuqi, për t'i dhënë zgjidhje problematikave të ngritura prej tyre.

30.08.2018

Prefekti i qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj ka zhvilluar një takim me drejtorin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit për qarkun Gjirokastër.

Drejtori i AKU ka specifikuar arritjet në luftën kundër informalitetit dhe parandalimit të konsumimit të ushqimeve jashtë standarteve si dhe ka parashtruar disa mungesa që kërkojnë mbështetjen e Ministrisë së Bujqësisë, si: mungesën e infrastrukturës mbështetëse për proçedurën e inspektimit si automjete për transportin e trupës inspektuese, automjete frigoriferike për transportin e produkteve të bllokuara dhe pajisje të posaçme për marrjen e mostrave; mungesën e pajisjeve laboratorike për kryerjen analizës për produkte ushqimore të falsifikuara si mjalt, vaj ulliri, prodhime bulmeti (për shtesa bimore, si vaj palme apo niseshte); mosgjetjen e bashkëpunimit me Degën e Doganës Kakavije për të kryer kontrolle

të përbashkëta mbi automjetet e vogla për mallra kontrabandë; mungesat në personel pasi numri aktual i inspektorëve aktual nuk arrin të mbulojë në mënyrë efiçente sigurinë ushqimore për qarkun e Gjirokastrës.

04.09.2018

Në kuadër të fillimit të vitit të ri arsimor 2018-2019, Prefekti i Qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj ka zhvilluar takimin e rradhës me Organin Këshillues pranë Institucionit të Prefektit të qarkut për të analizuar masat e marra nga DAR Gjirokastër dhe ZA Tepelenë e Përmet, mbi fillimin e proçesit mësimor në arsimin bazë të mesëm dhe të lartë. Gjithashtu edhe për analizimin e masave të marra nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore mbi përmirësimin e kushteve në ambientet e shkollave, kopshteve dhe çerdheve.

Të pranishëm në këtë takim ishin Drejtoresha e DAR Gjirokastër znj. Lindita Rova, kryetarja e Bashkisë Libohovë znj. Luiza Mandi, Rektori i Universitetit Eqrem Çabej, z. Bektash Mema dhe anëtarë të tjerë ku janë diskutuar problematikat më kryesore gjatë këtij takimi.

04.09.2018

Prefekti i Qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj ka inspektuar nga afër shkollën e mesme "11 Shkurti" të bashkisë Libohovë ku të pranishëm ishin edhe kryetarja e Bashkisë Libohovë znj. Luiza Mandi dhe drejtoresha e Drejtorisë Arsimore Rajonale znj. Lindita Rova.

Prefekti i qarkut Gjirokastër ka vlerësuar punën e mirë që është bërë nga ana e kësaj bashkie për rregullimin dhe sistemimin e të gjitha shkollave në territorin e bashkisë. Gjithashtu një punë e mirë është bërë edhe për krijimin e terreneve sportive të përshtatshme për zhvillimin në kushte sa më normale të lëndës së edukimit fizik.

06.09.2018

Prefekti i qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj ka zhvilluar një takim kortezie me Konsullin e Përgjithshëm të Shqipërisë në Gjirokastër z. Vasileios Tolios para largimit të tij në përfundim të misionit diplomatik në vendin tonë. Në këtë takim Prefekti i qarkut falenderoi për bashkëpunimin që ka patur gjatë përiudhës të qëndrimit në Shqipëri, ku ka ndihmuar në rritjen e bashkëpunimit ndërkufitar midis dy popujve tanë në fusha si: kulturë, art, turizëm, tregëti etj. Nga ana e tij Konsulli falenderoi për bashkëpunimin e institucioneve në këto fusha duke garantuar që edhe zëvëndësi i tij do të jetë po aq aktiv në realizimin e detyrave si edhe do të ketë një marrëdhënie të mirëfilltë midis dy shteteve tona dhe konkretisht për qarkun e Gjirokastrës.

06.09.2018

Ditën e sotme Prefekti i qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj mori pjesë në inagurimin e hapjes së thertores. Në këtë takim u konkretizuan detyrat e caktuara nga qeveria shqiptare që të jenë në parametrat e rregullave të Bashkimit Europian. Prefekti i qarkut në fjalën e tij falenderoi për nismën e hapjes së kësaj thertoreje me standarte evropiane, të përparuara, me një teknologji që do të garantoi ruajtjen e parametrave të cilësisë së produkteve ushqimore. Ky biznes do të jetë shembull edhe për ngritjen e bizneseve të tjera që do të ndihmojnë në agroturizëm, përpunimin e frutave e perimeve, djathit, nënprodukteve të qumështit duke bërë të mundur daljen jo vetëm në vendin tonë por edhe jashtë kufijve të Shqipërisë.

11.09.2018

MShMS në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Shëndetësisë Gjirokastër po punojnë për përmirësimin e infrastrukturës së Qëndrave Shëndetësore në të gjithë qarkun Gjirokastër.
I janë nënshtruar rikonstruksionit tetë qendra të tilla dhe konkretisht Q.Sh. Petran, Q.Sh. Krahës Q.Sh. Lunxhëri, Q.Sh. Cepo, ambulancat në lagjen “Dunavat”, “Palorto”, “18 Shtatori” dhe ajo e lagjes “11 Janari”.

Në përfundim të punimeve të gjitha këto qëndra do të kompletohen me pajisje bashkëkohore me qëllimin e vetëm, përmirësimin e shërbimit ndaj komunitetit.

Prefekti i Qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj së bashku me drejtorin e Drejtorisë Rajonale të Shëndetësisë z. Shpëtim Novi kanë inspektuar punimet në të gjitha këto qëndra shëndetësore dhe ambulanca si dhe janë lënë detyrat që këto punime të kryhen brenda afatave kohore të përcaktuara dhe standarteve cilësore.

11.09.2018

Prefekti i Qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj së bashku me drejtoreshën e Drejtorisë Arsimore Rajonale Gjirokastër znj. Lindita Rova dhe drejtorin e Drejtorisë Rajonale të Shëndetësisë z. Shpëtim Novi kanë kryer ditën e sotme një inspektim në shkollën 9-vjeçare "Asim Zeneli" mbi masat e marra në mirëmbajtjen e shkollës për fillimin e vitit te ri mësimor.

Pas inspektimit të bërë, Prefekti i Qarkut z. Astrit Aliaj ka zhvilluar një takim me stafin pedagogjik të shkollës ku ju ka uruar një fillim të mbarë dhe të kenë sa më shumë suksese gjatë vitit të ri mësimor 2018-2019, ku gjithashtu krahas realizimit të programit mësimor ti kushtojnë një kujdes të veçantë aktiviteteve kulturore dhe sportive për nxitjen dhe mbështetjen e hobeve të veçanta të shfaqura nga nxënësit përgjatë vitit shkollor. Janë shpërndarë gjithashtu edhe librat mësimor për fëmijët që shkojnë për herë të parë në klasën e parë.

13.09.2018

Prefekti i qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj ka zhvilluar një takim pune me drejtorin e Shëndetin Publik z. Shpëtim Novi, drejtorin e OShEE Gjirokastër z. Robert Lili, drejtoreshën e F.S.D.K.Sh znj. Anxhela Hoxha, N/Kryetarin e bashkisë Gjirokastër z. Vangjel Muço, administratori i Ujësjellës Kanalizimeve Sh.A z. Dhimo Kristidhi si dhe me drejtorët e qëndrave shëndetësore të qarkut Gjirokastër.

Në këtë takim është diskutuar mbi ndihmesën për bashkëpunim që duhet të kenë drejtoria e OShEE dhe drejtoritë e ujësjellës-kanalizimeve për furnizimin e qëndrave shëndetësore me energji elektrike dhe ujë të pijshëm.

Gjithashtu në fjalën e tij drejtori i Shëndetit Publik kërkoi nga ana e përfaqësuesve të bashkive të qarkut bashkëpunim në lidhje me kontratat që duhen të lidhin qëndrat shëndetësore me OShEE dhe ujësjellës-kanalizimeve për arsye mungesë fondesh nga kjo drejtori.

Prefekti i qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj theksoi se nga ana e OShEE dhe Ujësjellës Kanalizimeve nuk duhet të mungoj energjia elektrike dhe uji i pijshëm në asnjë qëndër shëndetësore dhe nga ana e Drejtorisë se Shëndetit Publik të bëhen kontrolle për higjenën dhe profilaksi në ambjentet shkollore.

13.09.2018

Në institucionin e Prefektit të Qarkut Gjirokastër është zhvilluar takimi i punës për verifikimin dhe monitorimin e procesit të riorganizimit të shoqërive të Ujësjellës-Kanalizime. Në këtë takim të drejtuar nga Prefekti i qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj kanë qënë të pranishëm edhe Drejtoresha e Çështjeve Vendore dhe Funksioneve të Deleguara znj. Alma Mele, Këshilltari i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë z. Flauers Shoshi si dhe Administratorët e Shoqërive të Ujësjellës-Kanalizime në të shtatë bashkitë e qarkut Gjirokastër.

Gjatë këtij takimi është diskutuar për regjistrimin në hipotekë të të gjitha asteve dhe territoreve të ujësjellësave që kanë patur në pronësi ish komunat. Takim, ky i cili do të përsëritet në mënyrë periodike midis aktorëve të lartpërmendur.

14.09.2018

Prefekti i Qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj ka marrë pjesë në dhurimin e 10 radiove marrëse-dhënëse në MZSH-në Gjirokastër, donacion ky i mundësuar nga Këshilli i Qarkut Gjirokastër.

17.09.2018

Prefekti i qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj me rastin e fillimit të vitit të ri shkollor 2018-2019 mori pjesë në ceremoninë e ditës së parë të çeljes së procesit mësimor në shkollën e mesme të përgjithshme "11 Shkurti" në Libohovë dhe në disa shkolla të tjera të qarkut.

Në urimin e tij, Prefekti i qarkut fillimisht i është drejtuar fëmijëve që nisin për herë të parë jetën shkollore, sikurse mesuesve të klasave të para që do të përkujdesen për këta filiza të rinj, me të gjithë përgjegjësinë e mësuesit dhe prindit, për të siguruar që këta fëmijë të bëhen e ardhmja e denjë për këtë vend. Gjithashtu ka uruar të gjithë prindërit të cilët do të duhet të jenë mbështetja kryesore që fëmijët të ndjehen të qetë, të sigurt dhe plot besim në rrugën e gjatë të dijes.

Një urim të veçantë Prefekti i qarkut ka përcjell edhe për të gjithë nxënësit e sistemit parauniveristar dhe mësuesit e qarkut Gjirokastër, që përmes punës së tyre plot përkushtim dhe përgjegjshmëri, luajnë rolin jetik për zhvillimin e një shoqërie, duke mundësuar realizimin e objektivave reformuese, frytet e të cilave po ndihen dhe do të ndihen së shpejti në të gjitha nivelet e arsimit.

18.09.2018

Gjatë zhvillimit të ceremonisë së 74-vjetorit të çlirimit të qytetit të Gjirokastrës nga pushtuesit nazi-fashistë. Lufta Nacional Çlirimtare është një epope e lavdishme e historisë tonë, ku të gjitha ato vajza e djem, burra dhe gra që u përfshinë në luftë, ju kundërvunë me heroizëm fashistëve italianë dhe nazistëve gjermanë. Përulemi me respekt përpara heroizmit, luftës dhe sakrificave të dëshmorëve që derdhën gjakun jo vetëm për çlirimin e qytetit tonë por edhe për të gjithë luftëtarët e lirisë që kontribuan në Luftën Antifashiste Nacional Çlirimtare. Është nder dhe detyrim që të përcjellim brez pas brezi vlerat e heronjve që dhanë jetën e tyre për këtë kauzë kaq kuptimplotë dhe jetike. Gjaku dhe vepra e dëshmorëve të atdheut do të nderohet përherë në memorien e të gjithë brezave që do të vijnë.



18.09.2018

Në institucionin e Prefektit të qarkut Gjirokastër është zhvilluar një takim i zgjeruar me pjesëmarrje të drejtuesve të njësive të vetëqeverisjes vendore të qarkut, të Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të qarkut, të drejtuesve të ZVRPP-ve dhe ALUIZNIT, të Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë mbi tokën bujqësore pranë Prefektit të qarkut, për të analizuar punën e bërë për shqyrtimin e vlefshmërise ligjore të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore.

Nisur nga problematikat e shumta në drejtim të krijimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi nga ana e bashkive, mungesa e dokumentacionit të nevojshëm në disa prej këtyre njësive si dhe neglizhenca e punonjësve që kanë të bëjnë drejtperdrejt me krijimin e këtyre titujve, Prefekti i qarkut z. Astrit Aliaj kërkoi me insistim që për periudhën e ngelur të ketë një angazhim të të gjitha institucioneve që marrin pjesë në zinxhirin ligjor të krijimit të titujve të pronësisë për fermerët, në mënyrë që të zbatohen me rigorozitet procedurat e aplikimit dhe të marrjes së certifikatës së pronësisë.

Gjithashtu Prefekti i qarkut nisur edhe nga thjeshtimi i procedurave për krijimin e titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore kërkoi nga kryetarët e bashkive përfundimin brenda afateve kohore të regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi dhe raportimin e tyre për punën e kryer çdo muaj tek Prefekti i qarkut. Në fund të këtij takimi për të gjitha institucionet Prefekti i qarkut ka dhënë edhe rekomandimet përkatëse për sa i përket këtij procesi.

21.09.2018

Me rastin e daljes në pension të punonjësit të institucionit të Prefektit të qarkut Ing. Jorgo Thano është organizuar takimi për mirënjohje ndaj përkushtimit të tij në punë dhe respektin e treguar për të gjithë stafin e institucionit të Prefektit të Qarkut Gjirokastër.

22.09.2018

Prefekti i Qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj ka marrë pjesë në takimin me bashkëpunëtorët lokalë në nismën "Për një drejtësi pa vonesa" në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet. Ky takim është mbështetur nga Ministria e Drejtësisë, OSBE, USAID dhe Ambasada e Austrisë.

22.09.2018

Prefekti i qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj ka organizuar një takim pune në N/Prefekturën Përmet me drejtuesit e institucioneve qëndrore në nivel vendor ku janë trajtuar edhe problemet e evidentuara. Drejtuesit e institucioneve kanë paraqitur problematikat e hasura deri më tani ku nga ana DSHP-së është evidentuar problemi i mospajisjes së disa qëndrave shëndetësore me energji elektrike dhe ujë. Gjithashtu në disa qëndra shëndetësore nuk është zgjidhur ende problemi i pronësisë së tokave.

Nga Zyra Arsimore është ngritur problemi i kujdesit që duhet të tregojnë bashkitë për mirëmbajtjen e objekteve shkollore dhe pajisjen me fikëse zjarri në raste emergjencash.

Nisur nga problemet e parashtruara, Prefekti i qarkut theksoi rëndësinë e zgjidhjes në kohë të ankesave të ardhura nga qytetarët dhe ka kërkuar një angazhim më të madh për dhënien e AMPT-ve të gjithë qytetarëve brenda afatit të përcaktuar.

25.09.2018

Në fshatin Nivicë të bashkisë Tepelenë është mbajtur çelja e eventit “100 Fshatrat” me pjesëmarrjen e Kryeministrit z. Edi Rama, ambasadorit austriak z. Johann Sattler, ambasadorit suedez z. Johan Ndisi, Koordinatorit Kombëtar për Programin “100 Fshatrat”

znj. Elva Margariti dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit z. Aulon Tare.

Gjatë këtij eventi është prezantuar modeli "Zhvillimi Potencial i fshatit Nivicë" nga Dr. Gjergji Islami, profesor në FAU, potenciali i ardhshëm zhvillimor i fshatit, idetë e zhvillimit dhe pikat për ndërhyrje me ide për projektet e reja.

Nivica, fshati mbi 2400 vjecar, ku lulëzimi i tij si qyteti i vetëm ilir i zonës daton rreth shekujve III-I para Krishtit. Si e tillë, Nivica ishte e vetmja qytezë-kështjellë në zonën e Kurveleshit te sipërm. Fshati, si dhe zona përreth, karakterizohet nga natyra, biodiversiteti dhe mikpritja e vendasve. Fshati ka premisa për t'u kthyer në model të një ekonomie rurale të qëndrueshme dhe të begatë, me potencial turistik.

27.09.2018

Nisur nga situata e krijuar në fshatin Mesopotam të bashkisë Finiq në qarkun Vlorë, ku si pasojë e një zjarri masiv u shkaktuan edhe dëme materiale në banesa, institucioni i Prefektit të qarkut ka shprehur gjithë gadishmërinë e strukturave përgjegjëse për të mbështetur komunitetin në situata të tilla në një komunikatë për shtyp.

Falë masave të marra nga strukturat e emergjencave civile dhe sektorët e Mbrojtjes nga Zjarri dhe shpëtimi pranë bashkive të qarkut Gjirokastër, edhe gjatë stinës së verës, është arritur shmangia e zjarreve në pyje dhe kullota duke regjistruar dëme minimale krahasuar me vitet e kaluara.

27.09.2018

Prefekti i qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj ka marrë pjesë në aktivitetin e organizuar nga Bashkia Libohovë "Libohova, Kulturë dhe Agroturizëm" në kuadër të ditës ndërkombëtare të turizmit dhe mbështetjes nga Projekti "Bashkitë për Evropën" të financuar nga Bashkimi Evropian.

Në kuadër edhe të Programit Integral për Zhvillimin Rural "100 fshatrat", në fjalën e tij Prefekti i qarkut është shprehur se "Duhet ta shikojmë të ardhmen në fshat si një të ardhme të lidhur jo thjesht me prodhimin bujqësor në funksion të tregut në ofrimin e produkteve bujqësore por edhe si një zhvillim turistik me bazë bujqësore dhe bazë blegtorale. Dhe për këtë, ne natyrisht, duhet të mbështesim me infrastrukturë, duhet të mbështesim me ndërhyrje për trashëgiminë kulturore rreth e rrotull, duhet të mbështesim me fonde shtesë për të bërë investimin, por gjithmonë kjo vetëm bashkëpunim me ata që duan të punojnë, të zhvillohen dhe që e shikojnë të ardhmen në fshat si një zgjedhje dhe jo detyrim".

08.10.2018

Prefekti i Qarkut Gjirokastër, z. Astrit Aliaj pas një takimi të zhvilluar në Tepelenë, në nënprefekturën Tepelenë, ka zgjedhur për të vizituar një nga bizneset e rrobaqepësisë të hapura së fundmi në këtë qytet. I shoqëruar dhe nga administratori i sipërmarrjes z. Valtid Xhafa, Prefekti i qarkut është njohur me ecurinë e biznesit, zhvillimin e punës dhe menyrën e tregëtimit. Z. Papa ka informuar se aktualisht aty punojnë rreth 30 punonjëse me kohë të plotë si dhe ka kërkesa edhe për 20 të tjera. Kapaciteti prodhues mujor shkon deri në 20 mijë copë, ku përfshihen lloje të ndryshme veshjesh, të cilat paketohen dhe nisen çdo fundjavë. "Jemi duke bërë përpjekje që të hyjmë në treg me "Made in Albania" por do të na duhet edhe një vit kohë për këtë. Shpresojmë t'ia dalim pasi taksat dhe detyrimet që paguajmë ndaj shtetit grek aktualisht janë kosto dyfish për ne" shprehet z. Papa, sipërmarrës i J & Blue Fashion. Kjo kompani prodhon veshje për tregjet spanjolle, italiane, portugeze, angleze dhe greke.

Duke u ndalur tek punësimi, Prefekti i qarkut z. Aliaj ka thënë në fjalën e tij se "Nga çfarë pamë në këtë sipërmarrje, ajo që vlen për tu theksuar është trajnimi profesional, një tjetër ekspansion që ndodh brenda ndërmarrjes dhe mundësia për tu punësuar. Biznesi sot ka më shumë mundësi për të ofruar vende pune. Do të doja të ftoja të gjitha vajzat dhe zonjat e kësaj zone të vinë e të shikojnë mundësinë e punësimit. Falenderoj z. Papa për ndihmën dhe

mundësitë e ofruara kundrejt ekonomisë vendase, uljen e papunësinë dhe rritjen e mirëqënies për shumë familje. Urojmë që ky biznes të ketë sa më shumë sukses".

08.10.2018

Nisur nga ankesa e ardhur nga qytetarë të lagjes Manalat dhe Zinxhira të qytetit të Gjirokastrës drejtuar Prefektit të qarkut, përfaqësues nga ky institucion në bashkëpunim me Inspektoriatin e bashkisë Gjirokastër, inspektuan punimet që kryente firma Çaushi sh.p.k në shtrirjen e rrjetit elektrik 20 kw. Nga inspektimi i punimeve u konstatuan disa mangësi dhe difekte në punën e firmës sipërmarrëse si:

1. Asfalti i hedhur në disa segmente në aspektin vizual ishte i cilësisë jo të mirë, kjo për faktin se gjatë shkeljes thërrmohej.
2. Hedhja dhe nivelimi i shtresës së asfaltit nuk përmbushte kushtet teknike të zbatimit.
3. Në disa pjesë të rrugës mungonin elementët e betonit si edhe kuneta e rrugës që firma e kishte për detyrë ti plotësonte.

Në këto kushte Prefekti i qarkut z. Astrit Aliaj, ka organizuar një takim në ambientet e institucionit të Prefektit, ku morën pjesë përfaqësues nga Bashkia Gjirokastër, drejtori i OSHEE të degës Gjirokastër si dhe administratori i firmës Çaushi sh.p.k. z. Enver Çaushi. Në këtë takim u diskutua lidhur mbi realizimin e punimeve nga ana e firmës si dhe plotësimin e kushteve teknike të zbatimit të këtyre punimeve. Në këtë kontekst firma mori përsipër të realizoj të gjitha detyrimet e parashikuara në kontratën e bërë me investitorin. Gjithashtu, për shqetësimet e krijuara në komunitet për sa i përket cilësisë së dobët të punimeve, firma Çaushi sh.p.k do të kryej riparimet e duhura brenda një kohe shumë të shkurtër dhe do kthej objektin në gjendjen e mëparshme.

Në përfundim të këtij takimi, Prefekti i qarkut kërkoi mobilizim dhe bashkëpunim më të mirë të firmës me komunitetin dhe me organet e vetëqeverisjes vendore për një mbarëvajtje më cilësore të punës deri në përfundimin e plotë të projektit.

15.10.2018

Në ditën e Pelegrinazhit tradicional, me shumë mirënjohje është përkujtuar 110 vjetori i çeljes së shkollës së parë në gjuhën shqipe në teqenë bektashiane të Koshtanit, në bashkinë Memaliaj. Prefekti i qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj ka falenderuar dhe përgëzuar organizatorët për aktivitetin e zhvilluar dhe në veçanti Kryegjyshin Botëror të Bektashinjve, Hirësinë e tij Haxhi Dede Edmond Brahimaj. Shkolla e Koshtanit lindi, mbijetoi dhe u rrit

cilësisht jo vetëm falë rolit të madh të Baba Ahmetit, mësuesve të përkushtuar dhe klerikëve të Tepelenës por edhe falë kontributit të Petro Nini Luarasit, Babë Dudë Karbunarës e të shumë figurave patriotike të kohës. Qarku i Gjirokastrës dhe veçanërisht qyteti i Memaliaj e Tepelenës, krenohen me këtë shkollë dhe vendimet e rëndësishme që mori Kongresi i Koshtanit.

15.10.2018

Prefekti i qarkut z. Astrit Aliaj ka shprehur urimet më të mira për vitin e ri akademik 2018 – 2019. Një vit i ri sa më i suksesshëm dhe i mbushur plot me sfida për arritjen e objektivave dhe ngritjen profesionale të stafit të pedagogëve si dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies me metodat bashkëkohore.

Gjithashtu Prefekti i qarkut ka shprehur të gjithë predispozicionin duke përdorur autoritetin që i jep ligji për të bërë të mundur realizimin e të gjitha problematikave që ka sot universiteti "Eqrem Çabej" në mënyrë që ky universitet me traditë shumëvjeçare dhe eksperiencë maksimale në të gjitha degët por sidomos në degët tradicionale, ato të mësuesisë, të kthehet në një korpus universitar jo vetëm për qarkun Gjirokastër por edhe për rajonin e më gjerë.

17.10.2018

Prefekti i qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj së bashku me Drejtorin e Drejtorisë Rajonale të Monumenteve të Kulturës Gjirokastër z. Albert Kasi dhe Drejtorin e Teatrit pranë Bashkisë Gjirokastër z. Kudret Alikaj, kanë vizituar ditën e sotme "Muzeun e Rilindasve" në lagjen "Dunavat" të qytetit të Gjirokastrës për të parë nga afër gjendjen dhe për të diskutuar për mundësitë reale të kthimit në identitet të këtij muzeu.

Kjo shtëpi muze, e ndërtuar në shtëpinë e Bajo dhe Çerciz Topullit, është inaguruar në vitin 1967 dhe deri në vitin 1993 ka funksionuar si Muze i Rilindasve, me vlera të mëdha historike të ruajtuara nëpër breza nga familja Topulli.

Prefekti i qarkut z. Astrit Aliaj ka kërkuar mbështetjen e strukturave shtetërore dhe kontributin e subjekteve private për rikthimin e vlerave të këtij muzeu si një aset i rëndësishëm turistik për vizitorët vendas dhe të huaj.

17.10.2018

Prefekti i qarkut z. Astrit Aliaj ka zhvilluar një takim me përfaqësuesin e pakicës rome dhe egjiptiane në qarkun e Gjirokastrës z. Gramoz Braho.

Z. Braho ka kërkuar bashkëpunimin e institucionit të Prefektit për njohjen nga ana e institucioneve përgjegjëse në qark të detyrimeve që lindin nga "Plani kombëtar i veprimit për integrimin e romëve dhe egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë, 2016 - 2020" miratuar me VKM nr. 1072, datë 23.12.2015. Prefekti u angazhua për të organizuar shumë shpejt një takim me drejtuesit e institucioneve për të kërkuar nga ana e tyre, marrjen e masave në zbatim të detyrimeve konkrete që përcaktohen në këtë plan veprimi.

18.10.2018

Në Institucionin e Prefektit të qarkut Gjirokastër është zhvilluar takimi i rradhës i Organit Këshillues të Prefektit me temë "Marrja e masave paraprake nga ana e njësive të vetëqeverisjes vendore, degëve territoriale dhe strukturave shtetërore të Prefekturës së Qarkut Gjirokastër, për përballimin e situatave emergjente për periudhën vjeshtë - dimër 2018 - 2019". Në këtë takim u zhvillua një analizë e plotë e situatës së emergjencave civile në qarkun e Gjirokastrës (përmbytjet dhe zjarret) për periudhën dhjetor 2017 - tetor 2018 si dhe marrja e masave paraprake për përballimin e emergjencave të pritshme për periudhën vjeshtë - dimër 2018 - 2019. Në këtë takim morën pjesë Drejtori i Përgjithshëm i Emergjencave Civile dhe Krizave në Ministrinë e Mbrojtjes z. Haki Çako, drejtues të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe institucioneve shtetërore të qarkut Gjirokastër.

18.10.2018

Prefekti i qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj organizoi një takim me pjesëmarrjen e Drejtorit të Zonave të Mbrojtura Gjirokastër z. Gligor Dushi dhe përgjegjësit e sektorëve të institucionit. Në këtë takim u diskutua për VKM 593 dt 9.10.2018 për "Përbërjen, funksionet, detyrat dhe përgjegjësit e Komiteteve të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura Mjedisore.

Në këtë takim Prefekti i qarkut si drejtues i Komitetit të Menaxhimit vendosi që nga ana jonë të pregatitet shkresa për të gjitha institucionet që parashikon vendimi për të dërguar emrat e përfaqësuesve të tyre në përbërje të Komitetit të Zonave të Mbrojtura.
Në përfundim të takimit u la që në javën e parë të muajt dhjetor të bëhet takimi i parë i këtij Komiteti pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut.

29.10.2018

Në funksion të procesit të krijimit të regjistrit kombëtar të pyjeve dhe kullotave fond i cili ka kaluar në pronësi të bashkive, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është duke ndërmjetësuar takime dypalëshe midis bashkive të cilat kanë konflikt ndërmjet tyre për menaxhimin/pronësinë e disa sipërfaqeve pyjore/kullosore të cilat sipas VKM-se Nr. 433 i përkasin njërës bashki dhe sipas kufirit administrativ të vendosur me reformën territoriale i përkasin bashkisë fqinjë.

Për të zgjidhur këto problematika, janë zhvilluar në institucionin e Prefektit të qarkut Gjirokastër, takimet midis zyrtarëve të lartë të bashkisë Gjirokastër dhe Dropull si dhe të bashkisë Gjirokastër dhe atyre të bashkisë Libohovë, me ndërmjetësinë e zyrtarëve të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, nën drejtimin e zëvendës ministres znj. Çuçi, në prezencë të Prefektit të Qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj dhe Kryetarit të Këshillit të Qarkut Gjirokastër z. Armand Hilaj.

Në takim u dakortësua ndërmjet kryetarëve të bashkive në konflikt për të finalizuar listat e azhornuara të inventarit të pasurive pyje dhe kullota në pronësi të bashkive respektive dhe miratimi i tyre pranë këshillave bashkiake në mbështetje të procesit të regjistrimit të këtyre pasurive kombëtare.

01.11.2018

Në institucionin e Prefektit të qarkut Gjirokastër është zhvilluar Analiza e Sezonit Turistik për vitin 2018 në qarkun e Gjirokastrës dhe masat që do të merren për periudhën në vazhdim. Në zbatim të detyrave të Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit dhe nga informacionet e dërguara, rezulton se është punuar me përkushtim nga të gjithë aktorët kryesorë për marrjen e masave dhe zbatimin e detyrave përkatëse për mikpritjen e turistëve vendas dhe të huaj që vizitojnë rajonin tonë, kjo falë edhe një bashkëpunimi të suksesshëm midis strukturave pjesëmarrëse për zhvillimin e turizmit.

Këtë vit turizmi ka shënuar një rritje të konsiderueshme. Për periudhën janar – shtator rreth 150.737 vizitorë vendas dhe të huaj kanë vizituar qarkun tonë, shifra këto që kontribuan ndjeshëm në rritjen vjetore ekonomike të qarkut. Turizmi kështu rikonfirmohet si nxitësi kryesor i rritjes së ekonomisë së qarkut.

"Evidentimi i të gjithë problematikave pa harruar asnjë, tregon që kemi shumë hapësira për menaxhim, organizim dhe për ti dhënë njerëzve bindjen që turizmi është një mundësi reale për një jetë më të mirë. Në qarkun e Gjirokastrës ekzistojnë të gjithë komponentët e asaj çfarë ne duam të bëjmë për turizmin në Shqipëri. Një falenderim të veçantë dua të bëj për të gjithë administratorët e njësive akomoduese të hotelerive, restoranteve, bujtinave si dhe të gjithë aktorët kryesorë në zhvillimin e turizmit, për kontributin e pa zëvendësueshëm që kanë dhënë në shërbimin dhe promovimin e vlerave të pazëvendësueshme që ka qarku ynë" tha në fjalën e tij Prefekti i qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj.

09.11.2018

Në Institucionin e Prefektit të qarkut Gjirokastër është zhvilluar një vizitë pune nga të dymbëdhjetë Prefektët e qarqeve të Republikës së Shqipërisë. Fillimisht, ata janë pritur nga Prefekti i qarkut Gjirokastër z.Astrit Aliaj i cili i'u uroi mirëseardhjen dhe më pas për ta u prezantua një material informues i punuar nga specialistë të administratës së Prefektit në lidhje me të dhënat, resurset, historinë, kulturën, traditën, trashëgiminë në të gjithë qarkun Gjirokastër.
Më pas Prefektët kanë zhvilluar vizita në disa prej muzeve të qytetit të Gjirokastrës. Gjatë këtyre vizitave në mënyrë simbolike janë mbjellë disa pemë ku një prej të cilave afër kalasë së qytetit u quajt "Pema e Prefektëve". Në ditën e dytë të vizitës ata shkuan në qytetin e Përmetit ku janë pritur nga Kryetari i Bashkisë Përmet, i cili ju ka uruar mirëseardhjen në këtë qytet. Më pas janë zhvilluar vizita në Gurin turistik të Përmetit, në disa biznese të prodhimit të glikove të famshme të Përmetit dhe në fund një vizitë në ujrat termale të Bënjës. Vizita e tyre 2 ditore ishte një eksperiencë e vyer për të njohur nga afër vlerat kulturore,

historike dhe monumentet e trashëgimisë kulturore në të gjithë qarkun tonë dhe për promovimin e tyre të mëtejshëm.

13.11.2018

Nisur nga problematikat e krijuara në liqenin e Viroit gjatë periudhës së dimrit të kaluar, Prefekti i qarkut Gjirokastër zhvilloi një vizitë në këtë liqen për të parë nga afër masat që duhen marrë për mospërsëritjen e përmbytjeve në rrugën kryesore Gjirokastër - Tepelenë, km 3 pranë liqenit të Viroit.

Nga vizita në terren u konkludua në marrjen e disa masave si hapjen e shkarkuesit sipërfaqësor duke hequr shandorët, si dhe me ndërhyrjen e një mjeti gërmues për hapjen e shkarkuesit në trupin e rrugës. Njëkohësisht u kontaktua edhe me inxhinierin e firmës së mirëmbajtjes së rrugës i cili premtoi që shumë shpejt do të filloj ndërtimi i murit të gurit që kufizon rrugën nacionale me pasqyrën ujore të liqenit të Viroit.

15.11.2018

Prefekti i qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj ka pritur ditën e sotme në ambientet e këtij institucioni, trupën e teatrit të Vlorës "Petro Marko" për ti falenderuar personalisht, edhe në emër të publikut gjirokastrit, për emocionet e përcjella me vënien në skenë, ditën e djeshme, të komedisë "Sundimi Gruas".

15.11.2018

Në institucionin e Prefektit të qarkut Gjirokastër u zhvillua një takim me Drejtues të Policisë Gjirokastër për marrjen e masave të sigurisë në vend. Prefekti i qarkut z. Astrit Aliaj falenderoi drejtuesit e institucioneve që merren me sigurinë. Në këtë takim u diskutua për kontrollin mbi territorin nga ana e policisë, veshjen, prezencën e punonjësve të policisë në pikat kufitare.



16.11.2018

Institucioni i Prefektit të qarkut Gjirokastër ka realizuar hartimin dhe botimin e librit "Trembëdhjetë petalet e para në buqetën rurale", një material informativ për 13 fshatrat turistike të qarkut Gjirokastër të përfshira në Programin e Integruar për Zhvillimin Rural i cili synon të koordinoj ndërhyrjet zhvillimore në hapësirat rurale.

PIZHR do të programoj ndërhyrjet me investime të integruara në zonat e përcaktuara nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës publike, zhvillimit ekonomik dhe zhvillimit të kapitalit social e njerëzor.



"Në një vështrim panoramik, peisazhet rurale gërshetojnë vlera pa fund, vlera kulturore të papërsëritshme por edhe mundësi reale sociale, që kërkonin vizionet e që tashmë po u afrohen me përkushtim e me vendosmëri nga tërë aktorët e faktorët e Shqipërisë që po rilind e transformohet.
Përvojat, arritjet e djeshme, me këtë program ambicioz do të shënojnë më shumë rritje, maja mirëqënieje për mjedisin jetik rural e më gjerë, të krijuara me duart e mendjet e tyre por pa dyshim me shtysën e inkurajimin e Qeverisë Shqiptare" ka thënë në fjalën e tij përshëndetëse Prefekti i qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj.

20.11.2018

Prefekti i qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj së bashku me drejtoreshën e Drejtorisë Arsimore Rajonale znj. Lindita Rova, kanë vizituar shkollën 9- vjeçare "Koto Hoxhi" ku u takuan me nxënësit për të dhuruar libra dhe për të lexuar bashkë me ta. Prefekti i qarkut shprehu gjithë mbështetjen e tij për organizimin e takimeve të shpeshta të cilat kanë një rëndësi të veçantë në edukimin e fëmijëve për ta bërë librin nje mik të vërtetë. "T'iu lemë librin amanet dhe ata do të dinë të bëhen të pasur! Prandaj do te takohemi për një liber çdo ditë sepse beteja me padijen është e gjatë dhe e vështirë."

21.11.2018

Në ambjentet e teatrit "Zihni Sako" Gjirokastër është vënë në skenë poema dramatike "Gjergj Kastrioti Skënderbeu". Kjo shfaqje u oragnizua në kuadër të vitit të Skënderbeut, me mbështetjen e Institucionit të Prefektit të qarkut Gjirokastër dhe nën kujdesin e veçantë të Prefektit të qarkut z. Astrit Aliaj.
Në fund të shfaqjes Prefekti i Qarkut i dhuroi aktorit të famshëm shqiptaro-amerikan z. Xhevat Limanit një pllakë guri që simbolizonte qytetin e Gjirokastrës.

22.11.2018

Prefekti i qarkut z. Astrit Aliaj, ka organizuar një takim me drejtorin e Drejtorisë Vendore të Policisë dhe drejtues të ISHSH Dega Rajonale Gjirokastër dhe Degës Rajonale të ISHMPUT Gjirokastër ku u raportua mbi rezultatet e deritanishme të zbatimit të legjislacionit për problematika të ndryshme si: mbrojtja e shëndetit nga produktet e duhanit, menaxhimi i mbetjeve urbane dhe spitalore, prerja e pyjeve pa kriter dhe gjuetia e paligjshme.
Në fund të takimit z. Aliaj kërkoi nga drejtuesit zbatimin me përpikmëri të detyrave që përcakton ligji, bashkëpunim ndërinstitucional, marrjen e masave konkrete dhe tolerancë zero kundër këtyre fenomeneve.

22.11.2018

Prefekti i qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj ka pritur në ambjentet e Institucionit të Prefektit bizesmenin e firmës Cotex që zhvillon biznesin e tij për tekstile, ku ka mbi 100 punonjës në qarkun e Gjirokastrës dhe 150 në Tiranë. Në këtë takim të dyja palët shkëmbyen mendime për përmirësimin e punës në biznes kryesisht nga ana e Bashkisë Gjirokastër si dhe për mos ndërprerjen e energjisë elektrike nga OSHEE-së. Nga ana e tij Prefekti i qarkut siguroi një

ndërmjetësim për mos ndërprerjen e energjisë elektrike në biznesin e tij dhe një komunikim me Bashkinë Gjirokastër për heqjen e mbeturinave, për një pastërti si detyrim i Bashkisë duke qënë se paguhen të gjitha detyrimet ndaj saj.

23.11.2018

Institucioni i Prefektit të Qarkut në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore rajonale, morën pjesë në aktivitetin e organizuar nga shkolla 9 vjeçare "Koto Hoxhi" me rastin e festave kombëtare të 28 - 29 Nëntorit.
Prefekti i qarkut në mënyrë simbolike iu ka dhuruar nxënësve të klasës së pestë një pako me flamurin kombëtar, flamurin e Bashkimit Evropian dhe një disk me himnin kombëtar dhe atë të Bashkimit Evropian. Kjo dhuratë është në kujtim të një dite të rëndësishme siç është ajo e Pavarësisë dhe ngritjes së flamurit në Vlorë. Në fjalën e tij Prefekti i Qarkut theksoi që flamuri kombëtar të mos mbetet një send simbolik por të shpaloset në çdo festë kombëtare.

27.11.2018

Është zhvilluar në ambjentet e institucionit të Prefektit të qarkut Gjirokastër një takim pune me drejtues të degëve territoriale dhe institucioneve shtetërore në nivel vendor me fokus në çështjet si më poshtë:

- Gadishmëria institucionale për përballimin e emergjencave civile për periudhën e dimrit.
- Standartizimi i dokumentacionit shtetëror për të gjitha institucionet (shkresa, urdhra, vendime etj.) bazuar në vendimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave.
- Zbatimi i ceremonialit shtetëror në të gjitha institucionet shtetërore dhe pjesëmarrja e tyre në të gjitha aktivitetet që zhvillohen me rastin e festave kombëtare.

Në fund të takimit Prefekti i Qarkut dha rekomandimet për çështjet që u diskutuan si vendosja e flamurit kombëtar në të gjitha institucionet shtetërore, respektimi i afateve ligjore në kthimin e përgjigjeve të shkresave zyrtare si dhe raportimi periodik i veprimtarisë së tyre pranë institucionit të Prefektit të Qarkut.

28.11.2018

28 Nëntori – Dita e Flamurit, festa që bashkon shqiptarët anë e mbanë botës, festa që i bën një të gjithë shqiptarët. Prandaj është e udhës që për këtë datë të rëndësishme kombëtare, të bashkohemi të gjithë për ta festuar në gji të flamurit të Skënderbeut, duke udhëtuar në retrospektivë, duke kujtuar personalitetet dhe veprat e tyre, të cilat kanë bërë që ne sot të gëzojmë gjuhën, flamurin, shtetin dhe identitetin kombëtar të pacënuar.

29.11.2018

74-vjetori i Çlirimit të Atdheut!
Urimi i parë ka shkuar për 29 Nëntorin, këtë datë të shënuar për të gjithë shqiptarët. Prefekti i qarkut z. Astrit Aliaj e vlerësoi këtë ditë si ditën e përvjetorit të çlirimit dhe të fitores së Aleancës së shqiptarëve me antifashizmin.

04.12.2018

Është festuar 106-vjetori i ngritjes së flamurit kuq e zi në bedenat shekullore të kalasë Gjirokastër. Ky flamur është ngritur nga patriotët gjirokastritë me në krye patritotin Hasan Xhikun të cilët e hapën edhe më tej lajmin e pavarësisë.
Kjo ditë e bekuar përkon me 65 vjetorin e shfaqes së filmit të heroit tonë kombëtar "Skëndërbeu" i interpretuar nga artisti gjenial sovjetik Akaki Horava. Një emocion të veçantë solli prezenca e motrës së Skëndërbeut, Znj. Adivie Alibali në rolin e Mamicës, e cila u vlerësua me titullin "Nderi i Qarkut" nga Këshilli i Qarkut Gjirokastër. Ky titull u dha edhe pas vdekjes për aktorin Akaki Horava, në rolin e heroit tonë kombëtar Skëndërbeu.
Me këtë rast janë zhvilluar disa aktivitete si ngritja e flamurit, vizitë tek kulla e sahatit, ekspozitë fotografike, dokumentari "Gjirokastra dhe Skëndërbeu", akordimi i titujve të nderit dhe ne fund homazhe tek memoriali i Skëndërbeut.

05.12.2018

Në institucionin e Prefektit të Qarkut Gjirokastër është zhvilluar një takim me përfaqësuesen e Shell/Blloku 4. Gjatë këtij takimi u diskutua në lidhje me organizimin e dëgjesave publike që do mbahen në muajin janar me institucionet rajonale publike, njësitë e qeverisjes vendore, komunitet ku do realizohet studimi sizmiologjik dhe organizatat e shoqërisë civile.

11.12.2018

Në institucionin e Prefektit të qarkut Gjirokastër është zhvilluar ditën e sotme takimi i punës me Drejtorin e Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura z. Gligor Dushi për të diskutuar mbi veprimtarinë që do të ushtrohet nga Komiteti i Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.593 datë 9.10.2018 "Për përbërjen, funksionet, detyrat dhe përgjegjësitë e Komiteteve të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura Mjedisore". Gjatë këtij takimi u përcaktua data e mbledhjes së parë, ku do të bëhet edhe prezantimi i të gjithë antarëve të këtij komiteti dhe njohja e tyre me rregulloren dhe zonat e mbrojtura që shtrihen në territorin e qarkut të Gjirokastrës.

11.12.2018

Në institucionin e Prefektit të qarkut Gjirokastër është zhvilluar takimi i punës me pjesëmarrjen e punonjësve të zyrave të gjendjeve civile dhe zyrave të urbanistikës të qarkut Gjirokastër, me tematikë mbi përfundimin e projektit të adresarit dhe popullimit.
Gjatë këtij takimi pjesëmarrësit diskutuan mbi punën e bërë nga institucionet vendore për plotësimin e regjistrit vendor të adresave, emërtimin e rrugëve, shesheve, bulevardeve si dhe për vendosjen e numrave kodifikues në godinat e banimit në zbatim të ligjit nr. 9270 datë 29.07.2004 "Për sistemin e adresave" i ndryshuar.
Në përfundim të takimit Prefekti i qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj theksoi ndjekjen me seriozitet nga ana e zyrave të gjendjeve civile dhe zyrave të urbanistikës, plotësimin e regjistrit vendor të adresave dhe raportimin periodikisht nga ana e këtyre institucioneve, pranë Prefektit të qarkut brenda muajit shkurt 2019.

15.12.2018

Në vijim të zbatimit të Projektit THEMA, institucioni i Prefektit të qarkut Gjirokastër së bashku me partnerët e tjerë të kësaj nisme ndërkufitare, ka realizuar turin e dytë studimor në qarkun e Gjirokastrës me qëllim promovimin e identiteteve kulturore dhe turistike nëpërmjet teknologjive të reja në shërbim të zhvillimit të rrugëve tematike në rajonin ndërkufitar Greqi-Shqipëri.

Partnerët e Projektit THEMA, Agjencia e Zhvillimit të Epirit, Qendra për Bashkëpunim dhe Zhvillim Rajonal RCDC, institucioni i Prefekti të qarkut Gjirokastër, Agjencia Kombëtare e Turizmit në Shqipëri dhe Shoqata e Hoteleve të Rajonit të Janinës kanë vizituar javën e parë të muajit dhjetor kalanë e Gjirokastrës, qytetin e lashtë të Antigonesë, Libohovën, Peshtanin, Përmetin, ujërat termale në Bënjë dhe Piskovën, duke parë nga afër potencialin turistik që ofrojnë këto vende me trashëgiminë, historinë, natyrën dhe kulturën që mbartin. Projekti THEMA, partner udhëheqës i të cilit është Agjencia e Zhvillimit të Epirit, financohet nga Programi Europian INTERREG IPA CBC "Greqi-Shqipëri 2014-2020, me fonde të Bashkimit Europian dhe burime kombëtare të të dy vendeve partnere.

20.12.2018

Prefekti i qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj priti në ambjentet e Institucionit të Prefektit profesorë të Universitetit të Firences dhe të Universitetit të Zonjës së Këshillit të Mirë, Tiranë, të cilët kanë marrëdhënie bashkëpunimi përsa i përket fushës së Arkitekturës. Në këtë kuadër profesorë Italianë dhe student të Universitetit Zonja e Këshillit të Mirë po bëjnë

rilevimin e disa banesave karakteristike, monumenteve kulturore në Gjirokastër duke qënë së arkitektura e ndërtimit të këtij qyteti është pjesë e studimeve të këtyre Universiteteve.

20.12.2018

Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional Prefekti i Qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj ka zhvilluar një takim pune me homologun e tij Prefektin e Qarkut Fier z. Baki Bala. Gjatë këtij takimi pune përpos diskutimit të problematikave të përbashkëta institucionale, është rënë dakort edhe për shkëmbim eksperiencash të nëpunësve të këtyre dy institucioneve.

21.12.2018

Prefekti i qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj është vlerësuar në ambientet e Muzeut Kombëtar në Tiranë me titullin e lartë pegasian "Veprimtar i shquar kombëtar" për vitin 2018, vitin e Skënderbeut. Vlerësim i dhënë me motivacionin si një kuadro model vizionar për progresin shoqëror, i shquar në ideimin, organizimin dhe zhvillimin kualitativ të veprimtarive historike, kulturore dhe arsimore në vitin e kryeheroit të kombit shqiptar, Gjergj Kastriot Skënderbeut".

26.12.2018

Në kuadër të masave të marra për mbarëvajtjen e festave të fundvitit Prefekti i qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj ka mbledhur në një takim pune drejtues të degëve territoriale dhe institucioneve shtetërore në nivel vendor, ku përpos raportimeve të bëra nga ana e tyre, është përqëndruar vëmendja edhe për realizimin në mënyrë rigoroze të masave që duhet të marrë çdo institucion për garantimin e rendit, sigurisë publike, sigurisë rrugore etj.

27.12.2018

Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) në Gjirokastër ka zhvilluar një aktivitet të veçantë. Përveç qytetarëve që kishin shkuar për shërbime të ndryshme, në ambientet e këtij institucioni ishte organizuar edhe një festë për fëmijët në nevojë duke iu shpërndanë dhurata të ndryshme me rastin e festave të fundvitit nga drejtoresha Marsida Xarba. E pranishme ishte edhe deputetja e qarkut znj.Mirela Kumbaro si dhe Prefekti i Qarkut z.Astrit Aliaj. Znj. Kumbaro ka dhuruar libra për fëmijët duke zgjodhur të lexoj për ata disa pjesë nga libri 'Princi i Lumtur'.

28.12.2018

Federata Universale e Paqes ka nderuar me titullin Ambasador për Paqen, Prefektin e qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj, në një ceremoni të zhvilluar në ambientet e institucionit të

Prefektit të qarkut, sëbashku me ambasadorët e nderuar në këtë ditë të veçantë kushtuar vlerave morale universale.

Federata Universale e Paqes njeh si Ambasadorë për Paqen ata individë, jeta e të cilëve personifikon idealin e jetesës për hir të të tjerëve dhe që i kushtohen praktikave që nxisin vlerat morale universale, jetën e fortë familjare, bashkëpunimin ndërfetar, harmoninë ndërkombëtare, rinovimin e Kombeve të Bashkuara, një figurë publike të përgjegjshme dhe themelimin e një kulture paqësore. Duke tejkaluar barrierat racore, kombëtare dhe fetare, Ambasadorët për Paqen kontribuojnë në përmbushjen e shpresës së të gjitha moshave, një bote të unifikuar të paqes ku dimensionet shpirtërore dhe materiale të jetës janë të harmonizuara.

29.12.2018

Në emërimin e Nënprefektit të ri të Përmetit z. Edvin Tuçi ishin të pranishëm Prefekti i qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj, Ministrja e Kulturës znj. Mirela Kumbaro si dhe kryebashkiaku z. Niko Shupuli. Emërimi i nënprefektit të ri është bërë nga Ministri i Brendshëm z. Sandër Lleshaj pas daljes në pension të ish-nënprefektit z. Anastas Naqe.

FJALIMET PËRSHËNDETËSE TË PREFEKTIT TË QARKUT GJIROKASTËR

15.11.2017

Takimi i "Komisionit të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave të Qarkut Gjirokastër"

Ky takim zhvillohet me anëtarët e Komisionit të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave, për të informuar lidhur me masat e marra nga ana e institucioneve të administratës shtetërore, organet e njësive të vetëqeverisjes vendore, degët territoriale që veprojnë në qark dhe institucionet e tjera shtetërore si dhe për të analizuar e diskutuar lidhur me angazhimin e tyre në marrjen e masave teknike dhe organizative për tu përgjigjur në kohë dhe me efektivitet të lartë situatave emergjente që mund të krijohen si rezultat i kushteve atmosferike dhe fatkeqësive të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore.

Në bazë të ligjit nr. 8756/2001 "Për Emergjencat Civile" të gjitha organet shtetërore janë përgjegjëse për parandalimin, përballimin dhe riaftësimin e pasojave të shkaktuara në rast emergjencash civile. Prandaj, sturkturat e planizuara dhe ngritura për përballimin e emergjencave civile duhet të funksionojnë jo vetëm në nivel qarku në rastet e emergjencave dhe situatave të jashtëzakonshme por duhet që çdo institucion duke filluar nga njësitë administrative, bashkitë dhe të gjitha institucionet shtetërore të përgjigjen në çdo rast fatkeqësie të mundshme edhe në skajin më të largët të qarkut. Kjo kërkon njohje të terrenit, problematikave dhe marrjen e masave për parandalimin, përballimin e emergjencës së shfaqur dhe minimizimin e pasojave që mund të sjellin fatkeqësitë e mundshme.

Në Qarkun e Gjirokastrës ka një eksperiencë të mirë në funksionimin e Komisionit të Përballimit të Emergjencave në rang Qarku e cila ka funksionuar me efektivitet në përballimin e situatave të krijuara në mënyrë të veçantë në rastet e zjarreve gjatë stinës së verës dhe përmbytjeve e inondatave në stinën e dimrit. Do të vija në dukje punën e mirë të bërë nga Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe shpëtimi pranë bashkisë Gjirokastër në përballimin e situatës së zjarreve gjatë verës që shkoi si dhe forcat e Detashmentit të Mbështetjes Rajonale të cilët i falenderoj për punën e bërë dhe njëkohësisht i inkurajoj që kjo eksperiencë të shërbej si stimul edhe për strukturat e tjera në qarkun tonë.

Nisur nga kërkesa jonë me shkresën nr.1792 prot, datë 17.10.2017 ku kërkohet "Raport mbi vlerësimin e situatave dhe nevojave si dhe marrjen e masave parandaluese dhe mbrojtëse për përballimin e situatave emergjente" si dhe me shkresën e dytë ku njoftohet dhe kërkohet përsëri informacion, rezulton se jo nga të gjitha institucionet ka ardhur materiali informues i kërkuar, por edhe ato që kanë ardhur janë me mangësi, për të cilat ju kërkoj të na informoni në mënyrë më të hollësishme në diskutimin tuaj.

Në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Planifikimit dhe përballimit të Emergjencave dhe Krizave, në diskutimet tuaja do të kërkoja:

1. Bashkëpunim dhe komunikim të vazhdueshëm.
2. Informim në mënyrë periodike të institucionit të Prefektit për çdo situatë të krijuar edhe në njësinë më të largët.
3. Angazhim të plotë të strukturave dhe ndërhyrje të menjëhershme në rastet kur do të kemi situata emergjente të mundshme. Me këtë rast do të theksoja se kemi detyrimin ligjor ndaj komunitetit që në çdo situatë tu qëndrojmë pranë dhe të zgjidhim në një kohë sa më të shkurtër problematikat e shfaqura.

4. Raportimin nga ana e bashkive lidhur me planifikimin dhe harxhimin e fondit të planifikuar për emergjencat civile.
5. Të raportohet në mënyrë të hollësishme në lidhje me asetet dhe kapacitetet operacionale si dhe gjendjen e tyre.
6. Të raportohet mbi gatishmërinë e sistemit kullues dhe të rezervuarëve ujitës që janë në administrim të njësive të vetëqeverisjes vendore.
7. Rishikim dhe përditësim të planeve të masave për përballimin e emergjencave që mund të krijohen gjatë këtij sezoni të dimrit.
8. Secili të shpreh lirshëm të gjithë problematikën e hasur sipas fushës që mbulon dhe të japi sugjerimet për zgjidhjen e tyre.

Përballimi i situatave të mundshme emergjente dhe të fatkeqësive nuk mund të realizohet me masa formale dhe programe fiktive, por me veprime konkrete nga ana e çdo institucioni dhe strukture shtetërore, në përgatitjen dhe rritjen e aftësive të burimeve njerëzore, mbajtjen në gatishmëri të mjeteve si dhe realizimi i detyrave përkatëse në situata normale për ti parandaluar, përballuar dhe rehabilitimin sa më shpejt të pasojave në çdo situatë.

Së fundmi do të doja që të gjitha problematikat që hasni në institucionet tuaja, në territorin e njësive të vetëqeverisjes vendore ti paraqisni me qëllim që së bashku të ndërtojmë një plan realist që të mund të përballojmë në kohë situatat e mundshme.

04.01.2018

Takimi me drejtuesit e degëve territoriale, agjensive dhe inspektoriateve në Qarkun Gjirokastër

Së pari dëshiroj t'ju uroj Gëzuar Vitin e Ri 2018, uroj që së bashku në këtë vit, vitin e Skënderbeut të realizojmë të gjitha objektivat sektoriale dhe ato në bazë qarku. Jam i bindur se me përkushtimin ndaj detyrës, rritjes së rolit të çdo drejtuesi dhe të administratës që drejtoni, do të bëhet i mundur realizimi i objektivave dhe politikave sektoriale, të përcaktuara nga Ministritë e Linjës dhe në mbështetje të programit të qeverisë Rama 2.
Këtë takim e kërkova ta zhvilloja me ju për parashtrimin e disa detyrave, të cilat rrjedhin nga ligji nr.107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut". Sapo ka përfunduar viti 2017 dhe sigurisht që ju jeni duke punuar për analizat vjetore. Do të kërkoj që në këto analiza midis arritjeve duhet të diskutoni edhe mos realizimet, ku të dallohen ato objektiva që nuk varen nga ju, nga ato subjektive, ku të dalin para përgjegjësive specialistë apo edhe përgjegjësa sektori që nuk kanë qenë në lartësinë e detyrave dhe me neglizhencën e tyre kanë vënë para përgjegjësisë sektorin apo drejtorinë. Të ketë vlerësime individuale pozitive për ato që kanë realizuar detyrat dhe i kanë tejkaluar ato, si dhe të ketë masa disiplinore ndaj atyre që kanë patur dobësi dhe shkelje. Vetëm kështu do të bëjmë të mundur të luftojmë informalizmin. Gjithashtu do të kërkoj që në analizat tuaja të ketë gjithëpërfshirje të qarkut, se ju si drejtues të degëve territoraliale të bashkëpunoni edhe me zyrat që janë në Tepelenë dhe Përmet me qëllim që ato të ndiejnë nga afër ndikimin tuaj. Dëshiroj të theksoj se prioritet në këtë analizë duhet të jetë puna që bëhet me përzgjedhjen, trajnimin, monitorimin dhe rolin e personelit të marrë rishtaz në punë. Të keni objektiva të qarta ndaj tyre, me qëllim kontrollin sa më mirë të tyre.

Nje drejtim tjetër është bashkërendimi i veprimtarive së degëvë teritoriale që veprojnë në qark me organet e njësive të vetqeverisjes vendore, për ketë duhet të analizoni se kur, ku, çfarë

keni arritur nga ky bashkërendim dhe ku, kur dhe çfarë nuk kemi bërë për faj të mos përfshirjes së tyre në zbatim të programit të Këshillit të Ministrave. Po kështu edhe agjensitë e tjera dhe inspektoriatet që veprojnë në rang qarku të trajtojnë veprimtaritë e tyre njësoj si drejtoritë e degëve teritoriale.

Roli i task forcave, komiteteve dhe grupeve të punës kanë ndikuar në përmirësimin e punës në çdo degë territoriale në veçanti edhe në rang qarku në përgjithësi. Arritjet në këto kontrolle, si janë zbatuar buxhetet nga secili institucion dhe sa kanë ndikuar në rritjen e kapaciteteve institucionale. Po kështu të analizohet lufta kundër korrupsionit dhe shpërdorimit të detyrave, shpërdorim detyre do të quhet edhe kur punonjësit nuk kryejnë detyrat dhe për këtë në bazë të kodit të punës të ndëshkohen deri në largimin nga puna.

Dhe së fundi do t'ju kërkoj edhe punën tuaj ndaj komunitetit, për këtë kërkohet transformimi i rëndësishëm i mënyrës dhe i standarteve të cilësisë së ofrimit të shërbimeve nga institucionet e qarkut ndaj qytetarëve dhe bizneseve. Ka shumë ankesa në drejtim të institucionit të Prefektit, ku qytetarët të shqetësuar paraqesin ankesa ndaj disa drejtorive që ankesat e tyre prej shumë vitesh nuk po gjejnë drejtësi.
Në këtë drejtim do të jem shumë i ndjeshëm dhe i ashpër me ata drejtues që nuk do të zgjidhin problemet ndaj qytetarëve do të mbajnë përgjegjësi. Do të propozoj lirimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve.
Prandaj rrisni kërkesën e llogarisë ndaj vartësve tuaj me qëllim që të mbarojë kalvari i gjatë i vuajtjeve të qytetarëve nga paaftësia apo mosdashja e personelit në çdo drejtori dhe të ndëshkohet kushdo që vepron në kundërshtim me programin e qeverisë.
Gjatë kësaj periudhe 2 mujore që jam në detyrën e Prefektit por edhe nga përgjegjësia që kam ndaj Kryeministrit në zbatim të ligjit të Prefektit, kam parë disa probleme të cilat do të doja ti ndaja me ju prandaj ju kërkoj të respektoni si më poshtë:

1. Kthimin në kohë të përgjigjeve të shkresave të dërguara nga ana e institucionit të Prefektit të Qarkut, bazuar në VKM-në nr. 867 datë 10.12.2014 për procedurat e bashkëpunimit me institucionet e administratës shtetërore, kreu II, pika 6, gërma dh.
2. Dërgimi i informacioneve mujore, 3-mujore, 6-mujore dhe vjetore, në kohë dhe me rekomandimin e problematikave për problematika të vecanta me qëllim që të mund ti drejtohemi ministrive të linjës për zgjidhjen e tyre.
3. Dërgimi në kohë i evidencave për realizimin progresiv të investimeve nga buxheti i shtetit çdo 4-mujor.
4. Dërgimi i strukturave dhe buxheteve me afate të përcaktuara.
5. Dërgimi brenda datës 15 janar 2018 të analizës vjetore të realizimit të planeve të punës për çdo degë teritoriale, agjensive apo inspektoriateve në rang qarku.
6. Të sillen në kohë planet e zhvillimit sektorial me qëllim që të jepen mendimet tona pranë ministrive të linjës.
7. Informacion mbi menaxhimin, rehabilitimin e pasojave të emergjencave të fundvitit.
8. Të dërgohen pranë institucionit të Prefektit data e zhvillimit të analizës vjetore së institucioneve tuaja.

02.02.2018

Takimi i grupit të punës për situatën emergjente mjedisore

E nderuar znj. Çuçi

Të nderuar pjesëmarrës,

Në kuadër të nismës "Pastrojmë Shqipërinë që duam", e ndërmarrë nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për përmirësimin e cilësisë së mjedisit dhe mbajtjen pastër të tij, realizojmë këtë takim pune me pjesëmarjen e drejtuesve të institucioneve shtetërore vendore dhe bashkive të qarkut.

Me këtë rast do të doja të falenderoja zonjën Çuçi, Zv/Ministre në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, e cila na nderoi me pjesëmarrjen e saj në këtë takim.

Sipas informacioneve të ardhura rezulton se të gjitha bashkitë e qarkut Gjirokastër, me vendime të këshillave bashkiakë, kanë përcaktuar venddepozitimet dhe realizojnë trajtimin e tyre me shtresëzime.

Procesi i administrimit të mbeturinave përfshirë këtu grumbullimin, ruajtjen dhe sistemimin e tyre nga krijuesi, hedhja sistematike në vendet e caktuara, transportimi për në vëndet e depozitimit, ndarjen, riciklimin dhe përpunimin, në përgjithësi lë për të dëshiruar për çdo bashki. Në mjaft njësi administrative të qarkut tonë veçanërisht në zonat periferike, për shkak të mungesës së kontenierëve të mbeturinave dhe automjeteve të pastrimit, mbetjet urbane në shumicën e rasteve nga komuniteti hidhen nëpër perrenj, prita malore apo përgjatë brigjeve të lumenjve duke ndotur kështu ambientin përreth.

Në takimin e zhvilluar më datë 23 Janar 2018, i thirrur nga Prefekti i qarkut, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të strukturave qëndrore në nivel qarku, u zhvillua faza e parë e vlerësimit të problematikave në lidhje me venddepozitimet e mbetjeve për qarkun tonë. Gjithashtu në këtë takim u vendos ngritja e grupit të punës, në përbërjen e të cilit u caktuan përfaqësues nga të gjitha institucionet vendore dhe bashkitë e qarkut. Ky grup pune do të bëj të mundur identifikimin e të gjitha venddepozitimeve të ligjshme dhe të paligjshme të mbetjeve brenda qarkut sipas bashkive, evidentimin e të gjitha pikave më të ndotura (hotspotet) në akset kryesore rrugore si dhe segmentet lumore në të gjithë territorin e qarkut Gjirokastër.

Duke parë problematikat e mësipërme, rezulton e domosdoshme planifikimi, ndërtimi dhe në të ardhmen menaxhimi i përbashkët i një venddepozitimi në rang qarku (landfill) që të plotësojë të gjitha kushtet mjedisore.

Pas takimit të zhvilluar, nëpërmjet shtypit dhe mediave vizive është bërë sensibilizimi i opinionit publik qytetar, institucioneve vendore dhe bizneseve për mbajtjen pastër të një mjedisi të pëlqyer nga turistët vendas dhe të huaj. Këta aktorë duhet të angazhohen gjithashtu për shtimin e zonave të gjelbëruara si dhe mbështetjen me dru frutorë në zonat urbane.

Referuar edhe nga informimi i sotëm i përfaqësuesve të Ministrisë së Turizmit dhe Mbrojtjes mbi aksionin "Pastrojmë Shqipërinë që duam" të gjitha strukturat vendore të marrin masa sa më konkrete për realizimin me sukses të këtij aksioni.

02.02.2018

Takimi me bizneset e huaja dhe partnerët e tyre vendas që ushtrojnë aktivitetin e tyre në qarkun Gjirokastër

Ju falenderoj përzemërsisht, në emrin e Prefekturës së Qarkut, në emër të Qeverisë dhe në emrin tim personal, për investimet serioze në të gjitha fushat e aktivitetit tuaj, për kontributin e rëndësishëm që jepni kryesisht në punësimin e banorëve të qarkut dhe rrjedhimisht në zhvillimin ekonomik të këtij qarku.

Qeveria Shqiptare, në programin e saj të punës, i kushton një rëndësi të veçantë, stimulimit dhe mbështetjes së projekteve serioze të investimeve në fushat e prodhimit, ndërtimit, turizmit dhe agroturizmit, projekte të cilat, përveç të tjerave, kanë adresuar një nga prioritetet absolute të Qeverisë, atë të punësimit.

Rritja ekonomike synon që të krijoj vende të reja pune të mjaftueshme për të ulur papunësinë në nivelin e vendeve europiane, për të përballuar me mundësira punësimi shtesën demografike të popullsisë dhe për më tepër edhe për të filluar të ndikojë në kthimin e një pjese të emigrantëve. Krijimi i një klime pozitive për zhvillimin e biznesit dhe investimeve, programe për hapjen e vendeve të reja të punës dhe nxitja e formimit profesional si një mekanizëm jashtë mase i rëndësishëm, janë disa nga masat që gjenerojnë punësim. Rëndësia dhe cilësia e politikave aktive të punësimit duhet të vlerësohet rregullisht. Prandaj, është e nevojshme të ndërtohen mekanizma për të monitoruar e më pas vlerësuar këto politika duke angazhuar edhe partnerët social. Kjo mund të çojë në të ardhmen në përmirësimin e programimit, informimit e instruktimit më të qartë të stafit të zyrave lokale të punësimit.

Bazuar dhe në të dhënat statistikore, nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, për vitin 2017 kemi një rritje jo të konsiderueshme të numrit të punëkërkuesve të papunë në krahasim me vitin 2016.

Viti 2017: 3523 *Viti 2016: 3465*

Përsa i përket punëkërkuesve të papunë që përfitojnë ndihmë ekonomike, gjatë vitit 2017 janë regjistruar rreth 1386 nga të cilët 685 prej tyre janë femra. Konkretisht 498 në rrethin e Gjirokastrës, 413 në rrethin e Përmetit, 475 në rrethin e Tepelenës.

Si rezultat i një bashkëpunimi serioz midis Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Gjirokastër dhe biznesit vendas dhe të huaj janë punësuar mbi 500 (pesëqind) punëkërkues të papunë, që janë punësime me ndërmjetësim, punësime me programet e nxitjes dhe gjetje individuale.

Gjatë kësaj periudhe, rritje vihet re në numrin e punëkërkuesve të papunë që ndoqën kurset profesionale në Qendrën e Formimit Publik Gjirokastër. Gjatë vitit 2017 janë çertifikuar 795 kursantë, afërsisht 99.6% e të rregjistruarve, shifër kjo që tregon një rritje të interesit të punëkërkuesve për t'u përfshirë në Programet e Nxitjes së Qeverisë.

Nisur nga kërkesat e punëkërkuesve të papunë, nëpërmjet këtij takimi do të kërkoja një bashkëpunim edhe më të suksesshëm nga aktorët kryesorë si dhe sindikatat përkatëse që të bëhet i mundur realizimi i objektivave të Qeverisë, për të minimizuar sa më shumë, të gjithë së bashku këtë plagë të shoqërisë sonë, si dhe një bashkëbisedim sa më frytdhënës për zhvillimin ekonomik të rajonit tonë.

09.02.2018

Dita ndërkombëtare e Gjuhës Greke

I nderuar Konsull i përgjithshëm i Greqisë zoti Vasilios Tolios,
Të nderuar pjesëmarrës,

Ndihem shumë i nderuar që kam marrë pjesë në një veprimtari të një natyre krejt të veçantë, atë të konstituimit për herë të parë të Ditës Ndërkombëtare të Gjuhës Greke.

Ky nderim nuk lidhet thjesht më faktin e festimit të parë por lidhet me rëndësinë e madhe të gjuhës greke, si gjuhë e folur dhe e shkruar, me jetëgjatësinë më të madhe se çdo gjuhë tjetër. Me faktin se gjuha greke ka kontribuar në ecurinë e të gjitha gjuhëve me peshë në të gjithë botën. Me faktin se gjuha qëndron në themel të mendimit shkencor, filozofik, letrar e akademik që kemi sot, qëndron në themel të atij civilizimi që trashëgoi dhe zhvilloi njerëzimi deri në ditët tona, por edhe në të ardhmen.

Dita e sotme na jep mundësinë për të vlerësuar se secili nga ne, në veprimtarinë tonë të përditshme, profesionale dhe njerëzore, shoqërore dhe civile, përdorim në mënyrë të natyrshme, fjalë, koncepte, mënyra të menduari që i kemi marrë ose e kanë rrënjën tek gjuha greke.

Për mua personalisht dhe vendin që përfaqësoj ky fakt përbën një vlerë më shumë sepse gjuha greke është gjuha e vendit dhe e popullit mik grek, me të cilin kemi një histori të gjatë, kemi shumë gjëra që na lidhin dhe na afrojnë. Gjuha dhe kultura greke përbëjnë premise për të forcuar këtë lidhje dhe marrëdhënie të fqinjësisë së mirë dhe të gjithë ne duhet të punojmë në këtë drejtim. Gjuha greke është njëkohësisht gjuha që hasim më shumë se çdo gjuhë tjetër të huaj dhe në prefekturën tonë.

Është gjuha e minoritetit etnik grek me te cilin bashkëjetojmë në paqe dhe miqësi, është gjuha që përdorin me mijëra emigrantë shqiptarë në Greqi, faktor këta me shumë rëndësi, për të na afruar më shumë, për më shumë mirëkuptim, miqësi e bashkëpunim!

I urojmë Gjuhës greke dhe popullit grek jetëgjatësi pa fund dhe kontribute të vazhdueshme për të mirën e kulturës botërore!

01.03.2018

Takimi mbi sensibilizimin për skemën e ndihmës ekonomike

Organizojmë këtë takim informues dhe sensibilizues për situatën e krijuar pas aplikimit të skemës së re të ndihmës ekonomike ku si pasojë e këtij aplikimi kanë mbetur pa përfituar ndihmë ekonomike një pjesë e konsiderueshme njerëzish.

Në janar të këtij viti, me vendim të Qeverisë, në gjithë Shqipërinë, po kështu edhe në qarkun Gjirokastër, filloi zbatimi i skemës së re të ndihmës ekonomike, pas pilotimit të saj në tre qarqe: Durrës, Elbasan, Tiranë.

I gjithë ky process kalimi nga një skemë e vjetër, jo pa të meta dhe me një risk të lartë abuzivizmi, në një system të integruar, ku shënjestrohet më mirë varfëria, tentohet të

shmanget abuzivizmi dhe rritet sasia e përfitimit financiar, është një nga reformat e forta e të guximshme që po ndërmerr qeveria Rama, dhe si e tillë duhet ta pranojmë, se patjetër prodhon kosto afatshkurtra, ku ndër më kryesorët do të kemi pak durim, përtej hutimit të parë, dhe me një sërë sugjerimesh të matura e ndërhyrje komplekse, hap pas hapi dhe jo shumë vonë, me siguri do të shohim rezultatet e saj.

Arritja më e madhe e kësaj reforme duhet kuptuar tek ndryshimi i mendimit të njerëzve, të cilët duke e kuptuar thelbin dhe përtej pakënaqësisë së momentit, të krijuar nga ajo mënyrë jetese, kur një familje i kishte sytë vetëm tek ndihma ekonomike, lind dhe përpjekja për integrim social dhe për të jetuar më mirë. Këtu futet roli i Zyrës së Punës dhe Formimit Profesional, që do të na japi mundësi lidhur me kapërcimin e këtyre situatave.

Nga problemet që një administratë përballon në nivel lokal, mbi të gjitha kur bëhet fjalë për ekonomi, ndihmë sociale etj, meritojnë jo vetëm mbështetje por edhe një ndërhyrje komplekse të shtetit, në këtë kuptim institucioni i Prefektit Gjirokastër, si përfaqësues i KM, në nivel qarku, koordinon dhe ndjek të gjithë këtë proces.

Si problematika paraqiten:

- Jo të gjithë Këshillat Bashkiakë janë mbledhur brenda afatit të përcaktuar me ligj, deri në datë 20 të çdo muaji, duke vonuar në këtë mënyrë vendimmarrjen nga ana e DRSHSSH.
- Të gjithë Këshillat Bashkiakë kanë miratuar kriteret për familjet e varfëra që do të përfitojnë nga fondi 6%, për t'u përfshirë sa më shumë familje në skemë.
- Të gjitha zyrat e ndihmës sociale të bashkive kanë përpiluar listën e familjeve, rreth 154 familje në qark janë planifikuar dhe do të përfitojnë nga fondi 6% i bllok-ndihmës përveç familjeve fituese nga skema.
- Qeveria ka ndërmarrë nismën për të ndihmuar me buxhet, krijimin e fondit social në të gjithë territorin e vendit.
- Lehtësimi i verifikimeve dhe inspektimeve në terren me institucionet e tjera të vartësisë së MSHMS.

Njerëzit kanë nevojë të ndriçohen jo vetëm nga personazhe publike, por edhe nga një informacion bazë, që marrin nga administratorët social, të cilët janë hallka e parë dhe bazë që i lidh me pushtetin local, dhe janë të trajnuar.

07.03.2018

Takimi i Organit Këshillues të Prefektit

Të nderuar pjesëmarrës,

Në zbatim të ligjit nr. 107/2016 "Për prefektin e qarkut" neni 23, pranë institucionit të Prefektit me urdhër të tij, ngrihet dhe funksionon organi këshillues i Prefektit. Në këtë organ këshillues marrin pjesë kryetari i këshillit të qarkut, kryetarët e bashkive, drejtori i Policisë Vendore, drejtuesi i Njësisë së Forcave të Armatosura për qarkun, drejtues të degëve territoriale si dhe përfaqësues nga shoqëria civile.

Ky organ funksionon për probleme të përgjegjësive të Prefektit në interes të zbatimit të ligjeve kushtetuese, akteve normative dhe të politikave të zhvillimit në rajon.

Në zbatim të rregullores së funksionimit të këtij organi, të cilën ne do ta miratojmë sot, ky organ do të mblidhet një herë në muaj për të trajtuar tematika dhe probleme të ndryshme që kanë të bëjnë me realizimin e misionit të Prefektit në funksion të zbatimit të reformave të Qeverisë Shqiptare, të prioriteteve dhe objektivave për zhvillimin e qarkut tonë.

Në këtë kuadër, për vitin 2018 Qeveria Shqiptare ka ndëmarrë disa reforma të rëndësishme ku mund të përmendim reformën në sektorin e ujit të pijshëm, reforma në sektorin e ndihmës ekonomike, në drejtim të zhvillimit turistik, për përmirësimin e situatës mjedisore veçanërisht në përcaktimin dhe menaxhimin e venddepozitimeve të mbetjeve urbane si dhe angazhimin në planifikimin dhe përballimin e emergjencave civile dhe krizave në qarkun tonë.

Në drejtim të aksionit për formalizimin në sektorin e ujit të pijshëm, në qarkun tonë po kryhet një punë e mirë nga të gjitha task-forcat e bashkive si në subjektet private, institucionet shtetërore dhe së fundi edhe me abonentët familjarë. Veprimtaria e këtyre task-forcave monitorohet nga grupi i koordinimit i ngritur pranë Prefektit të qarkut.

Siç edhe e keni ndjekur në vazhdimësi, qarku ynë gjatë këtij sezoni dimëror ka patur disa problematika në drejtim të emergjencave civile. Pavarësisht nga disa mangësi të dala veçanërisht në organizimin dhe funksionimin e shtabeve të emergjencave civile pranë njësive vendore, falë bashkëpunimit të institucionit të Prefektit me strukturat qëndrore e vendore është arritur të përballohen situatat e krijuara.

Prej datës 1 Janar 2018, pas pilotimit në tre qarqe edhe në qarkun tonë ka hyrë në fuqi sistemi i ri i ndihmës ekonomike. Kjo reformë e rëndësishme synon në të vërtetë largimin nga skema të personave të cilët kanë përfituar ndihmën ekonomike në mënyrë abuzive dhe inkurajon për të aplikuar online në këtë skemë të gjithë personat që në të vërtetë gjenden në kushte të vështira dhe meritojnë ta përfitojnë ndihmën ekonomike.

Qeveria Shqiptare nëpërmjet Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit ka iniciuar procesin e kategorizimit të venddepozitimeve dhe evidentimin e masave për zbutjen e riskut. Në rang qarku janë krijuar grupet e punës të organizuara sipas bashkive. Këto grupe bëjnë të mundur identifikimin e të gjitha venddepozitimeve të ligjshme dhe të paligjshme të mbetjeve urbane brenda qarkut sipas bashkive, evidentimin e të gjitha pikave më të ndotura në akset rrugore si dhe segmentet lumore në qarkun Gjirokastër.

Institucioni i Prefektit të Qarkut është i angazhuar maksimalisht për realizimin e këtyre reformave në bashkëpunim me të gjitha institucionet shtetërore në nivel vendor dhe veçanërisht me njësitë e vetëqeverisjes vendore.
Në cilësinë e Prefektit të Qarkut në çdo mbledhje që do të zhvillojmë do të kërkoja nga ana juaj mendime, sugjerime, këshillime dhe diskutime për mbarëvajtjen e çdo problematike që do të trajtojmë.

Përveç tematikës vjetore të mbledhjeve të organit këshillues të Prefektit që do të miratojmë së bashku për vitin 2018, mund të propozohet edhe ndonjë tematikë tjetër që e shikojmë të arsyeshme në lidhje me specifika të veçanta që lidhen me qarkun tonë.

Pasi të diskutojmë së bashku për tematikën për të cilën ju kemi vënë në dispozicion, ju ftoj të miratojmë rregulloren dhe planin vjetor të punës së këtij organi.

16.03.2018

Takimi rajonal "Në kuadër të masave për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të kultivimit të bimeve narkotike për vitin 2018"

Të nderuar pjesëmarrës!

Aktiviteti i paligjshëm i kultivimit të bimëve narkotike me gjithë masat e marra nga Qeveria shqiptare, ka vazhduar të kryhet si një nga format e pasurimit të paligjshëm nga persona me precedent kriminal.

Nisur nga objektivat dhe prioritetet strategjike si dhe përpjekjet e vazhdueshme që po bën vendi ynë për tu integruar në familjen europiane, Shtabi Rajonal pranë Prefekturës së Qarkut Gjirokastër, për parandalimin dhe luftën kundër kultivimit të bimëve narkotike ka hartuar Planin e Veprimit Rajonal.

Qëllimi i këtij plani është të parashikojë masat, detyrat dhe veprimet që do të meren dhe zbatohen nga strukturat përkatëse që janë pjesë e shtabit rajonal, veçanërisht ato të Policisë së Shtetit në nivel vendor, për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të bimëve narkotike si dhe vënien para përgjegjësive ligjore të autorëve.

Shpeshherë mendohet se lufta kundër kultivimit të bimëve narkotike_në përgjithësi është një punë që i takon policisë. Në një shoqëri demokratike, policia nuk mund t'ja dalë pa mbështetjen dhe bashkëpunimin e komunitetit, institucioneve shtetërore ligjzbatuese, organet e vetëqeverisjes vendore, institucionet arsimore, mediat etj.

Rilindja e besimit qytetar dhe ndërkombëtar nuk ka të bëjë vetëm me atë çfarë bëmë, por dhe me ato çfarë duhet të bëjmë kundër ketij fenommeni me qëllim krijimin e një mjedisi të sigurtë për shoqërinë.

Në cilësinë e Prefektit të qarkut Gjirokastër, më lejoni të ofroj gjithë mbështetjen time personale, por edhe të institucionit që unë drejtoj dhe besoj se kemi vullnet institucional dhe mbi të gjitha detyrë e gjithësecilit por dhe përgjegjësi qytetare për të bërë edhe më shumë në luftën kundër kultivimit të bimëve narkotike.

19.03.2018

Takimi rajonal për sensibilizimin e komunitetit për parandalimin e kultivimit dhe trafikimit të bimëve narkotike

E nderuar Znj. Aida Hajna, N/Drejtore e Përgjithshme e Policisë së Shtetit,
Të nderuar drejtues të organeve të pushtetit vendor dhe të organeve ligjzbatuese në qarkun e Gjirokastës,

Në bazë të plan-kalendarit të Drejtorisë së Përgjithëshme të Policisë së Shtetit, po zhvillohet ky takim rajonal në nivel qarku, për sensibilizimin e komunitetit për parandalimin e kultivimit dhe trafikimit të bimëve narkotike për vitin 2018.

Siç jeni në dijeni, më datë 16 mars 2018, në institucionin e prefektit të qarkut u zhvillua takimi i parë i Task Forcës Vendore në rang qarku për vitin 2018 me drejtime kryesore:

- Parandalimin e kultivimit të kanabisit;
- Veprimtarinë sinjalizuese, analizuese, zbuluese e goditëse të strukturave ligjzbatuese ndaj atyre që do të tentojnë të mbjellin;
- Nevojën dhe rëndësinë e forcimit dhe bashkëpunimit të të gjitha strukturave ligjëzbatuese vendore në luftën kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit.

Në atë takim theksova se mbështetur në nenin 14, ligji 107/2016 "Për Prefektin e qarkut", në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe vendimit nr. 248, datë 29.03.2017 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Planit të Veprimit Kundër Kultivimit dhe Trafikimit të Kanabisit 2017-2020", pika 12, të urdhërit nr. 51, datë 13.04.2017 të Kryeministrit "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave drejtuese dhe koordinuese ndërinstitucionale në nivel qëndror", është përcaktuar se pjesëmarrja e përfaqësuesve të bashkive në Task Forcën Vendore, rregullohet me Marrëveshje të përbashkët ndërmjet Prefektit të qarkut dhe kryetarëve të bashkive përkatëse. Për këtë janë bërë marrëveshjet e bashkëpunimit midis prefektit të qarkut dhe kryetarëve të bashkive, ku kryetari i bashkisë, në nenin 2 është përfaqësues në Task Forcën Vendore (firmosur nga prefekti i qarkut dhe kryetari i bashkisë, datë 31.05.2017).
Gjithashtu nga ana e Njësive të vetëqeverisjes vendore, janë përgatitur edhe Plan – Veprimi kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit për vitin 2018, të cilat duhet të sillen pranë prefektit të qarkut.
Pavarësisht masave të marra dhe rezultateve pozitive të arritura gjatë vitit të kaluar, grupet kriminale këtë vit do të mundohen të përdorin forma të tjera dhe veçanërisht ata mund të shfrytëzojnë ambjentet e mbyllura. Prandaj del detyrë kryesore e të gjithë aktorëve që janë pjesë e Task Forcës Vendore të ushtrojnë kompetencat e tyre ligjore për mbajtjen nën kontroll të territorit që kanë në administrim, duke planifikuar kontrolle të përbashkëta me policinë e shtetit, sidomos ndaj objekteve të mbyllura me rrisk të lartë në këtë fazë për kultivimin e kanabisit, siç janë: depo, tunele kapanone të mëdha, shtëpi të braktisura apo të mbyllura, stane që dyshohen se mund të kthehen në sera të mbyllura, etj.

Nisur nga objektivat dhe prioriteti strategjik që Qeveria Shqiptare ka në kuadër të integrimit në familjen europiane, Task Forca Vendore pranë Prefektit të qarkut ka hartuar ***Plan - Veprimin Vendor*** për parandalimin dhe luftën kundër kultivimit të bimëve narkotike, e cila ju është dhënë të gjithë antarëve të TFV, ku janë përcaktuar masa konkrete për çdo institucion.
Ritheksoj edhe njëherë se të gjitha institucionet shterore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore që marrin pjesë në TFV duhet të raportojnë tek institucioni i prefektit të qarkut çdo ditë të premte mbi veprimtarin e punës së tyre lidhur me zbatimin e detyrave të caktuara në këtë plan- veprimi. Ky informacion do t'i përcillet Sekretariatit teknik pranë Task Forcë Qëndrore TFQ pranë Ministrisë së Brendëshme.
Shpeshherë mendohet se lufta kundër kultivimit të bimëve narkotike në përgjithësi është një punë që i takon vetëm policisë. Në një shoqëri demokratike, policia nuk mund t'ja dalë e vetme pa mbështetjen dhe bashkëpunimin e komunitetit, institucioneve shtetërore ligjzbatuese, organeve të Vetëqeverisjes Vendore, institucioneve arsimore, mediat lokale dhe qëndrore, por në këtë luftë kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit duhet të përfshihen edhe persona me reputacion publik nga fusha e shkencës, artit, kulturës dhe sportit.
Është e pafalëshme të qëndrojmë indiferent ndaj sulmeve që bëjnë portalet e ndryshme dhe konkretisht portali, Argjirolajm.net, datë 16.03.2018, ndaj prefektit të qarkut Gjirokastër dhe Task Forcës Vendore, ku në vend të përfshihet së bashku me të gjitha mediet lokale të qarkut tonë duke sensibilizuar komunitetin për parandalimin e kultivimit dhe trafikimit të bimëve

narkotike si një e keqe e madhe që duhet të luftohet dhe të mbetet për historinë tonë si një faqe e zezë, ata bëhen palë së bashku me krimin dhe kriminelët që kush më parë dhe kush më vonë do të jenë para drejtësisë për dëmin e madh që i kanë sjell vendit tonë.
Me këtë rast ftoj Prokurorinë, Shërbimin Informativ Shtetëror dhe Drejtorinë Vendore të Policisë në qarkun tonë të shikojnë se kush fshihet pas tyre dhe kush i paguan për të përbaltur punën e organeve ligjëzbatuese të shtetit. Janë disa raste që ky portal kërkon të dezinformojë komunitetin e qarkut në lidhje me problematika të ndryshme me të cilat është përballur qarku ynë kohët e fundit. Këta janë po aq të dëmshëm sa edhe ata që ndodhen pas tyre dhe që i menaxhojnë. Ata kanë një fjalë të përbashkët: "mbjelljen" . Ndërsa kultivuesit mbjellin dhe trafikojnë kanabisin, këta kërkojnë të mbjellin pasiguri dhe të përbaltin strukturat shtetërore që janë të përfshira me ligj në luftën tonë të përbashkët kundër kultivimit dhe shitjes së këtyre lëndëve vdekje prurrëse për fëmijët dhe të rinjtë tanë.

Në kuadër të nismës të Qeverisë Shqiptare për rehabilitimin e 100 fshatrave në aspektin infrastrukturor, kulturor dhe historik, ju bëj me dije se pjesë e këtyre fshatrave të përzgjedhur janë dhe 12 fshatra në territorin e qarkut Gjirokastër. Këto fshatra janë zgjedhur mbi bazën e potencialit të tyre turistik dhe pritet të shndërrohen në qendra të turizmit rural.
Do të rikujtoja të gjithë drejtuesit e njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ato rajonale që zotërojnë kullota livadhe dhe pyje, në kontratat që do të lidhin për dhënien me qera apo në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik, të specifikojnë detyrimisht përgjegjësitë që kanë qiramarrësit për mos kultivimin në ato territore të bimëvë narkotike si dhe parandalimin e zjarreve dhe marrjen e masave për shuarjen e tyre. Në rast evidentimi dhe mos sinjalizimi nga ana e qiramarrësve dhe e strukturave mbikqyrësë dhe monitoruese, do të përballen me forcën e ligjit.

Edhe njëherë përfitoj nga rasti t'ju bëj thirrje që së bashku duhet të bëhemi promotorë, në parandalimin e kultivimit të bimëve narkotike dhe në goditjen dhe trafikimin e kanabisit me qëllim rritjen e imazhit dhe zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm dhe gjithëvjetor në qarkun tonë.
Prioriteti i Qeverisë Shqiptare dhe premtimi i Kryeministrit për vitin 2018 është ***kultivimi zero*** i bimëve narkotike në territorin e Republikës së Shqipërisë.
Në cilësinë e Prefektit të qarkut, si përfaqësues i Këshillit të Ministrave në nivel qarku dhe kryetar i kësaj Task Force Vendore, më lejoni të ofroj gjithë mbështetjen time personale, por edhe të institucionit që unë drejtoj për realizimin në afate dhe me sukses të Plan – Veprimit në rang qarku në luftën kundër kultivimit dhe trafikimit të bimëve narkotike.
Faleminderit!

05.04.2018

Takim me Sekretarët e Këshillave bashkiakë dhe Specialistët e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

Nisur nga problematikat e dala gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së akteve të paraqitura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore si dhe procesit të verifikimit për dhënien e akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi, e pamë të arsyeshme të zhvillojmë këtë takim me qëllim konsultimin, bashkëpunimin në drejtim të unifikimit dhe standartizimin e këtyre akteve.

Gjatë kësaj periudhe në të cilën unë drejtoj institucionin e Prefektit, kam vënë re disa parregullsi në formulimin dhe bazueshmërinë ligjore të akteve dhe dokumentave të tjera shoqëruese (relacione apo dokumenta plotësuese). Të gjitha këto mangësi na kanë detyruar që shpesh aktet të kthehen të pakonfirmuar për tu rishqyrtuar në këshillin bashkiak përkatës. Nga ana e këshillave bashkiakë shpesh nuk respektohen aktet ligjore e nënligjore në vendimarrjen e tyre për çështje të ndryshme, si për shembull së fundmi, vendimet për dhënien e bursave të cilat në jo më pak raste u shoqëruan edhe me ankesa të qytetarëve për arsye të moszbatimit të kritereve ligjore në shpërndarjen e tyre.

Nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror është ngritur shqetësimi se vendimet në lidhje me ndihmën ekonomike shpesh shqyrtohen jo në kohën e duhur duke sjellë vonesa në shpërndarjen e ndihmës tek qytetarët. Po kështu edhe në lidhje me shpërndarjen e fondit prej 6% që jepet me vendim të Këshillit të Bashkisë do të kërkoja angazhimin tuaj që vendimmarrja të bëhet në kohë dhe në respektim të kritereve ligjore.

Nga ana e specilistëve të administratës së Prefektit të cilët punojnë me verifikimin e ligjshmërisë së akteve është dhënë gjithmonë asistenca e nevojshme juridike për sekretarët e këshillave apo specilistëve të bashkive, në drejtim të formulimit të aktit dhe bazës ligjore përkatëse, ndihmë e cila do të vazhdojë në kuadër të bashkëpunimit dhe zbatimit të ligjshmërisë në veprimtarinë e institucioneve tona. Pranë institucionit të Prefektit kryen veprimtarinë edhe Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë për Tokën Bujqësore. Referuar akteve ligjore dhe nënligjore ky komision bën verifikimin e titujve të pronësisë për realizimin e të cilit është i nevojshëm bashkëpunimi dhe komunikimi shkresor në lidhje me plotësimin e dokumentacionit dhe informacionin e duhur. Në punën e përditshme të këtij komisioni vërehen vonesa në kthimin e përgjigjeve nga ana e bashkive apo njësive administrative si dhe pasaktësi në dhënien e informacioneve të kërkuara.

05.04.2018

Takimi mbi shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore

Jemi mbledhur në këtë takim të zgjeruar me pjesëmarrje të drejtuesve nga njësitë e qeverisjes vendore, të DAMT së Qarkut, të drejtuesve të ZVRPP dhe ALUIZNI, të Drejtorisë së Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefektit të Qarkut dhe Zyra e Avokatisë së Popullit, për të analizuar punën e bërë për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore.

Ligji nr. 7501 “Për ndarjen e tokës bujqësore” është miratuar që në vitin 1991 dhe deri më sot, kjo tokë është e pandarë në mënyrë përfundimtare, e cila nuk u ka dhënë mundësi investimi fermerëve dhe investitorëve të huaj.

Mungesa e pronësisë së tokës bujqësore siguristh që ka pasur dëme të pallogaritshme, jo vetëm në zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë, por edhe në zhvillimin ekonomik të qarkut në tërësi. Kjo ka bërë që toka as mos të shitet e as most ë blihet, duke mos u dhënë mundësinë atyre që munden të punojnë të kenë më shumë tokë dhe atyre që nuk kanë mundësi fizike për të punuar, ta shesin tokën dhe dikush tjetër ta punojë atë. Fermerët nuk kanë mundur të financohen me granted he kredi për shkak të mungesës së tapive. Ata nuk kanë mundur të ndërtojnë sera, stalla apo ndërtime me karakter bujqësor dhe blegtoral, sepse për këtë dokumenti i parë që nevojitet për t’u pajisur me leje ndërtimi, është hipotekimi i tokës. Ata

nuk kanë motivin e duhur për ta punuar tokën, për aq kohë sa nuk kanë sigurinë e trashëgimit të saj tek pasardhësit. Po t'i shtosh edhe konfliktet për pronësinë e tokës që qëndrojnë pezull edhe pas 28 vitesh, është i qartë dëmi i pallogaritshëm që i është shkaktuar bujqësisë dhe ekonomisë shqiptare nga moszbatimi në kohë i ligjit nr.7501.

Gjatë kohës që jam në këtë detyrë, kam vërejtur mangësi të njohjes së legjislacionit në këtë fushë nga ana administrative e Njësive Vendore si dhe mungesë e vullnet për zbatimin e këtij legjislacioni. Vetëm 60 ditë do t'i duhen një fermeri të presë për të shtënë në duar hipotekën e tokës që ka në përdorim. Shkurtimi i afateve është shoqëruar edhe me thjeshtim të procedurave të aplikimit për marrjen e certifikatës së pronësisë. Janë më se të qarta hapat që duhet të ndiqen, si edhe dokumentacioni që duhet dorëzuar pranë njësisë administrative. Ky proces nuk ka kosto. E vetmja faturë që do të paguajnë fermerët do të jetë ajo që vilet nga Hipoteka (ZVRPP) gjatë regjistrimit të pronës.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit 9948, datë 7.7.2008 "Për shyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", ish-Komisionet e Ndarjes së Tokës pranë komunave të krijuara në bazë të nenit 7, të ligjit nr.7501 "Për ndarjen e tokës bujqësore" të ndryshuar, mbaruan funksionimin dhe veprimtarinë e tyre për ndarjen e tokës. I gjithë dokumentacioni i ndarjes së tokës, i disponuar nga Komisionet e mëparshme, u dorëzua pranë DAMT në Qark.

Me këtë ligj u krijuan Komisionet e Verifikimit të Pronësisë (KVVTP), pranë prefektëve të qarqeve, objekt i punës i së cilave është verifikimi i vlefshmërisë ligjore të krijimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi (AMTP), të krijuara deri në hyrjen në fuqi të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, proces i cili ende po vazhdon.

Nisur nga evidentimi i shumë rasteve ku familjet bujqësore në përdorim sipërfaqe toke (të ndara ndërkohë nga ish-Komisionet e Ndarjes së Tokës), apo Akte të Marrjes së Tokës në Përdorim të pa kthyer në Pronësi, rifilloi procesi i pajisjes me AMTP, proces i cili ende vijon si në territorin e ish-Ndërmarrjeve Bujqësore.

Kështu, me ligjin nr.172/2014, dhe VKM-të nr. 337 dhe 338, datë 22.04.2015, Njësitë Administrative dhe Bashkitë përkatëse, kanë detyrimin ligjor që të pajisin me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi AMTP në territorin e ish-Kooperativave/Ndërmarrjes Bujqësore, ato subjekte të cilët plotësojnë kriteret e vendosura me Ligjin dhe VKM-të e mësipërme. Në lidhje me situatën aktuale si dhe me problematikat e vërejtura, duhet thënë që zbatimi në praktikë i VKM-së dhe Ligjeve të mësipërme, përsa i përket procesit të pajisjes me AMTP, nuk ka pasur ecurinë e pritur, madje në disa Njësi Administrative thuajse nuk ka nisur fare, edhe pse ka shumë familje bujqësore, të cilët e përdorin tokën bujqësore të ndarë nga ish-Komisioni i Ndarjes së Tokës por që nuk kanë përfituar AMTP në lidhje me të.

Me reformën e re territoriale e vitit 2015, ka ndryshuar edhe procedura për marrjen e certifikatës së pronësisë për tokat bujqësore të ndara me ligjin nr. 7501.

Së pari, do të theksoja faktin që reforma territoriale nuk është thjesht një ndarje e re fizike e hartave të njësive të qeverisjes vendore por ajo riorganizon këto njësi edhe në aspektin funksional, duke u dhënë atyre funksione të reja, por edhe mundësi të reja të ushtrimit të këtyre funksioneve. Konkretisht, bashkitë nuk kanë pasur objekt të punës së tyre zbatimin e ligjit nr.7501 dhe ndarjen apo regjistrimin e tokës bujqësore, ndërkohë që komunat e kanë pasur këtë funksion por pa pasur realisht mundësi ligjore dhe praktike për zgjidhjen e këtij problemi. Sot, reforma territoriale ka krijuar mundësi të reja, institucione të reja, me më shumë mundësi për ta çuar këtë process përpara. Mundësitë e kufizuara të ish-komunave dhe

mungesa e angazhimit serioz të ish-kryetarëve të komunave, nuk ka qenë i vetmi shkak se pse ky process ka ngecur në vend prej gati 27 vitesh.

Një arsye e rëndësishme ka qenë fakti që një banor i fshatit, që në dorën e vet kishte vetëm një Akt të Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP) do të duhej të përgatiste gjithçka vetë për të regjistruar tokën e vet. Ai do të duhej të shkonte shumë herë në qytet për një certifikatë të trungut familjar të periudhës së përfitimit të tokës, për një planvendosje të tokave të veta, për të gjetur një topograf të licensuar që duhej të kryente matjet në terren, për të marrë një vërtetim nga kadastra, një tjetër nga Këshilli i Qarkut, një vërtetim nga ALUIZNI, për të aplikuar tek ZVRPP për të kryer korrigjimet e kërkuara nga kjo zyrë etj., procedura që lodhnin dhe mërzisnin edhe fermerin më të duruar në Shqipëri.

Lodhje, stres dhe kosto të larta që kanë sjellë në situatën e sotme kur fermerët punojnë prej çerekshekulli tokën por ata as nuk mund ta përdorin si kolateral për kreditim apo për financim të aktivitetit të tyre bujqësor e blegtoral.

Bazuar në këto akte nënligjore, si dhe VKM nr. 994, datë 9.12.2015 "Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes në pronësi" dhe udhëzimeve përkatëse, procedurat lehtësohen maksimalisht për fermerët, ndërkohë që bashkitë ngarkohen me më shumë detyra konkrete, duke mbajtur barrën e kryerjes së këtij shërbimi ndaj banorëve të vet që banojnë në fshat. Tashmë, një banor i fshatit mjafton të apikoj pranë njësisë së vet administrative, duke dorëzuar bashkë me kërkesën vetëm AMTP dhe certifikatën familjare (ndërkohë që për ata që nuk disponojnë AMTP kërkohen edhe disa dokumente që vërtetojnë pronësinë e tokës). Pas këtij momenti, ai s'ka për të kryer anjë veprim tjetër, pra ai nuk humbet as kohë e s'ka as kosto financiare. Bashkia ka për detyrë të përgatisë dosjen përkatëse me dokumentacionin që kërkon ligji, duke komunikuar dhe bashkërenduar punën me institucionet e tjera shtetërore, deri në finalizimin e regjistrimit të tokës. Kur ky process ka përfunduar, bashkia njofton pronarin e tokës bujqësore të paraqitet pranë ZVRPP për tërheqjen e Certifikatës së Pronësisë. Ai thjesht mbetet në pritje të përfundimit të procesit që ndodh ndërmjet bashkisë dhe ZVRPP.

Kur procesi i plotësimit dhe saktësimit të dokumentacionit përfundon, ZVRPP plotëson certifikatën e pronësisë, njofton bashkinë për mbylljen e këtij procesi dhe i kërkon asaj të njoftojë fermerin, ose njofton direkt fermerin për t'u paraqitur për tërheqjen e dokumentit. E vetmja pagesë në këtë rast është ajo që kryen çdo person që regjistron një pronë, pra pagesa e tarifës përkatëse që aplikon ZPRPP-ja. Të gjitha kostot e tjera që paguheshin për topografin e licensuar, për noterin, për aplikimin, për të shkruar disa herë në qytet etj., nuk do të paguhen më nga ana e fermerëve. Pra siç shihet, vendimet e lartpërmendura ngarkojnë me përgjegjësi Kryetarët e bashkive për përfundimin brenda afateve kohore të regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi AMTP dhe që duhet të raportojnë çdo muaj tek Prefekti i Qarkut. Në cilësinë e Prefektit të Qarkut, nisur nga mungesa e këtij informacioni nga ana juaj, kërkoj bashkëpunimin pranë ZVRPP për dhënie të Certifikatave të Pronësisë.

Qeveria shqiptare ka patur vazhdimisht në fokus procesin e shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore duke shtyrë disa herë edhe afatin për përfundimin e këtij procesi me qëllim zgjidhjen e subjekteve me AMTP.

23.04.2018

Festa e Hormovës

I nderuar Sheh Hysen Hormova!
Të nderuar pjesëmarrës !
Të nderuar besimtarë!

Sot për mua është një nder dhe një kënaqësi e veçantë që jam pranë jush. Në një ditë të shënuar dhe domethënëse si kjo nuk mund kurrësesi të mungoja. Një falenderim të veçantë shkon për ideatorët dhe iniciatorët e këtij evenimenti që jeni ju i nderuar Sheh Hysen Hormova. Është për tu vlerësuar dhe lavdëruar ajo çka ju sot pëcillni njëzëri: dashuri, respekt, mirëkuptim dhe tolerancë. Sot këtu reflektojnë më së miri vlerat dhe virtytet njerëzore. Ju uroj përzemërsisht gëzuar këtë ditë të shënuar, paqja dhe dashuria mbizotëroftë tek ne të gjithë së bashku! Gëzuar!

24.04.2018

Takimi me Ambasadorin e Italisë Z. Alberto Cutillo

I nderuar Z. Ambasador,

Fillimisht dua t'ju falenderoj për vizitën në qytetin dhe rajonin e Gjirokastrës dhe ju uroj përzemërsisht për detyrën tuaj të rëndësishme si Ambasador i Italisë në Shqipëri. Duke qenë takimi ynë i parë do të doja fillimin e një bashkëpunimi në funksion të rritjes dhe shtimit të marrëdhënieve dypalëshe.

Lidhjet e Gjirokastrës me Italinë janë historike. Falë ndihmës së Italisë në vitet '20-30' të shekullit të kaluar janë ndërtuar në rajonin tonë veprat e para infrastrukturore të standarteve evropiane për kohën: aeroporti, rrugët, urat, ujësjellësi, centrali elektrik, bankat e para, shkolla profesionale, liceu etj.

Gjirokastra është një qendër e rëndësishme administrative, universitare, sipërmarrjesh private, bankash, përfaqësish diplomatike dhe një qendër e madhe me vlera historike dhe arkitektonike që prej korrikut të vitit 2005 është pjesë e pasurisë botërore nën mbrojtjen e UNESCO-s. Gjirokastra historikisht ka qenë qendra kryesore e Jugut të Shqipërisë.

Ne kemi pasur raporte institucionale bashkëpunimi me realitete të ndryshme italiane si me: Rajonin e Markeve, Provincën e Ascoli Picenos, Bashkinë e Grotamares, Bashkinë e Leces, DIE-Delegacioni Italian i Ekspertëve, VSP, Konsullatën e Përgjithshme Italiane në Vlorë, Konsullatën e Nderit të Italisë në Gjirokastër, Misionin Arkeologjik Italian në Hadrianopolis etj.

Falë këtyre marëdhënieve janë realizuar në vitet e kaluara disa projekte si:

- Harta dixhitale e qytetit të Gjirokastrës (bashkëpunim me Grottamaren).
- Zyra e Planit Rregullues pranë Bashkisë Gjirokastër.
- Plani i Rikuperimit të Qendrës Historike (bashkëpunim me Rajonin e Markeve dhe Bashkinë e Grottamares, Provincën e Ascoli Piceno).

- Projekti Transizmik (Rajoni Markeve + Provinca e Ascoli Piceno + Bashkia Grotamare dhe disa Universitete Italiane).
- Në bashkëpunim me VSP – Torino është realizuar Studimi i Fisibilitetit të Aeroportit dhe Projekti i Parkut Natyror të Viroit.
- Në bashkëpunim me Konsullatën e Përgjithshme Italiane në Vlorë dhe Konsullatën e Nderit të Italisë në Gjirokastër janë organizuar takime dhe aktivitete të shumta kulturore dhe shkencore: ekspozita, konferenca etj.
- Me shumë vlera është puna e Misionit Arkeologjik Italo-Shqiptar pranë sitit romak të Hadrianopolis. Me këtë rast do të doja të vlerësoja punën e arkeologëve italiane të Universitetit të Macerates nën drejtimin e prof.Roberto Perna.
- Gjuha italiane studiohet në të gjitha nivelet e shkollave të Gjirokastrës, janë mbi tremijë nxënës që e studiojnë rregullisht italishten sipas projektit Iliria dhe si gjuhë e huaj e dytë si dhe në seksionin e italishtes në Universitetin "Eqrem Çabej."
- Shumë i vlerësuar ka qenë prej komunitetit gjirokastrit çelja vitin e kaluar e tre Seksioneve Europiane (dygjuhëshe) pranë dy shkollave 9-vjeçare "Koto Hoxhi" dhe "Urani Rumbo". Do të kërkoja më shumë mbështetje prej Ambasadës për këto seksione në mënyrë që të bëhen një model për shkollat e qytetit duke justifikuar edhe interesin e madh të nxënësve dhe prindërve.

Me këtë rast do të kërkonim mbështetjen tuaj Zoti Ambasador për çeljen e një Seksioni Dygjuhësh në Gjimnazin "Asim Zeneli". Kjo kërkesë i është drejtuar Ambasadës Italiane dhe Konsullatave para shumë vitesh dhe është ripërsëritur edhe tek Drejtoria e Liceut "Asim Zeneli" si dhe tek Drejtoria Rajonale e Arsimit.

Në këtë pikë do të vlerësoja punën e Komitetit "Dante Aligeri" – Gjirokastër në promovimin e kulturës dhe gjuhës italiane.

Prefektura e Gjirokastrës ka pasur dhe ka marrëdhënie shumë të mira bashkëpunimi me përfaqësitë diplomatike italiane në Shqipëri, Konsullatën e Përgjithshme të Italisë në Vlorë dhe me Ambasadën Italiane në Tiranë. Falë këtij bashkëpunimi sot në qytetin dhe rajonin tonë kemi një rritje të bashkëpunimit me Italinë dhe patëm ngjarjen historike atë të çeljes së Konsullatës Italiane të Nderit, si konkretizim i një kërkese të hershme të komunitetit gjirokastrit dhe autoriteteve lokale. Kjo konsullatë sot është një faktor i rëndësishëm për prezencën italiane por edhe për bashkëpunim dypalësh.

Gjirokastra siç dihet është edhe një qendër e rëndësishme ekonomike dhe tregëtare. Kjo vërtetohet nga prezenca e shumë sipërmarrjeve të fuqishme si dhe nga prezenca e shumë bankave vendase dhe të huaja. Por po vëmë re mungesë të prezencës të sipërmarrjeve italiane. Ne do të kërkonim prej jush që të ndihmonit që në jug të vinin edhe sipërmarrjet italiane si Conad dhe aktivitete të tjera ekonomike italiane. Rivënia në funksion e Aeroportit të Gjirokastrës do të përbënte një element shumë të rëndësishëm për zhvillimin e Rajonit Jugor. Dëshirojmë që ndihma edhe bashkëpunimi Italian për riaktivizimin e aeroportit të jetë një nga pikat kryesore të projekteve të ardhshme dypalëshe për ta kthyer funksional pa përjashtuar këtu edhe përfshirjen e investitorëve private italiane.

Turizmi është një tjetër sektor shumë i rëndësishëm për Rajonin Jugor. Vitet e fundit qendra historike e Gjirokastrës por edhe sitet arkeologjike kanë pasur një numër shumë të madh vizitorësh nga Italia. Rreth 60 mijë ka qenë numri i turistëve italianë që gjatë vitit që shkoi 2017 kanë vizituar rajonin tonë. Ky numër kaq i madh i turizmit Italian në rajon na shtyn që të shtojmë impenjimin dhe bashkëpunimin për të ardhmen në sektorin turistik ku konkretisht do të ishin me vlerë edhe pjesëmarrja e institucioneve lokale në projektet në kuadër të

programit IADSA e ADRION ku eksperienca italaine për turizmin dhe pasurinë kulturore do të ndihmonte në rritjen cilësore të turizmit në këtë rajon.

Duke qene se qyteti i Gjirokastrës është një qytet i mbrojtur nga UNESCO kërkojmë ndihmën tuaj për rritjen e prezencës së specialistëve, ekspertëve në lidhje me mbrojtjen dhe rehabilitimin e banesave karakteristike monument kulture si dhe rikualifikim të disa muzeve në qarkun e Gjirokastrës.

Me ndarjen e re administrative, pranë çdo bashkie janë krijuar sektorë të rinj të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi. Duke qenë se këta sektorë janë të krijuar rishtazi dhe me punonjës të pakualifikuar, do të kërkonim ndihmesën tuaj në lidhje me specializimin dhe kualifikimin e tyre për të rritur aftësitë profesionale për përballimin e situatave emergjente në zjarre, përmbytje dhe në raste tërmetesh. Gjithashtu do të kërkonim mundësinë e ndihmës nga ana juaj të ndonjë mjeti zjarrfikës të kompletuar edhe me paisjet përkatëse për heqjen e ujit gjatë përmbytjeve në banesa, biznese si dhe për evakuimin e banorëve.

Duke qenë se historikisht kemi përfituar prej prezencës italiane shumë vlera europiane, dëshirojmë të bëjmë të mundur çuarjen përpara të bashkëpunimeve të reja që do të na ndihmonin për tu integruar në familjen europiane.

Falenderojmë vendin mik Italian për mbështetjen e madhe dhe të vazhdueshme që po i jep Shqipërisë në rrugën e Integrimit Europian!

09.05.2018

Takimi me Drejtuesit e Degëve Territoriale të qarkut Gjirokastër

Të nderuar drejtues të institucioneve,

Së pari ju falenderoj për pjesëmarrjen tuaj në këtë takim dhe dëshiroj të falenderoj disa drejtues për arritjet e tyre por njëkohësisht të tërhiqja vëmendjen edhe për disa drejtues të tjerë të cilët deri tani nuk kanë pritshmëritë e duhura në realizimin e detyrave të tyre.

Siç edhe jeni në dijeni, Qeveria Shqiptare gjatë kësaj periudhe ka materializuar prioritete serioze dhe gjithpërfshirëse duke ndërmarrë reforma me një rëndësi të veçantë me qëllimi final hapjen e negociatave me Bashkimin Europian.
Reforma në drejtësi, lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, lufta kundër kultivimit të bimëve narkotike, që për vitin 2018 objektivi është 0% të sipërfaqes së kultivuar, zbutja e papunësisë duke hartuar programe pune me përfshirjen e formimit profesional, në bazë të nevojave të tregut të punës.
Përmirësimi i sistemit të ndihmës sociale, përmirësimi i klimës së biznesit dhe partneriteti me sipërmarrjen duke ofruar lehtësira fiskale nga shteti.
Reforma tërësore në sistemin e ujit të pijshëm si në përmirësimin dhe formalizimin e sistemit ashtu dhe ne rritjen e cilesise së sherbimeve duke u mbështetur me fonde nga qeveria dhe donatorë për ujësjellësa e kanalizime.

Aksioni mbarëkombëtar "Pastrojmë Shqipërinë që duam" dhe Java e Tokës e cila solli një përmirësim të dukshëm dhe për këtë do të doja të falenderoja të gjithë ju që u bëtë pjesë e këtij aksioni, por do të kërkoja që nga ana e inspektoriateve të jeni më të kujdesshëm në kontrolle dhe cilësi dhe atje ku krijohen premisa për rikthim të ndotjes të merren dhe masa administrative dhe ligjore.
Realizimi i një sërë projektesh për rilindjen rurale, përfshirja e 12 fshatrave të qarkut tonë në projektin "100 Fshatra", si element baze per zhvillimin e turizmit si burim i rëndësishëm ekonomie e zhvillimi të rajonit tonë.
Përmirësimi cilësor i arsimit, shëndetësisë dhe infrastrukturës, ofrimi i një qeverisjeje më të mirë dhe lehtësimi i shërbimeve për qytetarët dhe sipërmarrjen përmes komunikimit e teknologjisë, e shumë reforma të tjera, na bëjnë ne më të vetëdijshëm për kontributin dhe angazhimin serioz që duhet të japim në zbatimin dhe realizimin e tyre.

Po a është bërë gjithçka në qarkun tonë? Për këtë do të doja që në diskutimet tuaja të shpreheshit me qëllim përmirësimin e këtyre mangësive.

Në zbatim të këtyre politikave afatgjata të Qeverisë, sidomos ato që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me qytetarin, është shumë e rëndësishme që të përmirësojmë sa më shumë komunikimin, bashkëveprimin dhe ndërveprimin institucional dhe atë me njësitë e vetëqeverisjes vendore sepse, zgjidhen problemet e njerëzve pa humbur kohë dhe pa u sorrollatur në dyert e ndryshme të institucioneve.
Do të mbajnë përgjegjësi të gjithë ata drejtues që nuk zgjidhin ankesat në mënyrë ligjore sepse, duke mos i trajtuar në kohë këto ankesa, bie kredibiliteti i institucionit që ju drejtoni por dhe i ministrisë së linjës.
Kemi pasur disa raste ku qytetarë të ndryshëm, pasi nuk kanë gjetur zgjidhjen nga ana juaj, i janë drejtuar institucionit të Prefektit të qarkut, apo dhe raste kur ankesa dhe problemi ka ardhur nëpërmjet platformës së bashkëqeverisjes. Nëse do tw ketw raste tw ngjashme nw tw ardhmen, Prefekti i qarkut do ti drejtohet ministrit përkatës me propozim konkret.

Ajo që mbetet për t'u theksuar, është që ne të vijojmë intensivisht punën, jo vetëm si detyrim ligjor administrativ por mbi të gjitha moral, sepse të gjitha institucionet janë në shërbim të qytetarit.
Secili prej nesh duhet të ndërgjegjësohet për rolin që ka në institucionin që drejton dhe me përgjegjësi maksimale të përkushtuhen në realizimin e detyrave dhe objektivave të përcaktuara për çdo institucion në nivel vendor.
Të luftoni informalitetin dhe punën me fushata.
Të krijohet besimi në stafet tuaja dhe të bëhen përpjekje për ngritje profesionale me qëllim zbatimin korrekt të detyrës.

Për sa më sipër dhe në vazhdim, ju jeni në dijeni që në të gjithë vendin, kabineti i Kryeministrit ka filluar turin e llogaridhënies.
Gjatë këtij muaji edhe në territorin e qarkut tonë, sipas një kalendari të paracaktuar, do të ketë takime nga ana e ministrave, zv/ministrave dhe drejtues të lartë, për të bërë analizat e duhura lidhur me veprimtarinë e punës së institucioneve shtetërore vendore në qarkun tonë.

Ky takim i paraprin turit të llogaridhënies.

Siç edhe ju kemi njoftuar, kërkoj nga gjithësejcili të raportoni se ku jemi me:

- Realizimin e detyrave për 4-mujorin e parë të vitit 2018.
- Marrëdhënien me qytetarët, shërbimet dhe zgjidhja e problemeve të tyre.
- Realizimin e investimeve, me fonde të akorduara nga Buxheti i Shtetit apo donacione të tjera, në institucionin që ju drejtoni.
- Problem dhe rekomandime nga ana juaj për ministritë tuaja të linjës dhe Këshillin e Ministrave.

10.05.2018

Festa e Baba Fetahut

I nderuar President i Republikës, SH.T.Z. Ilir Meta!

Të nderuar pjesëmarrës!

Është një privilegj i veçantë që ndodhem sot mes jush, në këtë eveniment. 10 Maji është një ditë e veçantë. Është kthyer në traditë jo vetëm për Kolonjën dhe kolonjarët, por edhe për të gjithë zonën, duke mbledhur miq nga të gjitha anët. Është një festë e bukur për ju që jetoni në Kolonjë por edhe për ata që jetojnë fizikisht larg dhe me zemër janë përherë këtu.

Jam i befasuar nga mikpritja dhe bujaria juaj. Më impresionoi pafundësisht dashuria dhe respekti juaj ndaj një figure të bekuar dhe plot dritë, figurës së Baba Fetahut.

Sot Presidenti i Republikës po i akordon titullin më të lartë popullor por dekorata më e madhe që mund ti jepet është respekti që e ka merituar plotësisht dhe të kremtojmë të gjithë së bashku duke përcjellë mesazhe paqeje, dashurie dhe mirëkuptimi. Ju uroj ta vazhdojmë dhe ta festojmë 10 Majin si një ditë të bekuar për brezat!

11.05.2018

Mbledhja e Organit Këshillues të Prefektit

E nderuar znj. Mele,

Të nderuar kolegë,

Bazuar në tematikën vjetore të mbledhjeve të Organit Këshillues të Prefektit, në mbledhje do të trajtojmë dy problematika:

Tema I: Shërbimi shëndetësor në qarkun e Gjirokastrës, si shërbehet në njësitë administrative, gjendja e infrastrukturës dhe rritja e nivelit të shërbimit mjekësor në qendrat shëndetësore, për të cilën do të referoj drejtori i Drejtorisë së Shëndetit Publik z.Shpëtim Novi.

Tema II: Masat e marra për parandalimin e fenomenit të therjes dhe tregëtimit të mishit jashtë kushteve normale, në zbatim të aktit normativ të KM nr.4, datë 16.08.2012 *"Për përcaktimin e rregullave për therjen e kafshëve dhe tregëtimin e mishit të tyre"*, për të cilën do të referoj drejtori i Drejtorisë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit z. Besim Brahimi.

Këto problematika vlejnë të diskutohen edhe më shumë në këtë periudhë e cila përkon me çeljen e sezonit të ri turistik. Në lidhje me temat që po trajtojmë, do të kërkoja vlerësim dhe bashkëpunim maksimal të institucioneve përgjegjëse me njësitë e vetëqeverisjes vendore sepse janë dy procese të ndërlidhura ngushtë me njëri tjetrin dhe mosvlerësimi i drejtë i tyre mund të sjellë pasoja në jetën dhe shëndetin e banorëve të komunitetit dhe turistëve vendas e të huaj.

Ky bashkëpunim midis bashkive dhe institucioneve shëndetësore dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit të konsistojë edhe në evidentimin dhe mbajtjen në gatishmëri të qëndrave shëndetësore si dhe kontrollin rigoroz të ushqimeve sidomos atyre me bazë shtazore në mënyrë që të krijohen kushte të favorshme për trajtimin e tyre siç janë të parashikuara në aktet ligjore e nënligjore. Të gjitha këto masa paraprake do ti shërbejnë më mirë jetës në komunitet si dhe turistëve gjatë sezonit turistik në të gjthë qarkun tonë.

17.05.2018

Takimi për Turizmin

Të nderuar pjesëmarrës,

Bazuar në ligjin nr. 107/2016 "*Për Prefektin e Qarkut* ", në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 93/2015 "*Për Turizmin*" neni 20, pika 4, në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes nr. 8502, datë 24.10.2016 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit", me qëllim bashkërendimin e punës ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore, ministrisë përgjegjëse dhe institucioneve të tjera të turizmit në nivel vendor, po organizojmë mbledhjen e rradhës, bazuar në Urdhërin nr. 258 datë 23.01.2018 për Ringritjen, Organizimin dhe Funksionimin e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit në qarkun e Gjirokastrës me temë "Hapja e sezonit të ri turistik për vitin 2018" dhe "Plani i masave përgatitore të marra nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore dhe institucionet rajonale për mbarëvajtjen e sezonit të ri turistik 2018".

Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastër gjatë sezonit turistik 2017, në drejtim të organizimit të veprimtarive kulturore e artistike, për mbrojtjen dhe promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore si dhe për tërheqjen e sa më shumë vizitorëve e turistëve vendas dhe të huaj ka bashkëvepruar dhe bashkëpunuar me njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, degët territoriale që mbulojnë sektorin e Turizmit me Drejtorinë Vendore të Policisë së Qarkut si dhe me Drejtorinë e Kufirit dhe Migracionit.

Qarku i Gjirokastrës është një nga destinacionet në zhvillim për sezonin turistik dhe do të jetë ndër më të kërkuarat edhe për sezonin turistik 2018.

Në këtë kuadër institucioni i Prefektit të qarkut ka realizuar Projektin ”Krijimi i rrjetit dhe promovimi i kështjellave”, shkurt Net Castle i cili është zbatuar në bashkëpunim me Qendrën UET nga pala shqiptare dhe Rajonin e Ishujve Joniane nga pala greke. Ky projekt mbart një vlerë të jashtëzakonshme. Për herë të parë kështjellat dhe kalatë e qarkut Gjirokastër jo vetëm janë dixhitalizuar dhe hedhur në sistem 3D por mbi të gjitha, do të kenë një promovim të jashtëzakonshëm. Me pak fjalë, çdo i interesuar, në çdo anë të globit mjafton të klikojë në faqen online të projektit dhe aty mund të shohë në sistemin 3D dhe të vizitojë virtualisht 12 kështjellat e qarkut Gjirokastër, të cilat për hir të së vërtetës aktualisht janë të panjohura. Madje edhe shqiptarët jam i sigurt që njohin vetëm ato më të mëdhatë, kështjellën e Gjirokastrës, Tepelenës dhe Libohovës, por nuk e dinë që ka të tjera kështjella, të të gjitha periudhave historike, duke filluar nga antikiteti, si ajo e Kardhiqit, e Labovës së Kryqit, Shën Triadhës, Këlcyrës etj.
Qëllimi i projektit është që nëpërmjet një përpjekjeje të përbashkët të të dyja vendeve të arrijë të administrojë sfida të ngjashme kulturore.

Objektivat më kyçe të ojektit përfshijnë nxitjen e një karakteri të përbashkët, përforcimin e bashkëpunimit dhe shkëmbimeve ndërkufitare, sikundër dhe rritjen e turizmit në zonë, përmirësimin kulturor të turizmit, diferencimin e kalave nga monumentet klasike antike, sensibilizim dhe mobilizim të komunitetit lokal shkencor, fuqizimin dhe azhornimin e metodave informuese për të gjithë banorët dhe vizitorët, nëpërmjet përdorimit të teknologjive të reja, çka është dhe një kontribut në trajnimin kulturor të të rinjve.
Qarku ynë për vizitorët vendas dhe të huaj është një vend kërkues për turizëm të aventurave, për pushimin aktiv, larg turizmit masiv por i pasur me eksperienca autentike në kontakt me natyrën dhe kulturën e vendit.

Nisur nga çelja e sezonit turistik 2018, kërkohet të merren masat konkrete nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore dhe degët teritoriale për ngritjen e grupeve të punës dhe planin e masave për mbarëvajtjen e sezonit turistik 2018.

Nisur dhe nga problematikat e hasura në vitin 2017 rekomandoj si më poshtë:

- Nëpërmjet strukturave përkatëse të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të qarkut për vitin 2018 e në vazhdim duhet të punohet për liçensimin e të gjithave bizneseve të vogla të hotelerisë.
- Të gjitha bashkitë e qarkut duhet të marrin masa për të realizuar ndriçimin e objekteve muzeale, kulturore e historike.
- Kërkohet nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore dhe Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare të shikohet mundësia e rijetëzimit të disa objekteve të veçanta si kalaja e Gjirokastrës, Tepelenës, Libohovës, nëpërmjet çeljes të ambjenteve shërbyese publike (ambjente shlodhëse e freskuese, suveniresh etj.)
- Të gjitha Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore të marrin të dhëna të sakta për numrin e shtretërve në njësitë akomoduese që mbulojnë, mos të gjenden të pa përgatitur në rast të një fluksi të madh vizitorësh vendas dhe të huaj.
- Të gjitha Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore të përcaktojnë një database të detajuar të të gjitha zonave muzeale, arkeologjike dhe natyrore në territorin e tyre.
- Çdo 3- mujor nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore dhe Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare të dërgoni pranë Institucionit të Prefektit informacion të detajuar mbi numrin e turistëve vendas dhe të huaj që vizitojnë njësinë tuaj.
- Të krijohen zyra turistike pranë bashkive ku vizitorët të marrin informacionin e duhur duke e shoqëruar me fletëpalosje për të gjitha zonat turistike.

- Në objektet muzeale të vendosen ciceronë të kualifikuar (historianë dhe njohës të mirë të gjuhëve të huaja), duke bashkëpunuar me universitetin "Eqrem Çabej" për punësimin me studentë të degëve që kanë lidhje me turizmin të punësuar part-time në këto objekte.

Strukturat e Policisë së Shtetit në bashkëpunim me Njësitë e Vetëqeverisjes vendore duhet të marrin masa:

1. Për zhbllokimin dhe lënien të lira të trotuarëve në zonat pedonale dhe veçanërisht në ato muzeale të qyteteve.
2. Për të ndaluar parkimet e automjeteve në zonat muzeale.
3. Për pastrimin dhe mbajtjen pastër të zonave muzeale.
4. Për ndriçimin veçanërisht të rrugëve të qyteteve gjatë orëve të natës.
5. Për plotësimin me hidrante sidomos në zonat muzeale.

Duke qenë se parqet natyrore të rajonit të Gjirokastrës janë pika të forta të zhvillimit të qëndrueshëm turistik, mendojmë se duhet të ketë investime për hapjen kryesisht të rrugëve që hyjnë në brendësi të zonave turistike dhe investime në përmirësimin e sinjalistikës orientuese kryesisht në zonat e mbrojtura si në Bredhin e Hotovës, Sotirës dhe Zhejit.

28.06.2018

Takimi i Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit me temë "Situata aktuale turistike në qarkun e Gjirokastrës"

I nderuar z. Çeku,
Të nderuar pjesëmarrës,

Në zbatim të urdhërit të Kryeministrit nr. 39, datë 28.02.2018 "Për miratimin e planit të masave përgatitore për mbarëvajtjen e sezonit turistik veror për vitin 2018 dhe ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës, Task-Force për menaxhimin e sezonit turistik veror 2018, Mbështetur në nenin 20, të Ligjit nr. 93/2015 "Për Turizmin", si dhe në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e qarkut ", me qëllim bashkërendimin e punës ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore, ministrisë përgjegjëse dhe institucioneve të tjera të turizmit në nivel vendor, po organizojmë mbledhjen e dyte të Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit për vitin 2018 me tematikë:

1. Masat e marra nga ana e institucioneve përkatëse dhe ecuria e deri tanishme e Sezonit Turistik Veror 2018 dhe problematikat e hasura.
2. Informimi në mënyrë të detajuar i Prefektit të qarkut mbi lëvizjen e turistëve vendas dhe të huaj për periudhën 1 janar - 25 qershor 2018.

Ju bëjmë me dije se pas takimit të parë të Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit për vitin 2018, do të falenderoja z. Çeku për kontributin me mendimet dhe rekomandimet e tij, të cilat janë vënë në zbatim gjatë kësaj periudhe.
Fill pas takimit të parë, bashkitë çelën sezonin turistik veror për vitin 2018 i cili u shoqërua si me promovimin e hoteleve, bujtinave të reja si dhe kulinarisë dhe gatimet tradicionale e deri në organizimin e programeve artistike, si elementë të rëndësishëm në zhvillimin e turizmit.

Qarku i Gjirokastrës, falë pozicionit të tij gjeografik, trashëgimisë kulturore, historike dhe arkitektonike, paraqet mjaft interes në fushën e turizmit.
Zhvillimi i turizmit në mbarë vendin përbën një ndër prioritetet parësore të Programit të Qeverisë Shqiptare dhe si pjesë integrale e kësaj, është edhe zhvillimi i turizmit në qarkun tonë sot dhe në të ardhmen. Me të janë të lidhura ngushtë infrastruktura, urbanizimi, rijetësimi, industria, bujqësia etj.
Objektivi i Qeverisë për sezonin turistik 2018 është i mbështetur në tre elementë siç janë: pastërtia, siguria dhe qetësia (këto janë detyrë kryesore e njësive vendore dhe institucioneve shtetërore vendore).

Drejtimet kryesore për zhvillimin e turizmit në qarkun tonë do të jenë:

- Turizmi kulturor dhe vizita në objektet e kultit**:** vizita në kala, vende kulti, parqe arkeologjike, muze etj.
- Turizmi natyror: vizita në burimet e Ujit të Ftohtë Tepelenë, Rrapi i Hormovës Tepelenë, Bokërrimat e Dangëllisë Përmet, Rrapi i Libohovës, Bredhi i Sotirës, Uji i zi Këlcyrë, Guri i Atos fshati Kutal Përmet.
- Turizmi shëndetësor: vizita në burime termale, Bënjë Përmet.
- Turizmi familjar: bujtina të ndryshme në zonat malore të qarkut
- Turizmi sportiv rafting: kanionet e Vjosës Përmet, kanionet e Kurveleshit Tepelenë

Nga ana e Qeverisë Shqiptare janë zbatuar një sërë projektesh në zhvillim të turizmit në qarkun tonë. Mjafton të vizitohen qytetet e Gjirokastrës, Tepelenës, Libohovës, Përmetit, Këlcyrës dhe do të shihen transformimet e të gjitha qendrave të qyteteve, ku jam i bindur që falë edhe potencialeve të mëdha turistike të këtyre zonave, këto investime dhe një sërë ndërhyrjesh të tjera që janë bërë, po sjellin shumë më tepër turistë këtë vit dhe në vijim.
Ndër investimet me inpakt më të madh në zhvillimin e turizmit të qarkut vlen të përmendim.

Bashkia Gjirokastër: Rikonstruksion i qendrës historike, financuar nga Fondacioni Shqiptaro - Amerikan i Zhvillimit.
Bashkia Libohovë: Rikualifikimi urban i qendrës së qytetit Libohovë, investim i FZHR (Fondit të Zhvillimit të Rajoneve); Rikonstruksion i Kishës së Labovës së Kryqit.
Bashkia Këlcyrë: Rijetësimi i pedonaleve dhe hapësirave rekreative në sheshin qendër të bashkisë Këlcyrë. Investim i Buxhetit të Shtetit, nëpërmjet FZHR (Fondit të Zhvillimit të Rajoneve); Rikostruksioni i ish pallatit të kulturës dhe konvertimi i tij në një qendër rinore polifuksionale.
Bashkia Përmet: Në kuadër të rijetësimit të monumenteve të kulturës, në bashkinë Përmet, është realizuar projekti Rivitalizim " Guri i Përmetit".
Bashkia Tepelenë: Rikonstruksioni i sheshit të Tepelenës dhe hyrjes së kalasë, investim i FZHR (Fondit të Zhvillimit të Rajoneve); Sistemim dhe asfaltim i rrugës Dragot – Pasarele; Projekti i IPA me Bashkimin Europian për investimin e shtëpisë së Ali Pashës në vendlindjen e tij, rrit prespektivën e turizmit në rrethin e Tepelenës.
Bashkia Memaliaj: Ansambli Arkitektonik i sheshit Minatori, investim i FZHR (Fondit të Zhvillimit të Rajoneve).

Së bashku me investimet në infrastrukturë, qarku ynë është pjesë e projektit të "100 fshatrave turistikë" me 13 fshatra të përzgjedhur në të cilat do të investohet për t'u bërë sa më tërheqës për turizmin, agroturizmin dhe agropërpunimin. Këto investime janë të rëndësishme në ruajtjen e trashëgimisë, kulturës dhe zhvillimin e turizmit.

Në kuadër të sezonit turistik veror 2018, të nismës "Pastrojmë Shqipërinë që duam", e iniciuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Institucionin e Prefektit të Qarkut Gjirokastër për përmirësimin e cilësisë së mjedisit dhe mbajtjen pastër të tij dhe të "Javës së Tokës" nga data 16 deri më 22 prill në qarkun e Gjirokastrës u zhvillua aksioni mjedisor për pastrimin e segmenteve lumore më problematike të rajonit. Në këtë aksion morën pjesë bashkitë e qarkut, institucionet shtetërore në nivel vendor dhe institucionet arsimore në nivel parauniversitar.
Do të vija në dukje pjesëmarrjen dhe punën e mirë të kryer në këtë aksion nga Detashmenti i Mbrojtjes Rajonale. Si rezultat i punës së mirë të kryer gjatë javës së këtij aksioni, në rang qarku janë grumbulluar dhe transportuar në venddepozitimet përkatëse rreth 168 ton mbetje.
Pavarësisht punës të mirë të bërë në kuadër të këtij aksioni, strukturat përkatëse të njësive të vetëqeverisjes vendore kanë vazhduar punën për sensibilizimin e gjithë opinionit publik të qarkut Gjirokastër për një mjedis sa më të pastër të të gjitha vendeve aktraktive të këtij qarku.

Gjatë periudhës së deri tanishme rezulton se nga të gjithë po punohet me përkushtim për marrjen e masave dhe zbatimin e detyrave përkatëse për mikpritjen e turistëve vendas dhe të huaj që vizitojnë qarkun tonë, kjo falë edhe një bashkëpunimi të suksesshëm midis strukturave pjesëmarrëse për zhvillimin e turizmit.
Veçanërisht këtu duhet të veçoj bashkëpunimin midis strukturave të Policisë Vendore të Qarkut, Drejtorisë Rajonale të Kufirit e Migracionit dhe Njësisë Rajonale të Qarkullimit Rrugor (me të cilat janë zhvilluar takime me drejtuesit e Policisë).

Po kështu, nga Drejtoria Rajonale e Rrugëve, në prag të sezonit turistik veror 2018, është intensifikuar puna për kryerjen e punimeve të nevojshme për përmirësimin e gjendjes të akseve rrugore nacionale në administrimin e saj.
Konkretisht këto punime konsistojnë në riparimin e shtresave me asfaltobeton të segmenteve të dëmtuara si dhe në përmirësimin e sinjalistikës horizontale dhe vertikale (ndërtimi i urës se re tek varezat e qytetit të Gjirokastrës, murit i trupit të rrugës në segmentin rrugor Jorgucat – Qafë e Muzinës, vënia në funksion e ndriçimit në segmentin Postobllok – Ura e Lumit Gjirokastër).

Përfitoj nga rasti të vë në dukje se edhe nga Drejtoria e Shëndetit Publik të qarkut, Spitali Rajonal, Drejtoria Rajonale e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit dhe Drejtoria e Doganës Kakavije janë marrë masa konkrete për mbarëvajtjen e sezonit turistik veror 2018 në qarkun tonë. (takime me personelin mjekësor të qendrave shëndetësore të bashkisë Dropull).

Një rol të veçantë në drejtim të zhvillimit të turizmit në rajonin tonë po luajnë dhe po bëhen pjesë aktive e punës edhe mediat lokale të shkruara dhe elektronike, shtetërore dhe private. Nëpërmjet punës së tyre sistematike dalin në pah problematikat e ndryshme duke bërë vazhdimisht sensibilizime në favor të zgjidhjes së tyre.

Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastër ka ndjekur dhe po ndjek hap pas hapi zhvillimin e turizmit në rajonin e Gjirokastrës nëpërmjet takimeve të punës me drejtuesit e strukturave përkatëse dhe informacioneve të herpashershme duke caktuar edhe detyra konkrete për mbarëvajtjen e sezonit turistik veror 2018 në qarkun tonë.

Numri i vizitorëve vendas dhe të huaj që kanë vizituar qarkun tonë për periudhën janar-qershor 2018 ka qënë:

- Bashkia Gjirokastër: 35 000 vizitorë
- Bashkia Përmet: 6000 vizitorë
- Bashkia Tepelenë: 3000 vizitorë
- Bashkia Libohovë: 2600 vizitorë

Ftoj antarët e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit dhe të ftuarit të marin fjalën dhe të diskutojmë për masat e marra në mbarëvajtjen sa më të mirë të sezonit turistik veror 2018.

10.07.2018

Takimi me Ambasadorin e Turqisë Z. Murat Ahmet Yoruk

I nderuar SHT. Z. Ambasador,

Ju uroj përzemërsisht mirëseardhjen në Qytetin e Gurtë, në qytetin e traditës, në qytetin e turizmit. Për ne është gjithmonë kënaqësi të jemi pjesë e takimeve të tilla miqësore dhe vëllazërore. Kulturat dhe traditat tona janë shumë të ngjashme dhe sigurisht kjo ngjashmëri na bënë të jemi dhe më të afërt dhe ta mbështesim fort njëri-tjetrin. Ndër vite është ndjerë mbështetja e shtetit turk ndaj shtetit tonë dhe sigurisht kjo gjë do të vazhdojë.

Edhe pse jeni në një periudhë relativisht të shkurtër në Shqipëri ju keni treguar mbështetjen tuaj në situatat e vështira që ka kaluar vendi ynë dhe ne për këtë ju jemi mirënjohës. Një fjalë e urtë e popullit tonë të mençur thotë ”Miku i mirë duket në ditë të vështira!”. Marrëdhëniet midis shteteve tona janë shumë të mira në të gjitha fushat dhe drejtimet por sigurisht ne do të dëshironim që marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare midis vendeve tona të mund të pasqyrojnë një potencial akoma edhe më të lartë. Ne dëshirojmë që investimet turke në Shqipëri të thellohen dhe te zgjerohen më tej. Sigurisht vendi ynë i zotëron të gjitha potencialet për investime të ndryshme në fusha të ndryshme , si ekonomi, arsim, shëndetësi, turizëm etj.

Qarku ynë është një qark arsimdashës të cilët janë në gjendje t’i përgjigjen pozitivisht çdo thirrjeje punësimi që do t’u bëhej dhe ky është një avantazh për çdo kompani e cila synon të ketë efektivitet. Të rinjtë tanë janë të etur për punë dhe sigurisht një fuqi punëtore e re s’ka si mos të jetë produktive.

Një sektor tjetër mjaft i rëndësishëm për rajonin jugor është edhe turizmi, për të cilin ne do të donim, prej jush, një kujdes akoma edhe më të veçantë. Rajoni ynë ofron shumë mundësi në sektorin e turizmit, si kështjella, qendra historike, muze, banesa karakteristike, monumente kulture dhe sigurisht ja vlen të vizitohet. Vendi juaj ka një përvojë dhe eksperiencë shumëvjeçare në fushën e turizmit dhe mbështetja juaj për ne do të ishte padiskutim kuptimplotë dhe e mirëpritur. Do të dëshironim që të kishim shumë vizitorë nga Turqia. Investimi i biznesit turk në qytetin e Gjirokastrës në hapjen e fabrikës fasone ka bërë të mundur punësimin e rreth 100 punonjësve. Ne jemi përpjekur t’i përkrahim dhe mbështesim investitorët duke ua bërë më të lehtë dhe më komode punën dhe investimin në vendin tonë.

Një sektor tjetër që ndodhet në hapat e parë të zhvillimit është edhe ai i agroturizmit. Ekperienca juaj, për ne, edhe ne këtë sektor do të ishte mjaft me vlerë . Shteti shqiptar po bën investime të rëndësishme në këtë sektor dhe synimi ynë është zhvillimi i mëtejshëm i tij. Aktualisht do të ndërtohen 100 fshatra turistike, ku nga këto 13 janë në qarkun tonë. Për këtë do të kërkonim një mbështetje nga ana juaj edhe për ndihmesën në ndërtimin e fshatrave ku të krijohen kushte turistike.

Sigurisht duke marrë shtysë nga përpjekjet tuaja për të zhvilluar akoma edhe më tej bashkëpunimin kulturor ndërmjet vendeve tona, ne do të donim që edhe qyteti ynë të ishte një prej destinacioneve tuaja në zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme kulturore. Gjirokastra është djep kulture me pionerë teatri, me Qendrën Kulturore dhe grupet polifonike.

11.07.2018

Takimi mbi shqetësimet dhe problematikat e personave me aftësi të kufizuara

Të nderuar pjesëmarrës,

Çdo takim është i veçantë dhe ka rëndësinë e vetë por ky i sotmi është i një rëndësie të veçantë pasi do të diskutojmë dhe trajtojmë një tematikë të ndjeshme dhe thelbësore të shoqërisë "Shqetësimet dhe problematikat e personave me aftësi të kufizuara".

Është shumë e rëndësishme që ju si pjesë e komunitetit të këtij qarku ta ndjeni veten të mirë integruar në të gjitha hallkat e tij, që zëri juaj të dëgjohet dhe të ndjeheni të mbështetur dhe të përkrahur maksimalisht nga të gjitha institucionet shtetërore.

Shqetësimet dhe problematikat që hasin personat me aftësi të kufizuar janë prioritet i Qeverisë dhe duhet të gjejnë zgjidhjen e duhur nga pushteti vendor, strukturat e të cilit nuk duhet të krijojnë distancë por të jenë një aleat i ngushtë i juaji duke ju mbështetur dhe përkrahur maksimalisht. Qarku i Gjirokastrës nga vetë pozicioni gjeografik ku shtrihet e bën më të vështirë por sigurisht jo të pamundur përmirësimin dhe përshtatjen e infrastrukturës rrugore dhe te godinave në mënyrë të tillë që ta lehtësojnë aktivitetin tuaj të përditshëm.

Në bazë të ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" të ndryshuar, në nenin 45/1 "Kushti për përshtatshmërinë e mjedisit" i cili citon që të gjitha ndërtimet për banesa, hapësira dhe shërbime për publikun, përfshirë parqet, sheshet, rrugët, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, duhet të plotësojnë kërkesat dhe standartet e përshtatshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, sipas dispozitave të përcaktuara në rregulloren për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara. Pra, është detyrim me ligj që çdo projektim dhe ndërtim duhet të respektojë infrastrukturën për aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara. Çdo problematikë dhe nevojë që ju keni duhet të bëhet pjesë e buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore për infrastrukturën dhe shërbimet sociale.

Një problem i rëndësishëm mbetet gjithashtu kujdesi shëndetësor ndaj personave me aftësi të kufizuara ku theksoj se duhet të krijohen kushte për t'ju lehtësuar jetesën, të mbështetet integrimi social dhe ekonomik i tyre. Që një shoqëri të përparojë me hapat e duhura duhet të kujdeset për çdo grup, shtresë dhe individ në veçanti. Por kujdesi duhet të jetë akoma edhe më i veçantë për ata persona që e kanë më të nevojshme ndihmën dhe përkrahjen tonë.

Problematika është e madhe por qëllimi duhet të jetë një dhe i përbashkët "Të investojmë dhe te përkrahim çdo herë edhe më shumë".

Theksoj edhe njëherë se institucionet shtetërore dhe shoqëria civile duhet t'i kushtojnë vëmendje maksimale krijimit të kushteve thelbësore për integrimin dhe funksionimin tuaj të plotë në shoqëri. Detyra jonë është të ndihmojmë në ngritjen e mirëqënies suaj dhe mbulimin e shërbimeve tuaja bazë.

Duke besuar në atë ç'ka po bëjmë sot dhe duke patur bindjen se është një gur i rëndësishëm për të ndërtuar atë çfarë duam të arrijmë në të ardhmen, ju falenderoj dhe ju uroj nga zemra gjithë të mirat!

18.07.2018

Përurimi i bustit të patriotit Bajram Ligu

Të nderuar pjesëmarrës,

Në emër të Institucionit të Prefektit ju falenderoj për ftesën,

I nxitur nga fjalët e parathënies së librit "Prongjia dhe banorët e saj" të organizatorit kryesor Xhevat Lluri, që familja dhe shoqëria shenjtërohen kur kujtohen e nderohen të parët tanë dhe vendlindja e tyre, dëshiroj ta çel fjalën time me shprehjen e një filozofi i cili thotë "Një vullnet të ri po u mësoj njerëzve, ta duan atë rrugë që njeriu ka përshkruar, ta quajmë të mirë çdo gjë që është trashëguar duhet ta dini që është bërë me gjak". Në rast se ne do ta hedhim poshtë këtë, do të zhdukim dëshmitë. Akulli i vetmisë do të na bëjë të dridhemi, pra do të jemi pa të kaluar, si të tillë do të jemi dhe pa të ardhme.

Akti i sotëm i përurimit të bustit të patriotit Bajram Ligu, ose siç njihet Bajram Prongjia, në kuadër të 110 vjetorit të luftës së Mashkullorës është shumë domethënës.

Prongjia, ky fshat në zemër të maleve të krahinës labe të Kardhiqit, shtrihet në një lëndinë të bukur, të sheshtë, në këmbët e malit të Bajramos. Për vetë pozicionin e saj Prongjia ka qënë strehë e shumë atdhetarëve. Këtu kishte strehën edhe çeta e komanduar nga Çerçiz Topulli. Duke qënë një vatër e tillë Prongjia është regjistruar në historiografinë shqiptare edhe si vendlindja e vendedukimi patriotik i njërit prej luftëtarëve trima të çetës së Çerçiz Topullit e Mihal Gramenos e bashkë atentatorit Hito Habilin (Hito Lekdushi a Hito Labi), e vrasjes së bimbashit turk në Gjirokastër në fillim të marsit 1908, Bajram Ligut ose Bajram Prongjisë. Akti trimëror që këta dy bij të labërisë kryen atë mars flakërimë të 1908, ndezi zjarr zemrat e djalërisë gjirokastrite e mbarë shqiptarëve, ndaj edhe populli e përjetësoi me këngë. Ky ishte një aksion që bëri bujë jo vetëm në Gjirokastër, troje e përreth, por edhe përtej kufijve. Bimbashi kreu shumë arrestime, mori masa shtrënguese ndaj popullsisë së prefekturës, prandaj Komiteti i Gjirokastrës dhe Komiteti "Për lirinë e Shqipërisë, mori vendim për ta dënuar me vdekje".

Dy luftëtarët e lirisë u pregatitën për vrasjen dhe u veshën si tregëtarë. Pas dy ditë qëndrimi në qytet, më 13 mars në orën 11^{15} në lagjen Harmurat, me gjakftohtësinë më të madhe, koburet e dy trimave të labërisë shtinë mbi Bimbashin dhe Lamçen (bodigardin e tij), që tentoi të mbronte bimbashin. Bimbashi mbeti i vrarë, ndërsa bodigardin e plagosën në dorë.

Akti i guximshëm tronditi portën e lartë. Patrioti Bajram Prongjia ka marrë pjesë në të gjitha aksionet e çetës, duke u shquar për guxim, trimëri, besnikëri e atdhetarizëm të flaktë. Edhe pas shpërndarjes së çetës, ai se ndali veprimtarinë e vet. Duke mbetur kështu një figurë e ndritur në zemrat e shqiptarëve duke e përjetësuar me ngritjen e këtij busti, për të cilën kemi falenderimet më të thella për të gjithë ata që e mbështetën.

Për ta mbyllur fjalën time, me sa kam mundur të njoh në takime dhe biseda dhe në vizitën time të dytë në Prongji dalin në pah dhe burra të tjerë trima dhe intelektualë të zotë si Majko Lluri, Gjergjo Jani, Stefan Maliko, Hasko Kasi, Koli Jani, Hamza Makashi, Hajro Skreli, Remzi e Dalip Aloçi, Ajaz Bala si dhe kolegu im, Baki Bala, sot Prefekt i qarkut Fier, Xhevat Lluri, publicist dhe krijues, Panajot Vasili (sinapi) karikaturisti i njohur, Vangjel Jani mjek, Ruzhdi Lluri aktor i talentuar i estradës Gjirokastër, Sabri e Skënder Skëndo, këngëtar popullorë, Jaho Skreli dhe më i riu Ilir Lluri regjisor i teatrit, e shumë e shumë të tjerë duke ju kërkuar ndjesë që nuk po i përmend.

Të dashur banorë të Prongjisë ju falenderoj nga zemra që nga gjiri juaj keni nxjerrë njerëz të tillë si Patrioti Bajram Ligu, ju falenderoj që e mbani gjallë figurën e tij dhe na jepni të gjithëve mesazhe pozitive.

19.07.2018
Çelja e projektit "THEMA"

Të nderuar partnerë!

Jam shumë i nderuar që sot në ambjentet e institucionit të Prefektit të qarkut Gjirokastër, në prezencën e të gjithë neve çelet dhe zhvillohet takimi i parë i partnerëve pjesëmarrës të projektit THEMA. Përfitoj nga rasti të falenderoj përfaqësuesit e Agjensisë së Epirit S.A, përfaqësuesit e Shoqërisë së hotelerisë Janinë, përfaqësuesit e Qëndrës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Rajonal dhe përfaqësuesit e Agjensisë Kombëtare të Turizmit në Tiranë.

Gjatë viteve të fundit institucioni i Prefektit të qarkut Gjirokastër në kuadër të projekteve ndërkufitare Interreg-IPA, ka përfituar dhe realizuar disa projekte që kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik dhe kulturor të qarkut Gjirokastër. Së fundmi institucioni jonë ka realizuar Projektin "Krijimi i rrjetit dhe promovimi i kështjellave", shkurt Net Castle projekt ky i realizuar dhe është zbatuar në bashkëpunim me qëndrën UET nga pala shqiptare dhe Rajonin e Ishujve Joniane nga pala greke. Ky projekt mbart një vlerë të jashtëzakonshme. Për herë të parë kështjellat dhe kalatë e qarkut Gjirokastër jo vetëm janë dixhitalizuar dhe hedhur në sistem 3D por mbi të gjitha do të kenë një promovim të jashtëzakonshëm.
Me pak fjalë, çdo i interesuar, në çdo anë të globit mjafton të klikojë në websiten e projektit dhe aty mund të shohë në sistemin 3D dhe të vizitojë virtualisht 12 kështjellat e qarkut Gjirokastër, të cilat për hir të së vërtetës aktualisht janë të panjohura. Madje edhe shqiptarët jam i sigurt që njohin vetëm ato më të mëdhatë, kështjellën e Gjirokastrës, Tepelenës dhe Libohovës por nuk e dinë që ka të tjera kështjella, të të gjitha periudhave historike, duke filluar nga antikiteti, si ajo e Kardhiqit, e Labovës së Kryqit, Shën Triadhës, Këlcyrës etj.
Projekti Thema për të cilën ne bashkarisht do ta realizojmë, përkon edhe me prioritetin e Qeverisë Shqiptare për "Akademinë e zhvillimit të 100 fshatrave turistikë" në të 12 qarqet e Shqipërisë ndër të cilat 13 prej tyre janë të përzgjedhura në qarkun Gjirokastër.

Të gjithë së bashku kemi marrë përsipër të realizojmë projektin THEMA i cili ofron një zgjidhje për rritjen dhe zhvillimin e zonave ndërkufitare duke përdorur teknologjitë e reja. Thema krijon inovacione në tri nivele, atë teknologjik, përmbajtësor dhe në nivelin social.

Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti është i dyfishtë:

a. Të përmirësojë përvojën e përgjithshme të përdoruesve që veprojnë si turistë në rajonin ndërkufitar.
b. Të rrisë trashëgiminë natyrore dhe kulturore të rajonit përmes teknologjisë bashkëkohore dhe turizmit tematik, përmes rritjes së interesit të audiencës dhe ofrimin e shërbimeve të avancuara dhe cilësore për të gjithë.

Projekti THEMA krijon objektiva të posaçme në përforcimin e përvojës së turistëve në zonën ndërkufitare dhe promovimin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore përmes teknologjisë së re. Kjo do të çojë në ofrimin e shërbimeve cilësore që mund të tërheqin audiencë të re (të rinjtë, tifozët e turizmit tematik) dhe do të zgjeroj vizitën e tyre në këto zona, pasi përmes rrugëve tematike dhe aplikacionit celular paraqitet një sërë opsionesh dhe përmbajtjesh përdoruesit, ndërsa, përmes mekanizmit të shpërblimit, turistët kanë motive shtesë.
Profesionistët mund të shfrytëzojnë paketat tematike dhe rrugët e ofruara nga projekti THEMA, me qëllim promovimin e biznesit të tyre, duke rritur konkurrueshmërinë e tyre në tregun e kërkuar të sektorit të turizmit.
Duke ju uruar punë të mbarë, ju uroj sukese në realizimin e objektivave të përcaktuara në këtë projekt.

25.07.2018

Takimi i Komitetit Rajonal Antitrafik

Të nderuar anëtar të Komitetit Rajonal Antitrafik,
Të nderuar të ftuar,

Organizojmë këtë takim të rradhës të Komitetit Rajonal Antitrafik të Qarkut Gjirokastër për të analizuar punën e bërë nga ana e institucioneve ligjëzbatuese kundër fenomenit të trafikimit të qënieve njerëzore, miratimin me disa ndryshime Rregulloren për "Funksionimin e Komitetit Rajonal të Luftës Kundër Trafikimit të Personave " si dhe me njohjen e "Planit të Veprimit Vjetor" të këtij Komiteti.
Për herë të parë janë të ftuar edhe drejtues të institucioneve jo qeveritare, pjesë e Unionit " Stop Krimit" z. Maksim Ferra, Drejtori Ekzekutiv Tiranë, z. Ylli Toska filiali Durrës, z. Stavri Bobo, Filiali Berat dhe z. Arben Hoxha, filiali Gjirokastër.

Më vjen mirë të konfirmoj se nëpërmjet informacioneve zyrtare të ardhura nga institucionet ligjëzbatuese tregojnë nivelin në minimum të trafikut të qënieve njerëzore për qarkun tonë, megjithatë duhet të vazhdojmë punën duke qënë në gadishmëri maksimale përsa i përket parandalimit të trafikimit të qënieve njerëzore por edhe dhënies ndihmë nëse do të kemi raste.
Më lejoni të shpreh vlerësimin mbi angazhimin tuaj personal dhe të institucioneve që drejtoni në luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore i pasqyruar në punën serioze dhe me kompetencë nga ana e Komitetit Rajonal Antitrafik të Qarkut tonë, të treguar përgjatë gjithë periudhës duke filluar nga momenti i ringritjes së këtij komiteti e deri më tani.

Trafikimi i personave sot është një sfidë reale ndaj sistemit tonë të vlerave shoqërore e njerëzore si dhe ndaj sistemit të së drejtës dhe respektimit të ligjit, si shkelje e hapur ndaj të drejtave themelore të njeriut, lirisë dhe dinjitetit njerëzor.

Për këtë kërkohet angazhimi individual i gjithë aktorëve në këtë fushë madje dhe i vetë viktimave, për t'a kthyer luftën kundër fenomenit në një kauzë kombatare në mbrojtje të më të dobtëve dhe të atyre që duan që zeri i tyre të dëgjohet.
Në radhë të parë si qytetarë të këtij vendi, por edhe si përfaqësues të institucione që drejtojmë të gjithë së bashku kemi mbi të gjitha përgjegjësi qytetare për t'u angazhuar në identifikimin e trafikimit dhe në përfshirjen e komunitetit për tu bërë pjesë aktive e veprimit kundër trafikimit të personave në Qarkun tonë por dhe më gjërë.
Sigurisht që parandalimit i trafikimit dhe lufta ndaj tij në radhë të parë është sfidë e organeve ligjzbatuese por asnjë strukturë ose institucion nuk do kishte sukses në këtë "beteje" pa mbështetjen dhe përfshirjen e gjithë shoqërise. Një përfshirje nëpërmjet informimit për të gjitha rastet e trafikimit apo trafikimit të mundshëm që mund të konstatohen nga qytetaret në bashkëpunim pët të krijuar më shumë mundësi për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave.
Përtej ndaj gjithë asaj ç'ka kemi arritur deri tani në duhet të jemi të ndërgjegjshëm se çështja e luftës kundër trafikimit të personave është shumë komplekse dhe kërkon një ndërgjegjësim të përgjithshëm shoqëror.

Vetëm nëse kthejmë vështrimin tonë drejt viktimave të këtij krimi qofshin ata fëmijë që detyrohen të punojnë në kushte të papërshtatshme për moshën dhe zhvillimin e tyre , vajza të reja të cilat bien pre e mashtrimit dhe abezimit apo gra të privuara nga e drejta për të zgjedhur vetë jetën që duan të jetojnë ne do mund ti kthejmë shoqërisë vlerat dhe dinjitetin njerëzor të duhur. Janë vetë viktimat dhe historitë e tyre ato që duhet të orientijnë hapat që ne duhet të marrim për të vënë para përgjegjësise trafikantët dhe përfituesit nga kjo industri e fuqishme ilegale si dhe për të vendosur në vend dinjitetin e viktimave të këtij krimi çnjerëzor.

Strategjia e luftës kundër trafikimit të personave dhe Plani i Veprimit janë udhërrëfyesit për veprimin antitrafik në vazhdimësi në përballjen me këtë krim duke ofruar një qasje gjithpërfshirëse shumëplanëshe ër trajtimin e duhur dhe dinjitoz të viktimave të këtij krimi.
Kthimi nga jashtë shtetit dhe ndihma për riintegrimin të shtetasve shqiptarë të identifikuar apo të paidentifikuar si viktima të trafikut përbën një çeshtje që mbetet për tu adresuar, së pari si një sfidë humanitare për tu mundësuar viktimave për të rindërtuar jetën e tyre dhe të integrohen në shoqëri, por edhe për të parandaluar trafikimin apo që personat e trafikuar të kthehen në trafilantë, dukuri kjo e cila mbetet aktuale.

Faktorët social-ekonomikë mund të jenë thelbësore në rritjen e mundësisë për tu trafikikuar, por ka dhe faktorë ndërmjetës, si psh. mungesa e ndërgjegjësimit që çojnë drejt trafikimit. Trafikimi i fëmijeve mbetet një problem shqetësues. Fëmijet trafikohen për mori qëllimesh, përfshirë ato për shfrytëzim seksual, shfrytëzim duke nxjerrë në rrugë për të lypur dhe forma të tjera të punës së detyruar si brenda ashtu dhe jashtë vendit.

Pranohet fakti që pjesëmarrja e shoqërisë civile është e domosdoshme për arritjen e synimeve në luftën kundër trafikimit. Të gjithë aktorët shtetërorë dhe joshtetërorë duhet të marrin pjesë në hartimin dhe zbatimin e veprimtarisë antitrafik dhe në monitorimin e saj. Organizatat e shoqërisë civile dhe në veçanti OJF-të luajnë një rol kyç në luftën kundër trafikimit dhe si të tilla janë përfshirë aktivisht në vendimarrje. Me këtë rast dua të falenderoj edhe këta " Heronj të heshtur", që edhe pse nuk paguhen nga shteti, kanë dhënë kontribute të mëdha në luftën

kundër këtij fenomeni. Kanë gjetur me dhjetra fëmijë që janë shfrytëzuar nga " padronët me kollare" dhe kanë shpëtuar me dhjetrajetë.

Dhuna në familje shihet si një dukuri e lidhur ngushtë me trafikimin. Ajo konsiderohet si një faktor që jo vetëm i paraprin, por edhe e shoqëron fenomenin e trafikimit. Këtë e dëshmon fakti që femrat janë më të prekura nga kjo dukuri. Për këtë nevojitet nga strukturat përkatëse identifikimi sidomos i familjeve me problematika të tilla dike u ardhur në ndihmë për tejkalimin e tyre.
Bazuar në Strategjinë e Luftës kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore, dhe Planit të Veprimit 2014 – 2017 miratuar me VKM-në Nr. 814, datë 26.11.2014, dhe në Urdhërin e Kryeministrit Nr. 139, datë 19.06.2006 "Për Krijimin e Komiteteve Rajonale të luftës kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore", pranë Institucionit te Prefektit të Qarkut Gjirokastër në mbështetje të ligjit Nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut, me urdhërin nr. 28, datë 21.03.2017 pranë këtij institucioni është ringritur Komiteti Rajonal i Luftës Kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore për Qarkun e Gjirokastrës.

Fenomeni i trafikimit të qenieve njerëzore është një krim i rëndë, shkelje e të drejtave të njeriut me ndikim të drejpërdrejtë në jetën ekonomike, sociale në imazhin, traditat në zhvillimin dhe prosperitetin e vendit.
Fenomeni nuk është trajtuar vetëm si problem i Policisë, Prokurorisë, Gjykatës, por ky është një problem i gjithë shoqërisë, komunitetit, i institucioneve shtetërore dhe pushtetit vendor si dhe OJF- ve të ndryshme. Ky preokupim është manifestuar në vazhdimësi në institucionet dhe në punën e tyre në qarkun tonë.

Në shoqëritë e zhvilluara demokratike ku ne synojmë të arrijmë, fenomenet negative edhe trafikimi i qënieve njerëzore nuk mbulohen as minimizohen përkundrazi bëhen pjesë e zgjidhjes përmes programimit dhe angazhimit të të gjithë faktorëve.
Në këtë filozofi Komiteti Rajonal Antitrafik i Qarkut Gjirokastër mbështetur në strategjinë dhe në Planin Kombëtar të Qeverisë kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore ka qenë sensibilizues dhe dobiprurës në veprimtarinë e tij.

Në Qarkun e Gjirokastrës në zbatim të strategjisë dhe planit kombëtar kundër trafikimit të qënieve njerëzore, Komiteti Rajonal Antitrafik është ngritur dhe funksionon prej vitit 2006. Vitet e fundit ky fenomen ka ardhur duke u reduktuar në menyrë të ndjeshme.
Me gjithe rezultatet e arritura, Qarku jonë është në pozicion të ekspozuar ndaj këtij fenomeni si pikë nyje, pranë zonës kufitare. Duke qenë te vetëdijshëm për riskun, Komiteti Rajonal Anti-Trafik në planin e veprimit të tij ka mbajtur parasysh disa drejtime kryesore:
Punën për parandalimin e fenomenit. Siç thamë dhe më lart për shkak të qarkullimit të lirë, zonës kufitare etj. në fushatën sensibilizuese ka patur në fokus Fëmijët, Vajzat dhe Fëmijët në nevojë.

Rëndësi e veçantë i është kushtuar sistemimit dhe mbrojtjes së fëmijëve nëpër shkolla. Për këtë rol kryesor kanë patur psikologët dhe sidomos bashkëpunimi i tyre me gjithë strukturat e tjera të arsimit. Efektive ka qenë puna e njësive mbrojtëse të fëmijëve në bashkitë e Qarkut tonë, të cilat kanë shërbyer si bërthama të identifikimit. Njësitë e Qeverisjes Vendore kanë grupet kërkimore në komunitet, lagje, fshatra. Keto njësi të mbrojtjes së fëmijëve kanë bërë punë të mirë në drejtim të rregjistrimit të fëmijëve në shkolla, përfshirjes së familjeve në nevojë në skemën e ndihmës ekonomike, këshillime dhe shërbime të tjera sipas nevojës.
Kordinimi i planit të veprimit nga Komiteti Rajonal Antitrafik, i cili ka patur në fokus adresimin e problemeve. Ky fenomen ka qenë në vemendje të të gjitha strukturave të KRAT-

i, Tryezës Teknike, Policisë Vendore, Drejtorisë Rajonale Arsimore, Institucioneve të Pushtetit Vendor, OJV-ve, etj.

Prefekti i Qarkut Gjirokastër është i gatshëm që ashtu si deri tani të vijojë të jetë promotor i një bashëpunimi ndërinstitucional, dhe ndërqytetar, të promovojë e të mbështesë nisma si dhe të ndikoje fuqishëm me strukturat e qarkut në fushata sensibilizuese në parandalimin dhe luftën pa kompromis ndaj këtij fenomeni

26.07.2018

Takimi i Organit Këshillues i Prefektit për parandalimin e zjarreve 2018

Në bazë të programit vjetor të Organit Këshillues të Prefektit, sot zhvillojmë takimin me Tematikë: "Marrja e masave për parandalimin e zjarreve në stinën e verës, bashkëpunimi i ngushtë i Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve me organet e vetqeverisjes vendore dhe komunitetit në përgjithësi dhe ruajtja e objekteve të rëndësisë së veçantë në qark".

Ky takim zhvillohet në vazhdim të mbledhjes së Task Forcës Rajonale, zhvilluar më 25 maj 2018, "Për marrjen e masave parandaluese në përballimin e emergjencave për zjarret në pyje dhe kullota gjatë periudhës qershor – shtator 2018".

Për menaxhimin e zjarreve në pyje dhe kullota, është hartuar plani i masave dhe është dërguar urdhëri i Prefektit për të gjithë strukturat ligjzbatuese për menaxhimin e zjarreve të pritshme, ku vëmendje e veçantë i është kushtuar ruajtjes së parqeve kombëtare, pyjeve dhe kullotave, garantimit të turizmit malor gjatë sezonit turistik veror. Në këtë kuadër është siguruar bashkëpunimi me të gjitha strukturat vartëse të Ministrise së Mjedisit, si Inspektoriati Pyjor, Inspektoriati Mjedisor si dhe me strukturat e Bashkive në rang qarku. Është bashkëpunuar dhe kemi siguruar mbështetjen e Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave sidomos për territoret tepër të vështira për fikjen e zjarreve nëpërmjet ajrit.

Nisur nga shtrirja gjeografike, qarku Gjirokastër përbëhet prej 45.104 ha të sipërfaqes me tokë të punueshme, 95.533 ha kullota, 84.662 ha pyje, shkurre dhe drurë të ndryshëm.

Gjatë vitit të kaluar si rezultat i rënies së zjarreve kanë ndodhur këto dëme të ndara në rrethe dhe bashki si më poshtë:

Në rrethin e Përmetit janë djegur rreth 8.7 ha pyje e kullota.
Në rrethin Gjirokastër janë djegur rreth 3066.55 ha pyje e kullota.
Në rrethin Tepelenë janë djegur rreth 154.6 ha pyje e kullota.
Në total si qark janë djegur rreth 3228.65 ha kullota, shkurre e pyje.

Bashkia Gjirokastër: vatra zjarri 19, sipërfaqe 30 ha,
Bashkia Libohovë: vatra zjarri 5, sipërfaqe e përshkuar 400.55 ha, sipërfaqe e djegur 300.55 ha, dëmi ekonomik 776.600 lek.
Bashkia Dropull: vatra zjarri 45, sipërfaqe e përshkuar 2736 ha, sipërfaqe e djegur 2736 ha
Bashkia Tepelenë: vatra zjarri 15, sipërfaqe e përshkuar 122.6 ha, sipërfaqe e djegur 122.6 ha, pemë frutore 2300, koshere blete 55, dëmi ekonomik 234.024 lek.
Bashkia Memaliaj: vatra zjarri 6, sipërfaqe e përshkuar 32 ha, sipërfaqe e djegur 32 ha, pemë frutore 50 rrënjë ullinj.
Bashkia Përmet: vatra zjarri 18, sipërfaqe e përshkuar 9 ha, sipërfaqe e djegur 7.5 ha.

Bashkia Këlcyrë: vatra zjarri 13, sipërfaqe e përshkuar 7.22 ha, sipërfaqe e djegur 1.2 ha.

Nga analizimi i rënies së zjarreve për vitin 2017 theksojmë se mbi 90% i tyre kanë qënë si rezultat i vënies së zjarreve nga ana e personave për rigjenerimin e kullotave, të cilat kanë çuar deri në mos menaxhim të situatës nga ana e sektorit të MZSH-së pranë bashkive, por edhe në rastet kur është kërkuar ndihma nga ajri dhe si përfundim janë djegur sipërfaqe të mëdha me pyje dhe ku janë rrezikuar edhe banesa të qytetarëve.

Nisur nga këto problematika Task Forca Rajonale e ngritur për vitin 2018 do të rishikojë me përgjegjësi dhe kompetencë planin e masave për organizimin dhe përgjigjen në kohë nga ana e strukturave shtetërore dhe ato lokale duke parashikuar masa parandaluese dhe rregulluese ndaj rënies së zjarreve mbi sipërfaqet pyjore dhe ato të kullotave gjatë verës së këtij viti.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore, kryetarët e bashkive, nëpërmjet strukturave përkatëse të tyre të shërbimit të MZSH-së si dhe në veçanti strukturat e shërbimit pyjor, për të ruajtur sipërfaqet pyjore dhe ato të kullotave duhet të organizojnë punën me grupe vullnetare dhe ato vrojtuese për inspektimin e përhershëm të pyjeve dhe kullotave dhe marrjen e masave parandaluese për mbrojtjen nga rreziku i zjarrit.

Në zbatim të VKM-së Nr.1080, datë 22.12.2010 "Për rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe në kullota, si dhe për krijimin e njësive vullnetare të shuarjes së zjarreve" dhe për Udhëzimin e Përbashkët me Ministrinë e Brendshme (Pushtetin Vendor), në bazë fshati, janë organizuar skuadrat vullnetare të gadishmërisë për MNZSH-në me elementë të përkushtuar të komunitetit, në krye të të cilave janë kryetarët e fshatrave dhe ku janë përgatitur listat me emrat e vullnetarëve, numrat e kontaktit si dhe mjetet që kanë në dispozicion në raste të ndërhyrjes për fikjen e zjarreve.

Gjatë kësaj periudhe Drejtoria e Policisë Vendore të Qarkut në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe shërbimin e MZSH kanë organizuar takime me komunitetin, me administratorët e njësive vendore, kryetarët e fshatrave, me personat që kanë marrë me qera kullotat dhe kanë sensibilizuar opinionin për njohjen me legjislacionin, penalitetet në zjarrvëniet e qëllimshme dhe nga pakujdesitë, të cilat sjellin pasoja të pallogaritshme për ekonominë tonë në rënien e zjarreve në pyje dhe kullota.

Nga ana e Prefektit të Qarkut do të ushtrohen të gjitha funksionet e tij, në shkëmbimin e informacionit, në menaxhimin e çdo emergjence me strukturat qendrore në qark, në veçanti gjatë këtij sezoni për zjarret në sipërfaqet pyjore. Për rastet kur situata emergjente zjarresh të papërballueshme duke bashkëpunuar me ju, do të kërkojmë ndihmë për pjesëmarrjen e forcave të tjera nga Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile si dhe do të realizojmë koordinimin e të gjtha forcave për parandalimin, ndërhyrjen dhe eliminimin e këtyre lloj emergjencash. Nga bashkitë kërkohet realizimi, koordinimi dhe ndjekja në vazhdimësi i detyrimeve ligjore dhe porosive të dhëna.

Për sa më sipër, kërkojmë të informohet me shkrim çdo ditë të premte ora 12:00 (qershor-shtator) për sezonin e stinës së nxehtë pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Gjirokastër në lidhje me ndjekjen nga ana e njësive të vetqeverisjes vendore dhe institucionet shtetërore që bëjnë pjesë në TFR gjithë problematikat e ndodhura për zjarret në pyje dhe kullota.

Në rolin e kryetarit të Komisionit të Planifikimit dhe Përballimit të EC dhe krizave dhe Task Forcës Rajonale për zjarret në rang qarku, në funksion të marrjes së masave efektive për përballimin me sukses të situatave të mundëshme emergjente, kërkoj përkushtim e vlerësim maksimal, koordinim e bashkëpunim permanent ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore,

degëve territoriale dhe strukturave shtetërore në të gjitha fazat me prioritet: parandalimin, shmangien dhe minimizimin e dëmeve në situatat që mund të krijohen për shkak të zjarreve të natyrave të ndryshme.

Bazuar ne ligjet nr.8756 dt.26.03.2001, "Për Emergjencat Civile", ligji nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", ligji nr.152 dt. 21.12.2015 "Për Shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", ligji nr.9385, datë 04.05.2005, "Për Pyjet dhe Shërbimin pyjor" dhe në zbatim të detyrimeve të Planit të Masave të Task Forcës Rajonale të Institucionit të Prefektit të Qarkut Gjirokastër, me qëllim parandalimin, përgatitjen, menaxhimin dhe përballimin e situatave që mund të shkaktohen nga zjarret për periudhën Qershor – Shtator 2018.

Ju rekomandoj për marrjen e masave paraprake nga Bashkitë, Njësitë Administrative, Strukturat e shërbimit të MZSH për planifikimin, përgatitjen e elementëve të gadishmërisë, për organizimin, parandalimin e zjarreve dhe shuarjes së tyre, rritjes së aftësive drejtuese për reagimin e menjëhershëm si dhe në bashkëpunimin dhe bashkërendimin e veprimeve me institucionet dhe strukturat e tjera të qarkut për përballimin e situatave të rënies së zjarreve.

- Rritjen e sensibilizimit institucional dhe qytetar me qëllim parandalimin e situatave por edhe përballimit me efiçensë të situatave që mund të shfaqen.
- Policisë së Shtetit i del si detyrë që në bashkëpunim edhe me Njësitë Administrative të organizoj takime me komunitetin për sensibilizimin e tyre dhe për njohjen me legjislacionin.
- Nënvizoj faktin se gjatë kësaj periudhe të gjithë strukturat planifikuese dhe operuese që janë të vendosura dhe veprojnë në të gjithë qarkun, duhet të veprojnë, duke monitoruar territorin, bashkërenduar punën sipas një skeme të mirë përcaktuar për të ndërhyrë në kohë dhe shpejtësi në çdo ngjarje zjarri që mund të krijohet.
- Në zjarrvëniet e qëllimshme por edhe në pakujdesitë që shkaktojnë zjarre, të personat përgjegjës të çohen deri në ndjekje penale dhe të mbahen e kontakte të vazhdueshme dhe të forcohen marëdheniet e bashkëpunimit me Njësitë Administrative, për shkëmbimin e informacioneve për çdo rast që mund të shfaqet.
- Bashkitë duhet të kenë në vëmëndjen e tyre zonat turistike që paraqesin rrezikshmëri më të lartë, të rivlerësojnë masat dhe strukturat përkatëse planifikuese dhe operuese, duke ushtruar kontroll periodik të këtyre zonave.
- Strukturat e Mbrojtjes ndaj Zjarrit dhe Shpëtimit (MZSH-ja) sipas planit të hartuar duhet të mbajnë në gadishmëri automjetet zjarrfikëse dhe personelin për këtë periudhë. Këto struktura duhet të raportojnë pranë Institucionit të Prefektit për situatën reale që ndodh në terren. Rëndësia e bashkëpunimit konkret, shkëmbimit të informacionit sipas skemës së situatave të emergjencave në kohë do të bëj të mundur përballimin me efiçencë të çdo situate që mund të shkaktohet gjatë kësaj periudhe.

02.08.2018

75-vjetori i Masakrës së Glinës

Të nderuar pjesëmarrës,
Të nderuar organizatorë të këtij takimi përkujtimor,
I nderuar Kryetar i Shoqatës së Veteranëve,
Të dashur miq,

Miq në ditë të mira dhe në ditë të vështira,

Është një privilegj i veçantë për mua të ndodhem sot mes jush për të kujtuar me respekt dhe përulësi, 28 dëshmorët e rënë heroikisht në luftë me pushtuesit fashist Italianë të vendosur pranë fshatit Jorgucat të Dropullit të Sipërm. Masakra e Glinës i tregoi popullit minoritar se rruga e tyre e vetme për të mbrojtur jetën dhe identitetin e tij kombëtar grek, ishte bashkimi me Frontin Nacionalçlirimtar. Minoriteti grek iu përgjigj që në fillim thirrjes së Konferencës së Pezës, me pjesëmarrjen e tij masive dhe të gjithëanshme në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare kundër pushtuesve nazifashistë, në krah të popullit Shqiptar.

Në luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare dhanë jetën e tyre për çlirimin e Shqipërisë shumë djem e vajza nga minoriteti. Midis tyre përmenden Lefter Talo dhe Theodhori Mastora të cilët janë nderuar me titullin e lartë "Hero i Popullit". Në krahasim me numrin e banorëve minoriteti etnik grek mund të renditet midis krahinave të Shqipërisë për një pjesëmarrje dhe për sakrifica të mëdha në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare. Pavarësisht kësaj masakre marrëdhëniet midis dy popujve tanë u forcuan edhe më tepër dhe u kuptua më së miri se të bashkuar ne do të jemi dhe askush s'do të mund të na përçajë.

Pas çlirimit, minoriteti grek ka dhënë kontribut të madh në ndërtimin e një Shqipërie të re, demokratike.Gjaku dhe vepra e dëshmorëve të atdheut do të respektohet përherë në kujtesën e brezave që do të vijnë.

Lavdi dëshmorëve të Atdheut!

07.08.2018

75-vjetori i themelimit të batalionit "Asim Zeneli"

Të nderuar pjesëmarrës,

Ndihem i privilegjuar dhe i emocionuar që ndodhem sot mes jush për të kujtuar së bashku momentet e krenarisë dhe nderit.

Në Kardhiq 75 vjet më parë, më 7 gusht 1943 u themelua batalioni partizan "Asim Zeneli", me në krye Riza Veipi dhe komandant Shefqet Peçi, si një nevojë e bashkimit për luftën kundër pushtuesve. Në radhët e batalionit, për lirinë e popullit ranë dëshmorë partizanët Demo Fejzo, Murat Bardhi, Hiqmet Dusha, Kapo Gaba e shumë partizanë të tjerë.

Një nga luftimet më të ashpra të batalionit përmendet ai i 2 tetorit 1943 në kështjellën e Manastirit të Cepos kundër pushtuesve gjermanë dhe ai i 16 tetorit 1943 kundër forcave tradhëtare në katundin Gjorm të Vlorës. Themelimi i këtij batalioni është një arritje historike për popullin shqiptar, rezultat i luftës patriotike dhe i përpjekjeve për liri e shtet-formim. Kjo është një epope e lavdishme e historisë tonë, ku të gjitha ato vajza e djem, burra dhe gra që u përfshinë në luftë dhe që iu kundërvunë me heroizëm fashistëve italianë dhe nazistëve gjermanë, do të mbeten përherë në mendjet e zemrat tona dhe do të gëzojnë respektin më të madh.

Sot pas 75 vjetësh, me gjithë vështirësitë e rrugës sonë si komb, mund të themi se disa nga aspiratat e këtyre vajzave dhe djemve janë realizuar. Për të gjithë shqiptarët Lufta Antifashiste Nacional Çlirimtare është një periudhë e ndritur në historinë e kombit tonë.

Lavdi Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare! Lavdi partizanëve të Batalionit "Asim Zeneli"!

04.09.2018

Takimi i Organit Këshillues të Prefektit në Bashkinë Libohovë

Të nderuar anëtar të Organit Këshillues të Prefektit,
Të nderuar të ftuar,

Së pari dua të falenderoj Kryetaren e Bashkisë Libohovë, znj. Luiza Mandi për masat e mira që ka marrë për zhvillimin e mbledhjes së Organit Këshillues të Prefektit në Bashkinë Libohovë. Kjo praktikë do të vazhdoj në muajt e ardhshëm edhe në Bashkitë e tjera, por në këto raste në vartësi të tematikës që do të zhvillojmë do të doja të ftoheshin edhe personalitete nga këto bashki për të marrë mendimet e tyre.
Bazuar në ligjin nr. 107/2016 *"Për Prefektin e Qarkut"*, neni 23 *"Për Organin Këshillues pranë Prefektit të qarkut"*, mbështetur në Udhëzimin e përbashkët midis Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Nr. 27 datë 16.08.2018 "Për vitin shkollor 2018-2019 në sistemin arsimor parauniversitar", po organizojmë këtë takim duke marrë ne analizë çështjet si më poshtë:

- Masat e marra nga DAR Gjirokastër dhe ZA Tepelenë dhe Përmet mbi fillimin e proçesit mësimor në arsimin bazë dhe arsimin e mesëm të lartë për vitin arsimor 2018 – 2019;
- Masat e marra nga ana e njësive të vetëqeverisjes vendore mbi përmirësimin e kushteve në ambjentet shkollore, kopshtet dhe çerdhet.
- Caktimi i datës dhe vendit ku do të zhvillojmë mbledhjen e ardhshme sipas tematikës së miratuar nga Organi Këshillues në fillim të vitit.

Siç jemi në dijeni, këtë takim e organizojmë sipas planit vjetor të Organit Këshillues të Prefektit, dy javë para fillimit të vitit të ri arsimor 2018-2019, për të raportuar gjendjen aktuale, mangësitë dhe problematikat që janë evidentuar dhe njëherazi për të bërë të mundur eleminimin sa më të shpejt të tyre me qëllim që viti i ri shkollor në qarkun e Gjirokastrës të nisë normalisht. Do të kërkoja që në diskutimet tuaja të fokusoheni jo vetëm mbi masat e marra për ambjentet shkollore brenda qyteteve por duke parë me një ndjesi dhe përgjegjësi më të madhe edhe shkollat që janë pozicionuara në zonat më të thella të qarkut tonë.

Ndarja e re administrative ka vënë në provë njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilat gjatë këtyre viteve kanë pasur mangësi duke filluar nga planifikimi i buxhetit, në ngritjen e strukturave për mirëmbajtjen e shkollave dhe deri tek kryerja e shërbimeve me nivele të larta për zhvillimin sa më normal të mësimit. Gjithashtu do doja të diskutojmë edhe për kushtet e krijuara për zhvillimin e praktikave mësimore pranë laboratorëve, terreneve sportive për zhvillimin e edukimit fizik dhe atij kulturor.

Institucioni i Prefektit të qarkut gjatë vitit arsimor 2017 - 2018 ka bashkëpunuar ngushtë me Drejtorinë Arsimore Rajonale Gjirokastër dhe Zyrat Arsimore në Tepelenë dhe Përmet ku ka vizituar dhe ka patur takime me personelin mësimor të disa shkollave dhe është informuar mbi arritjet në sistemin arsimor në qarkun tonë, por është njohur edhe me problematika të cilat u janë drejtuar njësive të vetëqeverisjes vendore për gjetjen e burimeve financiare dhe

zgjidhjen e tyre. Një nga këto problematika që do doja të rikujtoja ishte mos ngrohja e ambjenteve shkollore në stinën e dimrit dhe me këtë rast do të kërkoja nga ana juaj që për këtë vit të merren masa për parashikimin në buxhet "blerja e lëndëve djegëse" për krijimin e kushteve sa më të mira për një proçes sa më optimal.

Nëse do të kërkonim rezultate të larta tek nxënësit, është e domosdoshme që të gjitha institucionet që janë të lidhura me sistemin arsimor të krijojnë kushte sa më optimale në ambjentet shkollore, por do të theksoja se një rëndësi të veçantë duhet ti kushtohet organizimit të lëvizjes së nxënësve dhe mësuesve nga qendrat e banuara drejt ambjenteve shkollore dhe sidomos për zonat e thella rurale. Në këtë pikë, mban përgjegjësi jo vetëm Drejtoria Arsimore Rajonale por dhe Drejtoria e Policisë Vendore, Drejtoria e Kontrollit të Automjeteve e cila duhet të ushtrojnë kontrolle të vazhdueshme për gjendjen teknike të automjeteve që janë zgjedhur për trasportin e nxënësve dhe në qoftë se konstatojnë të meta teknike të mos lejojnë që këto automjete të qarkullojnë për transportin e tyre.
Po kështu jo më pak i rëndësishëm është kontrolli nga ana e Drejtorisë së Shëndetit Publik ndaj higjenes në ambjentet shkollore me qëllim parandalimin e sëmundjeve infektive dhe kujdesit të nxënësve që janë me sëmundje kronike. Aktualisht Drejtorisë Rajonale e Shëndetësisë Gjirakastër ka bërë një punë shumë të mirë në lidhje me marrjen e masave për rikonstruksionin e ambjenteve të qendrave shëndetësore jo vetëm në qytete por edhe në njësitë administrative duke përdor fonde që kanë dhuruar disa biznese.

Nisur nga emergjencat që u shfaqën vitin e kaluar kemi rekomanduar që nxënesit përveç programit të detyrueshëm arsimor duhet të jenë të përgatitur të përballojnë situata emergjente në rast fatkeqësive natyraore (tërmeteve,uje dhe zjarreve) për dhënien ndihmës të menjëhershme për shpëtmin e jetës, evakuimin nga zonat të prekura dhe marrjen e masave për kthimin në normalitet në shkolla.
Institucioni i Prefektit të Qarkut, gjatë vitit të kaluar ka ushtruar kontrolle dhe ka analizuar me drejtori të veçanta, por dhe me disa drejtori së bashku ku ka udhëzuar dhe rekomanduar mbi marrje e masve dhe zbatimin e tyre me përgjegjësi ndaj mangësive të konstatuara.

Duke Ju falenderuar, ftoj Znj Rova, Drejtoreshën e Drejtorisë Arsimore Rajonale për të na dhënë një pasqyrë rreth masave të marra nga drejtoria DAR për vitin e ri arsimor.

15.09.2018

75-vjetori i Çlirimit të Tepelenës

Të dashur qytetarë të Tepelenës, të dashur veteranë të LANÇ dhe familje të dëshmorëve por edhe të dëshmorëve që nuk jetojnë më. Është kënaqësi e veçantë që të marr pjesë sot në ceremoninë e 75-vjetorit të Çlirimit të Tepelenës. Një ngjarje e shënuar, jo vetëm për popullin e Tepelenës por edhe për Luftën Antifashiste Nacional Çlirimtare të popullit tonë. 15 shtatori është një ngjarje e rëndësishme për arsye sepse i dha një shkëndijë të fortë shpresës dhe besimit se vendi mund të çlirohej.

Tepelena është e lidhur pazgjidhshmërisht me çlirimin e vendit dhe të gjithë ne jemi mirënjohës ndaj djemve dhe vajzave tuaj që u bënë bijtë e gjithë Kombit. Populli i Tepelenës është shquar në historinë shumëshekullore të popullit shqiptar me ideale të larta dhe dashurinë e madhe për atdheun që luftuan si rrallë të tjerë. Nga gjiri juaj kanë dalë trima dhe luftëtarë që u vetë sakrifikuan për këto ditë lirie që jetojmë ne sot.

Tepelena mori pjesë aktive në LANÇ gjatë Luftës së Dytë Botërore. I gjithë rrethi i Tepelenës, u kthye në një nga bazat më të fuqishme dhe një nga zonat e para të çliruara në shkallë vendi. Në Kurvelesh në vitin 1942, u vendos krijimi i këshillave nacional çlirimtarë në shkallë vendi, me nismën e veprimtarëve të parë antifashistë si Mustafa Matohiti, Shefqet Peçi, Ago Çela, Ali Lala, Memo Meto, Abaz Shehu.

U krijuan këshillat nacionalçlirimtarë thuajse në të gjitha fshatrat bashkë me grupet (njësitë) e armatosura të fshatrave. Bijtë dhe bijat e Tepelenës, krahas çetave e batalioneve të para partizane të krijuara në krahinë u rreshtuan masivisht dhe në Brigadat V, VI Sulmuese "Hero i Popullit", si dhe në Brigadat II, III, VII, VIII, XII, XIV, XVI, XIX, XI Sulmuese, në formacionet luftarake të Zonës së Parë Operative (Grupi i 1-rë, rezervë operative e shtabit në Kurvelesh), si dhe masivisht në formacionet vullnetare territoriale.

Nga të gjithë fshatrat e Tepelenës dolën mbi 2.000 luftëtarë të lirisë të rreshtuar nëpër formacione partizane, ndërsa në forcat territoriale u angazhuan mbi 6.000 veta.
Tepelena në fundin e vitit 1944 ishte krahina më e dëmtuar, më e djegur dhe më e shkatërruar ekonomikisht nga operacionet fashiste gjermane në raport me gjithë vendin. Por kjo nuk ndikoi absolutisht në përpjekjet e tyre për të vazhduar përpara. Çdo plagë e luftës, Tepelenën e bëri edhe më të fuqishme. Edhe pse lufta e dërrmoi, Tepelena diti të ngrihej në këmbë, sepse ka një popull të mrekullueshëm, të mençur dhe punëtor.

Shumë, mund të flitet për Tepelenën dhe përsëri nuk do të mundim të shprehim admirimin dhe respektin e padiskutueshëm që kemi të gjithë ne.
Gëzuar 75-vjetorin e Çlirimit dhe u kujtofshin në breza trimat e këtij vendi!

18.09.2018

74-vjetori i çlirimit të Gjirokastrës

Ne vimë në këtë përvjetor me një respekt dhe përulje përpara heroizmit, luftës, përpjekjeve, sakrificave të dëshmorëve që derdhën gjakun jo vetëm për çlirimin e qytetit tonë por për të gjithë luftëtarët e lirisë që kontribuan në LANÇ.

E kemi për detyrë që të përcjellim brez pas brezi vlerat e bijve dhe bijave që dhanë jetën e tyre, të nderohen dhe të respektohen në vite.

Lufta Nacional Çlirimtare është një epope e lavdishme e historisë tonë, ku të gjitha ato vajza e djem, burra dhe gra që u përfshinë në luftë dhe që iu kundërvunë me heroizëm fashistëve italianë dhe nazistëve gjermanë, do të mbeten përherë në mendjet e zemrat tona dhe do të gëzojnë respektin më të madh.

Gjaku dhe vepra e dëshmorëve të atdheut do të respektohet përherë në kujtesën e brezave që do të vijnë. Lavdi dëshmorëve të Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare!

27.09.2018

Dita Ndërkombëtare e Turizmit

Të nderuar,

Agroturizmi me programin e 13 fshatrave është një mundësi reale punësimi. Në qarkun Gjirokastër ka potenciale të mëdha zhvillimi në sektorin e agroturizmit. Nëpërmjet lehtësirave fiskale po nxitet zhvillimi i agroturizmit, si një rrugë e mirë zhvillimi dhe punësimi, me rroga shumë më të larta se në shtet.

Sot numri i hoteleve dhe bujtinave është mbi 15 vetëm në qytetin e Gjirokastrës, ndërsa para pak viteve ishte 2-3. Panorama ka ndryshuar. Qarku Gjirokastër është një zonë kufitare që ka jetuar me emigracion, do të vijojë të jetojë si një zonë kufitare, ne duhet t'i japim mundësi të ngrihet mbi potencialet e veta. Nëse kthen kokën pas, nga sot dhe dje ka ndryshim, por ka ende shumë për të bërë. Nëse kthehemi pas në vite, sot jemi në pozicion tjetër. Deri pak vite më parë numëroheshin shumë pak bujtina apo hotele, sot janë hapur shumë të tilla. Ka rritje të konsiderueshme të turistëve në të gjithë qarkun tonë. Edhe këto ditë pavarësisht se jemi futur në stinën e vjeshtës janë vërejtur një numër i madh turistësh sidomos në qytetin e Gjirokastrës. Po të shikojmë vlerën e shtëpive, ajo është rritur. Ky është një tregues me rritje për ekonominë e vendit.

Gjirokastra dhe zonat përreth pasurinë e vet e kanë te turizmi. Krijimi i kushteve për të patur më shumë turizëm është detyrë e qeverisë në bashkëpunim me pushtetin lokal. Tani ka turistë. Duam të investojmë te agroturizmi. Të gjitha zonat si ajo e Libohovës, e Gjirokastrës e Këlcyrës të gjitha zonat që kanë një atraksion turistik kanë një mundësi të mirë tashmë për të pasur zhvillim. Në zonën e Libohovës janë përzgjedhur në listën e 100 fshatrave turistikë, fshati i Nepravishtës dhe Labova, që mbartin në vetvete vlera të mëdha përsa i përket zhvillimit të agroturizmit.
Po të flasim për shtëpitë ekzistuese që kthehen në bujtina kryesisht, duhet t'ju japim një paketë mbështetje, ku TVSH do të jetë 6% ashtu si hotelet me katër apo pesë yje. Duhet vetëm pak imagjinatë, kurajo dhe vullnet për punë dhe atë që duket se janë të dënuar të jetojnë në varfëri të mund të bëjnë biznes e të fitojnë më shumë se sa një rrogë shteti. Pjesa tjetër janë të ardhura nga emigracioni.

Me këtë rast dua të shtoj se çdo turist kërkon të njihet me traditat e çdo zone, historinë, por njëkohësisht kërkon edhe shërbim korrekt dhe të kulturuar. Për këtë duhet të mendohet për krijimin e kushteve nga ana e njësive të vetëqeverisjes vendore, bashkisë për hapjen e kurseve të ndryshme në shërbim të agroturizmit.
Në programin ambicioz me fokus 100 fshatrat, fokusi do të përqëndrohet jo vetëm për të krijuar realitete të reja me infrastrukturë në raport me mijëra realitete të tjera që presin të kenë infrastrukturë, por për të krijuar edhe zona zhvillimi ekonomik-ruaral, të bazuar tek investimet në agroturizëm dhe ekoturizëm, duke shfrytëzuar trashëgiminë kulturore, mrekullitë natyrore, traditën në tërësi, kapacitetet lokale por edhe investimet e sipërmarrësve më të mëdhenj.

Kombinimi i të gjitha këtyre faktorëve do të sjellin kushte të reja, për ta parë të ardhmen në fshat si një të ardhme të lidhur jo thjesht me prodhimin bujqësor në funksion të tregut në ofrimin e produkteve bujqësore por edhe si zhvillim turistik me bazë bujqësore dhe bazë blegtorale. Për këtë, natyrisht, ne duhet të mbështesim me infrastrukturë, duhet të mbështesim

me ndërhyrje për trashëgiminë kulturore rreth e rrotull, duhet të mbështesim me fonde shtesë për të bërë investimin, por gjithmonë kjo në bashkëpunim vetëm me ata që duan të punojnë, të zhvillohen dhe që e shikojnë të ardhmen në fshat si një zgjedhje dhe jo si detyrim.

04.10.2018

25-vjetori i Departamentit të Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek

Të nderuar miq,

Sot është një ditë e shënuar jo vetëm për universitetin e nderuar të Gjirokastrës por edhe gjithë rajonin dhe marrëdhëniet midis dy vendeve tona.

Departamenti i Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek, institucioni më i lartë dhe më i rëndësishëm për arsimin, kulturën dhe civilizimin e Minoritetit Etnik Grek, feston 25-vjetorin e krijimit të tij. Historia e tij çerek shekullore vërtetoi më së miri rëndësinë e tij për të mbështetur në mënyrë të gjithanshme këto komponente dhe sidomos arsimin.

Të diplomuarit e këtij departamenti përbëjnë sot themelin e kuadrove të arsimit në gjuhën amtare greke por ata janë dhe të kudo ndodhur dhe në ato poste që kërkohen njerëz dhe kuadro me njohje shumë të mirë të gjuhës greke por edhe asaj shqipe. Pra, ky departament me të gjitha mënyrat e mundshme dhe me nivel të lartë cilësor plotësoi ato boshllëqe që lidhen me respektimin e të drejtave të minoritetit në fushën e arsimit dhe kulturës dhe njëkohësisht shërbeu si një ambasador intelektual në lidhjen, komunikimin dhe bashkëpunimin midis universitetit të Gjirokastrës dhe universiteteve greke por edhe midis dy vendeve.

Shteti shqiptar do të mburrej në çdo rast tjetër, edhe në rast të funksionimit formal të një departamenti të tillë por, puna dhe arritjet e stafit të tij akademik, objektivat dhe ambicjet e tij, na bëjnë sot të jemi më koshientë se marrëdhëniet midis dy vendeve nuk kanë nëvojë për propaganda dhe formalitet por për realitete që ky department krijoi për 25 vjet. Po ashtu, egzistenca e këtij departamenti në strukturat akademike të Universitetit "Eqrem Çabej" të Gjirokastrës përbën me siguri një vlerë që e nderon, një vlerë që i jep këtij Universiteti një dimesion ndryshe, një dimesion evropian dhe të kohës.

Personalisht ndjehem shumë mirë që jam sot në këtë festë. Ndjehem mirë se më jepet mundësia që nga mjedisi i mrekullueshëm i këtij eventi të tregoj respektin tim personal dhe të shtetit për pakicën greke. Respektimi dhe nderimi i saj si një komunitet që di të bashkëjetoj pa mohuar vetveten, di të respektoj shtetin duke këmbëngulur për të drejtat e tij, di të marrë pjesë në punët e shtetit të përbashkët duke manifestuar dhe edukuar te shumica jonë vlera Evropiane.

Më lejoni edhe një herë t'i uroj Departamentit të Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek, stafit të tij akademik dhe studentëve të tij si edhe Universitetit të Gjirokastrës jetë të gjatë dhe gjithmonë suksese dhe përvjetore të tilla.

15.10.2018

110 vjetori i çeljes së shkollës së parë në gjuhën shqipe në fshatin Koshtan

I nderuar Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve, Hirësia e tij Haxhi Dedë Edmond Brahimaj,
Të nderuar Kryetarë!
Të nderuar pjesëmarrës!
Sot në ditën e Pelegrinazhit tradicional, me shumë mirënjohje përkujtohet 110 vjetori i çeljes së shkollës së parë në gjuhën shqipe në fshatin Koshtan të bashkisë Memaliaj.

Më 15 tetor 1908 në Teqenë e Koshtanit hapet shkolla e parë shqipe, e cila ishte e para shkollë legale pas fitores se revolucionit xhonturk në vilajetin e Janinës. Në mbështetje të hapjes së kësaj shkolle shqipe ishin gjithë istitucionet fetare të kohës si dhe patriotët Tepelenas si: Sulejman Luzati, Femi Mezhgorani, Sheh Ali Bënça, Baba Ahmet Turani, Baba Sali Matohasanaj, Baba Medin Gllava, Sadullah Tepelena e shumë të tjerë. Në këtë ngjarje të veçantë për arsimin shqiptar shprehim mirënjohjen për kryemësuesin Baba Ahmetin, për mësuesin Ibrahim Selimin nga Krahësi, Qamil Rustemi nga Kamcishti dhe Mulla Hasimin nga Gjirokastra.

Shkolla e Koshtanit, kjo dallëndyshe e parë e mësimit të gjuhës shqipe, lindi mbijetoi dhe u rrit cilësisht jo vetëm falë rolit të madh të Baba Ahmetit, mësuesve të apasionuar e të palodhur dhe klerikëve të nderuar tepelenas, por falë dhe kontributit të Petro Nini Luarasi, Babë Dude Karbunarës e të shumë figurave patriotike të kohës. Qarku i Gjirokastrës dhe veçanërisht Tepelena e Memaliaj krenohen për këtë shkollë, për vendimet e rëndësishme që mori Kongresi i Koshtanit. Ky kongres zhvilloi punimet e tij në gusht 1909 dhe mund të cilësohet si ngjarja më e madhe në trevat e jugut pas Kongresit të Manastirit. Pjesëmarrja në këtë aktivitet e shumë personaliteteve nga Tepelena, Memaliaj, Gjirokastra, Berati, Fieri si dhe Vilajeti i Janinës me në krye baba Hamet Koshtanin si figurë qëndrore dhe organizator i kësaj veprimtarie marrin përmasa me vlera të rralla historike. Jetëshkrimi i shkollës së Koshtanit, vlerësimi dhe evidentimi i vlerave të saj, duhet të shikohet me përgjegjësi profesionale e historike nga institucionet arsimore, pushteti vendor dhe nga institucione të tjera se kjo histori i bën nder gjithë krahinës dhe vendit tonë. Kjo shkollë kishte konvikt ku strehoeshin dhe mësonin mbi 60 nxënës nga fshatrat e zonës së Krahësit dhe zonës së Buzit, shpenzimet përballoheshin nga Teqeja dhe librat në gjuhën shqipe siguroheshin nga komunitetet shqiptar jashtë vendit.

Në emër të institucionit të Prefektit të qarkut Gjirokastër dhe në emrin tim personal vlerësoj dhe përgëzoj organizatorët e këtij aktiviteti, Hirësinë e Tij Haxhi Dedë Edmond Brahimaj dhe stafin e tij për përkushtimin e treguar në kujtim të ngjarjeve historike në qarkun e Gjirokastrës. Përshëndes organet e njësive të vetëqeverisjes vendore të Memaliajt dhe Tepelenës z. Durim Roshi dhe Tërmet Peçin, intelektualët dhe profesorët me në krye rektorin e universitetit z. Bektash Mema. Mirënjohje për të gjithë banorët e krahinës së Krahësit e Buzit që vlerësuan e mbështetën shkollën e tyre të parë shqipe në vitet më të vështira të pushtimit të Shqipërisë nga hordhitë e huaja dhe ruajtën traditën, vlerat dhe kulturën.

Lavdi dhe mirënjohje shkollës së parë shqipe në Teqenë e Koshtanit, mësuesve me në krye baba Ahmetin dhe gjithë banorët e Koshtanit, Krahësit dhe Tepelenës.

Tetor 2018

Çelja e vitit të ri akademik 2018-2019

I nderuar z. Rektor!
Të nderuar pedagogë!
Të dashur studentë!

Ju uroj mirëseardhjen në dyert e këtij Universiteti me histori dhe vlera jo vetëm për qytetin tonë por për mbarë vendin. Nga këto dyer kanë dalë dhe janë diplomuar një numër i madh studentësh.

Shumë prej tyre kanë shkëlqyer dhe janë sot personalitete me tituj dhe grada shkencore. Vitet studentore janë të arta. Keni mundësinë të mësoni të formoheni dhe ti jepni drejtim jetës dhe të argëtoheni dhe të shijoni ritmin e kësaj moshe. Duhet të keni pikësynime të qarta dhe të punoni fort për ti arritur ato.

Mësoni, mësoni më shumë dhe të jeni të sigurtë se me punë arrihet çdo gjë. Jeta është e juaja dhe duhet ti jepni vlerën e merituar. Edhe një herë suksese dhe vit të mbarë!

18.10.2018

Takimi mbi sistemin e ri të Ndihmës Ekonomike

Më lejoni së pari t'ju falenderoj për organizimin e këtij takimi i cili, përveçse është i nevojshëm në qasjen e qytetarëve që janë të interesuar për të aplikuar për ndihmë ekonomike, do t'ju vijë në ndihmë edhe individëve në nevojë të cilët duke u orientuar drejt skemave të Punësimit dhe Riintegrimit Social që Qeveria ka ndërmarrë, do të kenë më shumë hapësira punësimi me qëllim riintegrimin social dhe ekonomik.

Skema e Ndihmës Ekonomike është shtylla kryesore e programit të mbrojtjes sociale i cili synon zbutjen dhe lehtësimin e varfërisë. Ashtu siç jemi në dijeni, kjo është një nga prioritetet e Qeverisë Shqiptare dhe si rrjedhojë është parë si e rëndësishme që kjo skemë të reformohej duke sjellë transparencë dhe efikasitet, lehtësim dokumentacioni dhe procedurash për qytetarët që aplikojnë për ndihmë ekonomike.

Si çdo sistem i ri, edhe sistemi i mbështetjes sociale i ndihmës ekonomike pati marzhin e tij të gabimit që duhet theksuar se ishte minimalist, duke parë se shmangia e abuzivitetit njerëzor, favorizoi familjet që me të vërtetë kishin nevojë. Është e rëndësishme të kuptohet rëndësia e reformimit të kësaj skeme dhe duke parë ecurinë e saj, jo vetëm në qarkun që unë përfaqësoj por dhe në qarqet e tjera, vihet re ndryshimi në mënyrën e konceptimit dhe qasjes së saj nga individët që bëjnë pjesë në të por jo vetëm. Ndryshimi vihet re gjithashtu në rritjen e numrit të përfituesve të cilët duke kuptuar thelbin e kësaj reforme, kanë kuptuar mënyrën e aplikimit dhe si rrjedhojë kanë pranuar rezultatin përfundimtar.

Duke parë këto arritje nuk mund të lë pa falenderuar të gjithë punonjësit e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Gjirokastër, Zyrës së Punës dhe Formimit Profesional të cilët si rezultat i një bashkëpunimi serioz dhe me ndjeshmërinë maksimale institucionale por edhe njerëzore që përcollën gjatë kësaj periudhe, do të thoja jo shumë të lehtë, bënë të mundur që me durim dhe me sugjerime të matura, të kemi këto rezultate që jam i bindur se në të ardhmen do të jenë akoma dhe më të mira.

Në këtë pikë natyrisht lind pyetja, a është bërë çdo gjë në rregull? Natyrisht që në çdo gjë që ndryshon ka vend për përmirësim. Jam i bindur që përmirësime duhen dhe do të bëhen në përcaktimin e kritereve, ku prioritet do të kenë sidomos familjet me një kryefamiljar, fëmijët jetim apo individë të moshës së tretë të cilët janë të vetmuar.

Në fund do doja të theksoja dhe përgjegjësinë e njësive të qeverisjes vendore në forcimin dhe përmirësimin e këtij sistemi, përgjegjësi e cila duhet parë me seriozitet. Përcaktimi i fondit shtesë nga buxheti i tyre i cili i bashkangjitet fondit 6% si dhe mbledhja brenda afateve kohore të përcaktuar me ligj të këshillave bashkiak, është detyrim jo vetëm ligjor por dhe moral. Prandaj i ftoj të gjithë të kontribuojnë me seriozitet dhe përgjegjshmëri në ecurinë e kësaj reforme por edhe të reformave të tjera të rëndësishme që qeveria Rama po ndërmerr.

01.11.2018

Takimi mbi Analizën e Sezonit Turistik 2018 në qarkun e Gjirokastrës dhe masat e marra për periudhën në vazhdim.

Të nderuar pjesëmarrës,

Bazuar në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e qarkut " dhe të ligjit nr. 93/2015 "*Për Turizmin*", po organizojmë këtë takim mbi sezonin turistik 2018 në qarkun e Gjirokastrës ku do të trajtohen:

1. Masat e marra për sezonin turistik për vitin 2018.
2. Problematikat e hasura nga ana juaj për gjatë këtij viti.
3. Masat që duhet të merren për sezonin turistik për vitin 2019.

Institucioni i Prefekti ka ndjekur, monitoruar dhe koordinuar punën gjatë kësaj periudhe të sezonit turistik veror, kjo në bashkëpunim të ngushtë edhe me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Komitetin Rajonal të Zhvillimit të Turizmit, Bashkitë Gjirokastër, Libohovë, Dropull, Tepelenë, Memaliaj, Përmet dhe Këlcyrë, Degët Territoriale dhe me të gjithë aktorët përgjegjës publik dhe privat për menaxhimin e sezonit turistik veror.

Zhvillimi i turizmit në qarkun tonë është pjesë përbërëse e prioriteteve parësore dhe Programit të Qeverisë Shqiptare. Me të janë të lidhura ngushtë infrastruktura, urbanizimi, rijetëzimi, industria, bujqësia etj. Të gjithë së bashku jemi përpjekur të ndjekim hap pas hapi çdo problematikë të hasur në drejtim të shërbimeve në sektorin e turizmit për ofrimin e garancive dhe kushteve sa më të mira të pushuesve, në këtë sezon turistik. Në të gjitha takimet e zhvilluara në fazën parapregatitore kemi synuar të diskutojmë dhe japim zgjidhje konkrete problemeve të konstatuara si dhe marrjen e masave të nevojshme në mënyrë që të ndikonin pozitivisht në sezonin turistik veror. Me të gjithë këto struktura kemi qënë në kontakte të vazhdueshme për çdo problematikë dhe situatë që mund të krijohej në mënyrë që t'u jepnim zgjidhjen në kohë. Një element mjaft i rëndësishëm për sezonin turistik ka qënë edhe ngritja e Task Forcës Vendore nga Institucioni i Prefektit "Për monitorimin dhe kontrollin e masave për zbatimin e detyrimeve ligjore për sigurinë gjatë sezonit turistik veror 2018", kjo në zbatim të Urdhërit të Kryeministrit nr. 39 datë 28.02.2018 "Për miratimin e planit të masave përgatitore për sezonin turistik veror 2018 dhe ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës".

Siç jeni në dijeni edhe nga takimet e mëparshme, organizuar për këtë qëllim pranë institucionit të Prefektit, në zbatim të detyrave të Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit

dhe nga informacionet e dërguara nga ana juaj, rezulton se nga të gjithë është punuar me përkushtim për marrjen e masave dhe zbatimin e detyrave përkatëse për mikpritjen e turistëve vendas dhe të huaj që vizitojnë rajonin tonë, kjo falë edhe një bashkëpunimi të suksesshëm midis strukturave pjesëmarrëse për zhvillimin e turizmit.

Këtë vit turizmi ka shënuar rritje. Viti 2018 për periudhën janar – shtator shënoi rreth 150.737 vizitorë vendas dhe të huaj në qarkun tonë, shifra këto që kontribuan ndjeshëm në rritjen vjetore ekonomike të qarkut. Turizmi kështu rikonfirmohet si nxitësi kryesor i rritjes së ekonomisë së qarkut. Turizmi është tashmë një sektor me ndikim të madh social dhe ekonomik duke ndryshuar pozitivisht strukturën ekonomike, duke krijuar vende të reja pune me një treg pune tërheqës, të qëndrueshëm dhe konkurues dhe të ardhura të konsiderueshme, si dhe duke kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik të qarkut.

Në muajin Prill në kuadër të javës së Tokës, me inciativën e Kryeministrit dhe Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit u ndërmor Aksioni Kombëtar me nismën "Të pastrojmë Tokën që duam", aksion i cili vazhdoi deri më datë 22 prill në të gjithë territorin e qarkut Gjirokastër. Aksioni përfshiu të gjithë segmentet kryesore të rrugëve dhe urave në qarkun Gjirokastër.
Në maj të po këtij viti është zhvilluar mbledhja e parë e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit dhe në qershor të këtij viti është zhvilluar mbledhja e dytë e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit, pjesëmarrës në këto takime ishte edhe zv. Ministri i Turizmit dhe Mjedisit z. Hajrulla Çeku ku u trajtuan dhe u diskutuan:

- Masat e marra nga ana e njësive të vetëqeverisjes vendore dhe institucioneve shtetërore rajonale mbi ecurinë e deritanishme të sezonit turistik veror 2018.
- Informimi në mënyrë të detajuar i Prefektit të Qarkut mbi lëvizjen e turistëve vendas dhe të huaj për periudhën 1 janar - 25 qershor 2018.

Prefekti i qarkut Gjirokastër gjatë gjithë kësaj periudhe ka zhvilluar takime të ndryshme sipas specifikave me të gjithë degët territoriale në nivel qarku, në mënyrë të veçantë me ato struktura që ofrojnë shërbime në drejtim të turizmit si:

- Drejtorinë Vendore të Policisë të qarkut dhe Drejtorinë e Kufirit dhe Migracionit, në drejtim të rendit dhe sigurisë publike.
- Administratën e Zonave të Mbrojtura për orientimin e turistëve drejt zonave turistike natyrore dhe shtimin e numrit të turistëve vendas dhe të huaj që të vizitojnë Zonat e Mbrojtura që ka qarku i Gjirokastrës.
- Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare në drejtim të masave të marra në kalanë e qytetit Gjirokastër dhe në të gjitha sitet arkeologjike që mbulojnë.
- Janë zhvilluar takime me OSHEE-në dhe drejtorinë e Ujësjellës Kanalizimeve sh.a, në drejtim të ofrimit të shërbimeve të funizimit normal me energji elektrike dhe ujë të pijshëm, në mënyrë të veçantë në zonat turistike.
- Takime janë zhvilluar me drejtoritë Rajonale të Shëndetit Publik, Spitalin "Omer Nishani" dhe Drejtorisë Rajonale të Sigurimit dhe Kujdesit Shëndetësor, për marrjen e të gjitha masave në drejtim të ofrimit shëndetësor sa më profesional. Në mënyrë të veçantë janë inspektuar qendrat shëndetësore dhe janë parë me prioritet qendrat shëndetësore në zonat e thella për të ofruar të gjithë shërbimin e nevojshëm shëndetësor ndaj vizitorëve.
- Takime janë zhvilluar edhe me drejtorinë e Autoritetit Rrugor Jugor si dhe me përfaqësuesit e firmave kontraktore që mbulojnë qarkun Gjirokastër në drejtim të sigurisë rrugore dhe plotësimin me sinjalistikën e nevojshme të tyre.

Gjatë sezonit turistik 2018 ka patur një rritje të interesit nga vizitorët vendas dhe të huaj për të vizituar qarkun e Gjirokastrës dhe veçanërisht qytetin e Gjirokastrës. Shtimit të kapaciteteve akomoduese i është përgjigjur rritja e numrit të turistëve gjatë sezonit turistik. Nga ana tjetër ndërgjegjësimi i vetë bizneseve dhe bashkëpunimi i strukturave shtetërore ka lehtësuar qëndrimin e vizitorëve vendas dhe të huaj. Përmirësimi i shërbimit në funksion të turizmit është shoqëruar edhe me zgjatjen e kohës së qëndrimit të vizitorëve. Në bashkinë Gjirokastër sipas të dhënave të mbledhura nga InfoPoint-et dhe hotelet, më shumë se gjysma e vizitorëve që kanë vizituar qytetin kanë kaluar të paktën një natë në Gjirokastër.

Vendimi i qeverisë për të ulur TVSH-në nga 20% në 6% ka patur për qëllim të lehtësojë sektorin e turizmit, për nxitjen e investimeve, uljen e çmimeve dhe rritjen e konkurrencës. Ulja e TVSH-së për turizmin në 6% ka qenë një kërkesë e vazhdueshme e operatorëve turistik e cila pas implementimit ka rezultuar efektive për rritjen dhe zhvillimin e bizneseve të hotelerive.
Nga 1 korriku filloi zbatimi i projektit "Smile Albania" projekti më i ri për të punësuar të rinjtë të cilët bënë një prezantim të resurseve që ka qarku ynë. Në zbatim të kësaj nisme 57 të rinjtë e qarkut tonë u punësuan për 2 muaj në info point-et e përcaktuara në pikën kufitare Kakavi, Sheshin e Çerçizit bashkia Gjirokastër, Qendrat Multifunksionale bashkia Përmet dhe Ujërat Termale Bënjë.

Nga informacionet e marra nga turistët, janë dhënë konsiderata pozitive si mikpritja dhe sinqeriteti i komunitetit vendas në zona të ndryshme të Shqipërisë; vlerësim për peisazhet fantastike dhe mjediset e shumëllojshme, për bukuritë e bregdetit shqiptar, për gatimet tradicionale dhe për monumentet e kulturës.

Ndërkaq paralel me konsideratat dhe vlerësimet e mirëpritura, nuk mund të tregohemi jorealistë e të mos vëmë në dukje anët më problematike të zhvillimit të turizmit në vendin tonë, të trashëguara nga e kaluara e të cilat padyshim vazhdojnë të ndikojnë negativisht për rezultatet që duam të arrijmë në fushën e turizmit e më gjerë. Ngelen ende problematike ndotja e mjedisit, mungesa e infrastrukturës në zonat rurale, vështirësitë në orientim për të gjetur pikat e interesit si dhe mungesa e aktiviteteve kulturore dhe artistike të domosdoshme për pasurimin e jetës qytetare e rurale.

Atraksionet turistike më të frekuentuara të qarkut Gjirokastër për vitin 2018 ngelen objektet e trashëgimisë historike e kulturore, objektet turistike Natyrore, turizmi shëndetësor (vizita në burime termale, Bënjë Përmet), turizmi familjar (bujtina të ndryshme në zonat malore të qarkut) dhe turizmi sportiv rafting (kanionet e Vjosës Përmet, kanionet e Kurveleshit Tepelenë).
Zonat më të frekuentuara nga turistët e huaj dhe vendas për këtë vit ishin Kalaja e Gjirokastrës, Muzeu Etnografik, Pazari i Vjetër, Shtëpitë Muze, Bredhi i Sotirës në Njësinë Administrative Dropull i Sipërm, Tuneli i Luftës së Ftohtë, Parqet Arkiologjike Antigonea dhe Adrianopuli etj.

Gjatë vitit 2018, duke u bazuar në statistikat e marra nga strukturat të cilat ofrojnë shërbime turistike, rezultoi se numri i turistëve që vizituan qarkun e Gjirokastrës për periudhën 1 janar – 30 shtator kap shifrën 150.000 vizitorë rreth 50% më shumë krahasuar me vitin 2017 vendas dhe të huaj, konkretisht:

Bashkia Gjirokastër	105 .000 vizitorë
Bashkia Përmet	26.000 vizitorë

Bashkia Tepelenë	8.000 vizitorë
Bashkia Libohovë	9.220 vizitorë
Bashkia Këlcyrë	1517 vizitorë
Bashkia Memaliaj	1000 vizitorë

Një falenderim të veçantë do të bëj për të gjithë administratorët e njësive akomoduese të hotelerive, restoranteve, bujtinave si dhe të gjithë aktorët kryesor në zhvillimin e turizmit, për kontributin e pa zëvendësueshëm që kanë dhënë në shërbim dhe promovim të vlerave të pa zëvendësueshme që ka qarku ynë.
Nje rol të veçantë në drejtim të zhvillimit të turizmit në rajonin tonë kanë luajtur dhe po bëhen pjesë aktive e punës edhe mediat lokale të shkruara dhe elektronike, shtetërore dhe private. Nëpërmjet punës së tyre sistematike kanë dalë në pah problematikat e ndryshme duke ndërgjegjësuar vazhdimisht opinionin në favor të zgjidhjes së tyre.

Evidentimi i të gjithë problematikave pa harruar asnjë, tregon që kemi shumë hapësira për menaxhim, organizim dhe për ti dhënë njerëzve bindjen që turizmi është një mundësi reale drejt një jete më të mirë. Në qarkun e Gjirokastrës ekzistojnë të gjithë komponentët e asaj çfarë ne duam të bëjmë për turizmin në Shqipëri, duke filluar që nga kapacitetet akomoduese, mundësitë fantastike që ka turizmi kulturor në këtë qark, kompozojnë së bashku një peisazh ideal perfekt në të gjitha dimensionet dhe e bëjnë turizmin shumë më tepër të popullarizuar. Qarku i Gjirokastrës është shembulli i hapur se si turizmi nuk mund të jetë vetëm në një sezon, agroturizmi dhe turizmi kulturor vazhdon përgjatë gjithë vitit.

Gjirokastra ka një trashëgimi të pasur kulturore dhe historike si rezultat vizitohet gjatë gjithë vitit nga turistë të huaj dhe vendas. Ministri nënvizoi se takimet pranë Prefektit duhet të jenë permanente ku të diskutohen të gjitha problematikat e hapjes dhe shtrirjes së aktivitetit turistik. Duke filluar që tani duhet të fillojmë të mendojmë dhe për vitin e ardhshëm se çfarë do të realizojmë.

Do të doja të ftoja të gjithë të rinjtë që diplomohen në sektorin e turizmit dhe biznesit apo çdo të ri tjetër që t'ju zgjohet dëshira për tu futur në rrugën e biznesit duke hapur dhoma për hoteleri, restorante, pika përpunuese ushqimore dhe deri tek qendrat e agroturizmit. Ju biznesmenët më të vjetër ju futët kësaj pune përpara 20-30 vjetësh duke riskuar por sot situata është më lehtë për biznesit në përgjithësi. Kanë dal shumë ligje që favorizojnë ushtrimin e këtyre aktiviteteve.

Interesi i turistëve të huaj në vendin tonë dhe në veçanti për qarkun e Gjirokastrës, është në rritje. Janë ngritur zyrat turistike dhe Shqipëria tashmë është bërë një destinacion i pëlqyer për turistët. Së fundmi është në interes të tyre që të formalizoheshin edhe ata që kanë hapur shtëpitë e tyre për pritjen e turistave me qëllim jo vetëm që të njihen nga ligji komform rregullave por mbi të gjitha për të patur mundësinë e marrjes së kredive ndihmëse nga shteti për zhvillimin e tyre si biznes.

21.11.2018

Shfaqja e poemës dramatike "Gjergj Kastriot Skënderbeu"

Të nderuar qytetarë artdashës të Prefekturës së Qarkut Gjirokastër!

Dita e sotme na ka bashkuar në këtë "amfiteatër", në shfaqjen e një poeme dramatike me titull "Gjergj Kastriot Skënderbeu" shkruar, regjisuar dhe aktruar nga aktori me famë Xhevat Limani. Kjo është një sipërmarrje e bukur e Institucionit të Prefektit të Qarkut të Gjirokastrës. Është një krenari legjitime që, në vitin e Skënderbeut, në këtë muaj festiv të Kombit Shqiptar, të kemi në gjirin tonë, në qytetin tonë, trupën e Teatrit Shqiptaro-Amerikan. Aktori Xhevat Limani na sjell "profilin" e Skënderbeut, Kryeheroit tonë Kombëtar, në mënyrë të spikatur dhe Era Hoxha, e bija sopranoja e talentuar, figurën e Donikës, Kryezonjës Shqiptare.

Mirëseerdhët në Gjirokastrën tonë dhe tuajën, pas një rrugëtimi të gjatë triumfues të "Skënderbeut" në rreth mbi 50 shtete të botës, duke treguar gjenialitetin, superioritetin, taktikën, strategjinë, dinamizmin, përballjen, madhështinë dhe dimensionet e tij shumëplanëshe.

Në fjalor enciklopedik shqiptar të botuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë 2008 shprehimisht thuhet se "Interpretimi i tij (Xhevat Limanit) dallohet për temperamentin, për kulturën në trajtimin e figurave dhe veprave skenike, çka është vënë re në rolet kryesore që ka luajtur. Si regjisor ka vënë vepra të spikatura teatrore, ka realizuar filma dokumentarë, telepoema etj. Mesazhet e tij bien në sy për qartësi dhe përkushtim kombëtar në rrahjen dhe përzgjedhjen e temave të mprehta". I referohemi dy personaliteteve, të cilët vlerësojnë këtë aktor të madh:

Vanesa Redgrave, artiste angleze: "Xhevat Limani është një Lorenc Oliver shqiptar. Ai është një actor magjepës për të gjithë shqiptarët, qoftë në SHBA, në Shqipëri dhe gjetiu".

Mathie Aref: "Xhevat Limani solli në Tetrin Montorgueil, në Paris, Gjergj Kastriotin Skënderbeun, duke shënuar një ngjarje kulturore dhe na bëri të ndjehemi krenar me artin e tij emblem. Sopranoja Era Hoxha, e bija, në rolin e Donikës, shkëlqeu me timbrin e saj epiko melankolik".

I lindur në Strugë, studioi aktrim, gjuhë dhe letërsi shqipe. U diplomua në klasën e Faruk Begollit në 1974 (Student i parë shqiptar i aktrimit në Maqedoni). Gjatë vitit shkollor 1974-1975 punoi si profesor i gjuhës dhe letërsisë, në gjimnazin e Strugës. Nga 1975-2002 punoi si aktor profesionist në teatrin shqiptar në Shkup (Teatri i pakicave-Teatri i kombësive-teatri shqiptar). Nga viti 2002 jeton dhe vepron në SHBA, ku themeloi 'Teatrin Shqiptar në Amerikë" (Albanian Theater in America). Ka luajtur mbi 100 projekte aktrore dhe mbi 7000 shfaqje, në mbi 50 shtete të botës. Ka shumë role që kanë lënë gjurmë në historikun e Teatrit Shqiptar, madje dhe shumë regjisura që shenjuan epokën e teatrit. Ka meritë të veçantë se ka realizuar filmin e parë shqiptar në Maqedoni "Fatprerët", sipas motiveve të romanit omonim të Murat Isakut. Ka luajtur në disa filma në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni si: "Rruga pa kthim", "Ne ata", "Kolonel Bunker", "Rrugët që vrasin" e tjerë, po edhe disa fima në SHBA.

Ai është themelues Institucionesh artistike si Teatri "Sofra-Strugë 1992," Teatri i dramës-Tetovë 1994, Teatri Shqiptar në Amerikë-2002, Themelues i Fakultetit të Aktrimit në Universitetin e Tetovës-1994. Madje është ideator dhe bashkëthemelues i Festivalit Mbarëkombëtar të Teatrove në Tiranë, 1992; ideator dhe bashkëthemelues i Festivalit "Skampa" Elbasan; ideues i disa mitingjeve të Prosperitetit, 1991-1992. Gjatë gjithë karrierës së tij si regjisor dhe aktor, Xhevat Limani, veprimtaria e tij, është vlerësuar me tituj e çmime nga Lidhje, Shoqata, Klube shkrimtarësh, poetësh dhe artistësh në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Itali (tearbëreshët), në vende të Evropës dhe në SHBA.

Poema dramatike "Gjergj Kastriot Skënderbeu", çuditërisht nuk ka vetëm një kulm, sikundërse kanë gjinitë letrare por disa kulme. Është një "pjekurinë" dramatike, përkushtuar

një Kryeheroi real, i cili me bëmat e tij është kthyer në një legjendë, mit, kryerrëfim e kryemodel për mbrojtjen e patjetërsueshme të Trojeve.

23.11.2018

Takimi me nxënësit me rastin e festave kombëtare të Pavarësisë

Të dashur nxënës,

Dëshiroj t'ju falenderoj për sukseset në proçesin mësimor. Ju përfaqësoni një pasuri shumë të madhe për të gjithë ne, në ndërtimin e mesëm të Shqipërisë.

Për këtë arsye, Institucioni i Prefektit të Qarkut ka menduar t'ju japi një dhuratë të veçantë. Në këtë pako, ju do të gjeni flamurin kombëtar, flamurin e Bashkimit Europian dhe një disk për të dëgjuar jo vetëm himnin kombëtar por edhe atë të Bashkimit Evropian.

Himni dhe Flamuri Kombëtar janë simbole që bashkojnë të gjithë shqiptarët si brenda ashtu edhe jashtë territorit, krenarë që janë pjesë e një prej kombeve më të vjetra në botë, që edhe pse gjatë shekujve ju është dashur të luftojë me fqinjët, i ka rezistuar dhe kanë ditur të mbroj me dinjitet identitetin kombëtar, atë ç'ka shumë popuj dhe kombe edhe pse më të mëdhenj në popullsi dhe sipërfaqe, janë asimiluar.

Shpresoj se kjo dhuratë, në kujtim të një rasti kaq të rëndësishëm, përvjetorit të shpalljes së Pavarësisë më 28 nëntor dhe ngritjes së Flamurit në Vlorë, t'ju shoqërojnë gjatë gjithë jetës.

28.11.2018

28 Nëntori – Dita e flamurit Kombëtar

Dita e Flamurit Kombëtar është dhe do të mbetet përgjithmonë një ngjarje e shndritshme e idealeve të shqiptarizmit.

28 Nëntori, është një datë e shënuar në memorien e kombit tonë, një simbol i çmuar për të gjithë ne shqiptarët ku më 28 nëntor 1912, Ismail Qemali ngriti Flamurin Kombëtar në qytetin e Vlorës dhe shpalli Pavarësinë e Shqipërisë.

Në këtë ditë të shënuar, përkulemi për të gjithë ata të cilët luftuan dhe flijuan veten e tyre për lirinë dhe pavarësinë e atdheut. Ata ranë në fushën e betejës për këtë flamur, duke u bërë simbole të krenarisë shqiptare, shembuj frymëzimi për gjeneratat e reja. Sot një pjesë e mirë e shqiptarëve jetojnë jashtë kufijve të Shqipërisë por me besimin dhe vullnetin e mirë se në një të ardhme do të jenë të gjithë së bashku. Kjo ditë e shënuar për të gjithë ne, do të mbetet simbol i bashkimit, unitetit, lidhjes, krenarisë, qëndresës së popullit shqiptar.

Gëzuar 106-vjetorin e Pavarësisë dhe Ditën e Flamurit Kombëtar!

29.11.2018

Takimi i 29 nëntorit – Çlirimit të Shqipërisë

Të nderuar veteranë!
Të nderuar pjesëmarrës të familjeve të dëshmorëve!

Festimi i 74-vjetorit të Çlirimit të atdheut është një ngjarje historike që lidhet ngushtësisht me sakrificat e mëdha të popullit shqiptar në këmbim të lirisë, ku mund të themi me plot gojë se lirinë shqiptarëve nuk ua fali askush por e fituan me shumë mundim dhe me shumë gjak.

Sot kam nderin dhe privilegjin të jem pjesë e kësaj ceremonie duke falenderuar thellësisht nga zemra të gjithë ata patriotë që dhanë jetën e tyre, që në brezat e sotëm dhe në vazhdim të jetojmë ditë të begatë dhe të paqta. E gjithë përpjekja për liri e popullit tonë finalizohet me Luftën Nacional Çlirimtare. Kjo luftë i dha fund robërisë, i dha fund pasigurisë, i dha fund çdo padrejtësie që i kanë bërë këtij populli shekullor.

Ne jemi krenarë për të gjithë ata djem trima dhe ato vajza trimëresha që në lule të rinisë dhanë jetën për ne dhe nuk menduan për asnjë moment për veten dhe familjet e tyre. Luftuan me vetëmohim dhe sakrificë duke i dëshmuar jo vetëm atdheut por botës mbarë se shqiptarët luftojnë si luanë dhe fluturojnë si shqiponja. Askush por askush nuk ua ndal dot fluturimin.

Rreshtimi i vendit tonë në koalicionin antifashist bëri që vendi ynë të renditej në rangun e fituesve, duke bërë të mundur që ne të gëzojmë këta kufijë territorial që kemi sot.Vepra e të rënëve në këtë luftë shërbeu si simbol i bashkimit për idealet e lirisë, pavarësisë, demokracisë dhe frymëzim për brezat e ardhshëm.

Në këtë datë të shënuar më lejoni edhe njëherë të shpreh mirënjohjen, respektin, përuljen ndaj luftëtarëve, formacioneve partizane që dhanë jetën në shërbim të Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare.

Lavdi veprës së ndritur të dëshmorëve të Luftës!

04.12.2018

Ngritja e Flamurit në kalanë e Gjirokastrës

E nderuara Kryetare e Bashkisë Gjirokastër,
Të nderuar deputetë dhe autoritete vendore,
Të nderuar pjesëmarrës,
Ndihem shumë i nderuar dhe i lumtur që së bashku ne kujtojmë dhe festojmë një nga momentet më të rëndësishme të historisë të këtij qyteti, Ngritjen e Flamurit të Pavarësisë.

Më 4 dhjetor 1912, flamuri kuqezi, do të valëvitet për herë të parë pas më shumë se 5 shekujsh mbi bedenat e kalasë shekullore, që ka parë se si ka luftuar me trimëri ky popull. Në këtë datë të shënuar flamuri ynë kombëtar u ngrit në mënyrë të bujshme dhe me ceremoni pasi vetëm një ditë më parë ushtritë e Perandorisë Osmane ishin larguar nga qyteti dhe një pushtues tjetër po pregatitej ti zinte vendin. Kjo ditë simbol për Gjirokastrën është ditë e

madhe e triumfit të lirisë, e qytetarisë gjirokastrite që na bënë shumë krenar dhe që do të kujtohet brez pas brezi.

Në memorjen e qytetarëve gjirokastritë, kjo ditë është dita kur rilindasit, patriotët dhe të gjithë banorët e qytetit të Gjirokastrës brohoritën një zëri Rroftë Liria, Rroftë Pavarësia e Shqipërisë.

Në këtë vend, 106 vite më parë u kurorëzuan dhe u manifestuan fuqishëm përpjekjet dhe lufta shekullore e patriotëve dhe gjithë popullit tonë lirirdashës, të cilët me aktin e tyre sublime, ngritën, pas gati 5 shekujsh robërie, flamurin kombëtar të Skënderbeut, flamurin më të bukur në botë me fushë të kuqe si gjaku dhe me Shkabën Dykrenore.

Pas Vlorës së Ismail Qemalit, që shpalli pavarësinë e Shqipërisë më 28 Nëntor 1912, ku 19 përfaqësues nga Gjirokastra morën pjesë në Kuvendin e Vlorës, dy prej të cilëve janë firmëtar të dokumentit të Pavarësisë, Elmaz Boci dhe Veli Harxhi, një grup patriotësh gjirokastritë me në krye Hasan Xhikun, më 4 dhjetor 1912,valëvitën Flamurin e Pavarësisë në këto bedena historike të kalasë shekullore dhe shpallën Gjirokastrën të pavarur bashkë me të gjitha trojet e Shqipërisë. Gjithashtu, ju ftoj të nderojmë edhe patriotin Baki Gjebrea, i njohur dhe me emrin Abdul Bakiu apo Baki Gjirokastra, atdhetari që ngriti flamurin e pavarësisë në qytetin e një mbi një dritareve në Berat, dhe për fatin e tij të keq u pushkatua më 1915 nga ata që ishin kundra shpalljes së pavarësisë dhe Ismail Qemalit, duke dhënë shpirt me thirrjet e fundit "Rroftë Shqipëria!". Të gjithë së bashku sot le të nderojmë atë plejadë patriotësh që nuk e kursyen jetën e tyre por e dhanë për të jetuar ne sot në ditë të paqta e të lira. Ne ju jemi mirënjohës sot e në shekuj dhe ti mësojmë brezat që do të na vijnë të respektojnë dhe të nderojnë këta trima.

Me këtët rast dëshiroj të uroj edhe 106 vjetorin e krijimit të Ushtrisë Kombëtare, ku qeveria e Ismail Qemalit e krijoi që në ditët e para të saj sepse shovinistët serb e grek ishin pranë kufirit për të mos e lejuar atë gëzim të madh që populli ynë të festonte Pavarësinë e shumë pritur.

Me shumë respekt dhe mirënjohje ju uroj gëzuar pavarësinë, gëzuar lirinë dhe jetofshim ditë dhe çaste akoma edhe më të bukura dhe të gëzueshme.

07.12.2018

50-vjetori i themelimit të Universitetit "Eqrem Çabej"

Kam nderin dhe kënaqësinë e veçantë që sot, në emër të Institucionit të Prefektit të Qarkut Gjirokastër, të përshëndes këtë event të rëndësishëm të 50-vjetorit të themelimit të Universitetit "Eqrem Çabej" në qytetin tonë të vjetër.

Së pari dëshiroj të theksoj që ky nuk është vetëm eventi juaj por një ditë e rëndësishme për mbarë rajonin tonë.

Gjirokastra, megjithëse një qytet i vogël si një qendër e rëndësishme administrative e Qarkut, ka mbartur dhe zhvilluar në vite vlera të mëdha arsimore e kulturore. Kontributi i universitetit si qendra më e rëndësishme arsimore e qarkut tonë është i çmuar. Në vite ky

institucion ka përgatitur kuadro të cilët kanë kontribuar në çdo fushë të zhvillimit të vendit si në arsim, ekonomi, turizëm, shëndetësi etj. Ky kontribut ka qënë jo vetëm për rajonin e jugut, por për gjithë Shqipërinë e madje sot shumë profesionistë të dalë nga ky universitet përfaqësojnë me dinjitet vlerat e këtij institucioni anembanë botës.

Ne si Institucion i Prefektit të Qarkut, garantojmë stafin drejtues, personelin akademik dhe studentët, se do të kenë gjithmonë përkrahjen, mbështetjen dhe bashkëpunimin tonë pasi e konsiderojmë universitetin një aktor të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik, social e kulturor jo vetëm të Rajonit të Jugut por të mbarë vendit.

Urime dhe suksese të mëtejshme në misionin tuaj fisnik të edukimit dhe kultivimit të vlerave për brezat e ardhshëm.

13.12.2018

Takimi për projektin "Bashki të Forta"

I nderuar zoti Zhak Merat, Menaxher i Projektit "Bashki të Forta",
Të nderuar Kryetar i Qarkut, Kryetarë të Bashkive, Kryetar dhe Sekretar të Këshillave Bashkiak,
Të nderuar pjesëmarrës,

Së pari do të doja të falenderoja Agjensinë Zvicerane për zhvillim dhe Bashkëpunim në Shqipëri, për mbështetjen në realizimin e projektit "Bashki të Forta".

Pas reformës administrativo – territoriale dhe procesit të decentralizimit të vitit 2014, që nënkupton menaxhim të territoreve më të mëdha dhe funksioneve të shtuara për bashkitë, ky projekt mbështet bashkitë për të rritur menaxhimin e orientuar drejt qytetarëve për përmirësimin e shërbimeve. Mbështetja teknike për administratat ndërthurret me mbështetjen për pjesëmarrjen dhe monitorimin nga lart-poshtë ndërmjet këshillave bashkiake. Projekti gjithashtu forcon kapacitetet e agjensive të decentralizuara në nivel qarku në mënyrë që ato të kontribuojnë në zbatimin e politikës së decentralizimit të qeverisjes vendore.

Institucioni i Prefektit të Qarkut në bazë të ligjit nr.107/2016, *"Për Prefektin e qarkut"*, ligjit nr.109/2015 *"Për Vetëqeverisjen Vendore"*, ligjit 115/2014 *"Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë"* duke u bazuar në parimin e konsultimit dhe bashkëpunimit bën koordinimin dhe monitorimin e njësive të vetëqeverisjes vendore dhe degëve territoriale që veprojnë në qark në zbatim të programit të Qeverisë. Institucioni i Prefektit do të mbështesë projektin "Bashki të Forta" për objektivat e mëposhtme:

1. Në menaxhimin e shërbimeve publike të organeve të njësive të vetëqeverisjes vendore duke vendosur objektiva performance kjo referuar standarteve kombëtare kur ato ekzistojnë.
2. Krijimin e hapësirave nga ana e njësive të vetëqeverisjes vendore për pjesëmarrjen e qytetarëve si konsultime publike, trajtim ankesash dhe zgjidhjen e tyre.

Menaxhimi i performancës dhe krijimi i hapësirave për pjesëmarrjen publike janë në thelb të politikave të vetëqeverisjes vendore dhe politikave decentralizuese. Institucioni i Prefektit do

të mbështesë nëpërmjet koordinatorit të këtij projekti të vendosur për qarkun Gjirokastër, në realizimin e objektivave të specifikuara në këtë projekt.

Ftoj kryetarët e bashkive dhe të organeve përfaqësuese të këshillave bashkiake për të mbështetur këtë projekt në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve të tyre ndaj qytetarëve.

26.12.2018

Takimi mbi masat e marra nga ana e Drejtorive Rajonale (degët territoriale) të qarkut për festat e fund vitit

Në kuadër të masave të marra për mbarëvajtjen e festave të fundvitit Prefekti i qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj ka mbledhur në një takim pune drejtues të degëve territoriale dhe institucioneve shtetërore në nivel vendor, ku përpos raportimeve të bëra nga ana e tyre, është përqëndruar vëmendja edhe për realizimin në mënyrë rigoroze të masave që duhet të marrë çdo institucion si më poshtë:

- Garantimi i rendit dhe sigurisë publike në të gjithë qarkun dhe sidomos në ambjentet e hapura ku do të zhvillohen festat (sheshet, rrugët etj.).
- Garantimi i sigurisë rrugore në akset rrugore kryesore Kakavijë-Memaliaj por edhe aksin Ura e Leklit - Tre Urat (Çarshovë).
- Garantimi i sigurisë në pikat doganore Kakavijë dhe Tre Urat për shkak të shtimit të fluksit të emigratëve të cilët vijnë për të festuar festat e fundvitit.
- Spitali Rajonal dhe të gjitha qendrat shëndetësore të rrisin masat dhe të jenë në gatishmëri të plotë me personel dhe mjete për të gjitha emergjencat e mundshme.
- AKU dhe inspektoriatet të ushtrojnë kontrolle periodike duke garantuar tregëtimin e ushqimeve por edhe zbatimin e ligjit në ambjentet si restorante, kafene apo parqe dhe vende të tjera të cilat mund të shfrytëzohen për kamping e që mund të shndërrohen në vatra zjarri.
- Sistemi Zjarrfikës të jetë në gadishmëri të plotë me personel dhe mjete; të ushtrojnë kontrolle për marrjen e masave dhe parandalimin e zjarreve apo fatkeqësive të tjera natyrore.
- Drejtoria OSHEE të marrë të gjitha masat për të patur në vazhdimësi energji elektrike deri në pikën më të largët të qarkut.
- Autoriteti Rrugor Jugor të mbajë kontakt me subjektet e mirëmbajtjes së rrugëve dhe të mos ketë bllokime në rast shkarje dherash apo emergjencave të tjera.
- Të gjitha degët territoriale ashtu si çdo vit, të jenë në shërbim të qytetarëve për të garantuar një shërbim të lartë dhe profesional ndaj qytetarëve gjatë festave të ndërrimit të vitit.

Dhjetor 2018

Intervistë televize e Prefektit të Qarkut Gjirokastër

Si e nis punën në zyrë Prefekti i qarkut, Z. Astrit Aliaj?

Më lejo së pari të të falenderoj për mundësinë që më jepni për të bashkëbiseduar, pasi pavarësisht fluksit të punës apo angazhimeve që shpeshherë na çojnë në rutinë, komunikimi me publikun nëpërmjet mediave mbetet mjaft i rëndësishëm. Në fund të fundit komuniteti ka interes dhe njëkohësisht të drejtën e plotë të dijë çfarë ndodh në institucionet vendore dhe për çështjet që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e tij. Në këtë kuadër, mediat, si të shkruara ashtu

edhe ato audiovizive i kam vlerësuar gjithmonë si partnerë mjaft të rëndësishëm dhe të tillë do të vazhdojnë të mbeten.
Për sa i përket pytjes tuaj, dua të sqaroj se për mua personalisht por edhe për institucionin që unë drejtoj, primare janë kërkesat dhe ankesat e qytetarëve, të cilët për të qënë i sinqertë me ju dhe publikun, në shumë raste shikoj që problemet e tyre kanë ngjashmëri me njera tjetrën dhe se shumë institucione të qarkut tonë nuk i kanë dhënë zgjidhje problemeve të tyre. Theksoj se problematikat më të mëdha kanë të bëjnë me verifikimin dhe vlerësimin e AMTP-ve, ku pa drejtësisht ju është cënuar prona e marrë me ligjin nr.7501(Institucioni i Prefektit të Qarkut gjatë vitit 2018 ka trajtuar 116 kërkesa për plotësim dokumentacioni, 85 kërkesa të prapambetura nga vitet e kaluara, është plotësuar dokumentacioni i nevojshëm për 166 dosje të familjeve të fshatit Bulo, ka bërë gati për vendime 326 dosje dhe ka nevojë për plotësim dokumentacioni 89 dosje. KVVTP ka marrë gjithsej 37 vendime nga të cilat dy vendime për konfirmim, 5 vendime për shfuqizim të pjesshëm dhe 30 vendime për shfuqizim të plotë të AMTP-ve. Përfitimi që do të ketë shteti nga marrja e këtyre vendimeve do të jetë një suipërfaqe toke bujqësore prej 249.512 m2),
probleme në hipotekim banese, ankesa për mos llogaritje të drejtë të pensionit, ankesa për derdhje të ujrave të zeza pranë banesave, prerje të linjës së furnizimit me ujë të pijshëm, për ndërtim të rrugëve publike, ndriçim apo heqje të mbeturinave si brenda në qytete por më e theksuar në fshat, ndërtim të stallave pranë banesave në fshat etj. Gjatë vitit 2018, rreth 70% e kërkes – ankesave janë adresoj Njësive të Vetqeverisjes Vendore, por me keqëardhje konstatoj se në shumë nga këto raste përgjigja vonohet, ose në rastin më të keq nuk zgjidhet.
Në disa raste specifike, Prefekti i qarkut ka ngritur grup pune dhe ka shkuar në vend për verifikimin e problematikave në ballafaqim me drejtues të institucioneve shtetërore dhe njëisve të vetëqeverisjes vendore. Kjo është një nga sfidat e mia, që qytetari është i pari dhe nuk do të pushoj së kërkuari rrugët e zgjidhjes.

Bashkëpunimi i prefektit të qarkut me degët territoriale dhe organet e Njësive të vetqeverisjes vendore

Mendoj që ky bashkëpunim ka ardhur në rritje nga momenti që unë kam marrë detyrën dhe deri më tani. Kjo është llogjike se ka të bëjë me njohje direkt me drejtuesit, por më e rëndësishme është të theksoj se takimet dhe marrja pjesë në shumë aktivitete që kanë zhvilluar si degët territoriale ashtu edhe organet e vetqeverisjes vendore kanë bërë të rritet fryma e mirëkuptimit dhe respektit reciprok të institucioneve tonë.
Në këtë kuadër, prefekti i qarkut ka ushtruar veprimtarin e tij në verifikimin e ligjështmërisë të akteve të Njësive Vendore të depozituara pranë institucionit tonë. Prefekti i qarkut ka qënë maksimalisht i angazhuar por njëkohësisht ka ndjekur me shumë vemendje aktet e këshillave bashkiak që kanë të bënë me ndihmën ekonomike, paaftësin e kufizuar, kompensimin e energjisë të familjeve në nevojë si dhe akte që kanë të bëjnë me planifikimin e fondeve për trajtimin e rasteve të emergjencave civile.
Për sa i përket degëve territoriale, prefekti i qarkut ka zhvilluar takime me drejtues të këtyre instituacioneve në vazhdimësi duke lënë detyra dhe rekomandime konkrete për përmirësimin e punës në drejtim të zgjidhjeve të kërkesave që shqetësojnë komunitetin.

Si funksionon Organi Këshillues i Prefektit, Task Forcat Vendore dhe Komitetet Rajonale në shërbim të komunitetit. Cilat kanë qënë rezultatet dhe problematikat?

Në zbatim të ligjit Nr.107/2016 " Për Prefektin ", të akteve të tjera ligjore dhe të akteve normative të Këshillit të Ministrave, pranë institucionit të Prefektit të Qarkut janë ngritur dhe

funksionojnë nën drejtimin e Prefektit të qarkut Organi Këshillues i Prefektit, Task–Forca në nivel vendor për problematika të ndryshme, veçanërisht këto në shërbim të komunitetit.
Është përcaktuar tematika vjetore e mbledhjeve të Organit Këshillues të Prefektit dhe deri tani janë realizuar takimet mujore të planifikuara sipas tematikave.
Në zbatim të ligjit 107/2016 " Për prefektin e qarkut ", urdhërave të Kryeministrit dhe urhërave të Ministrit të Brendhshëm janë ngritur dhe kanë funksionuar Task Forca dhe Komitete në nivel vendor si:
- Task-Forca në nivel vendor mbështetur në Aktin Normativ të KM nr. 4, datë 16.08.2012 "Për përcaktimin e rregullave për therjen e kafshëve dhe tregëtimin e mishit të tyre".
- Task- Forca Rajonale për marrjen e masave parandaluese në përballimin e emergjencave për zjarret në pyje dhe kullota gjatë stinës së verës (qershor – gusht 2018) .
- Task - Forca vendore e Luftës Kundër Kultivimit dhe trafikimit të Kanabisit.
- Task-Forca në nivel qarku për marrjen e masave të ndërhyrjes emergjente ndaj subjekteve që gjenerojnë zhurmë tej normave të lejuara.
- Komiteti Rajonal i Luftës kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore për qarkun e Gjirokastrës.
- Komiteti Rajonal i Zhvillimit të Turizmit.
- Komiteti Rajonal i Zonave të Mbrojtura.
Prefekti i qarkut, në rolin e kryetarit të këtyre Task Forcave dhe Komiteteve Rajonale, ka gjetur bashkëpunim në nivele maksimale nga të gjithë antarët e këtyre task forcave, që në të shumtën e rasteve janë drejtues të institucioneve, por edhe kryetar të bashkive. Falë këtij bashkëpunimi këto Task Forca kanë funksionuar dhe vazhdojnë të funsionojnë shumë mirë. Ndaj më lejoni t'i falenderoj sërish të gjithë anëtarët për angazhimin dhe gatishmërinë e shprehur. Shpresoj që ky bashkëpunim jo vetëm të vazhdojë, por edhe të shtohet, pasi të gjithë së bashku kemi vetëm një synim: krijimin e një klime të sigurtë në rang qarku, duke parandaluar dhe luftuar ndaj çdo fenomeni të kundërligjshëm dhe ofrimin e shërbimeve cilësore si ndaj komunitetit por edhe ndaj vizitorëve vendas dhe të huaj.
Gjithashtu kemi ndjekur me vëmendje të veçantë disa reforma që qeveria shqiptare ka ndërmarë gjatë këtij viti dhe konkretisht:
Reforma e ujit të pijshëm.
Ngritja e grupit te monitorimit për ecurinë e aksionit të ujit të pijshëm në qarkun e Gjirokastrës.
Roli i Prefektit të qarkut në ndjekjen dhe raportimin javor të rezultateve të këtij aksioni pranë zyrës operacionale të Kryeministrit.
Reforma e ndihmës ekonomike
Aplikimi i skemës së re të ndihmës ekonomike.
Monitorimi i rasteve në terren në çdo bashki.
Sqarimi i personave të dalë jashtë skemës për mënyrën e aplikimit.
Aplikimi i kësaj skeme ka sjellë rritjen e numrit të punësuarëve në biznset private nëpërmjet drejtorisë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.
Gjatë këtij viti, prefekti i qarkut në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Turizmit, ka drejtuar aksione pastrimi në kuadër të Javës së Tokës dhe në prag të çeljes së sezonit turistik, për pastrimin e territoreve dhe brigjeve të lumenjve, të cilat kanë dhënë impact të drejtëpërdrejt në zhvillimin e turizmit në rajonin tonë.

Si kanë qënë masat e marra nga prefektura "Për emergjencat civile" në rang qarku (dimërore dhe verore)

Bazuar në ligjin nr. 107/2016, *"Për Prefektin e Qarkut"*, ligjin nr. 8576, datë 26.03.2001 *"Për Emergjencat Civile",i ndryshuar,* dhe VKM-se Nr. 655, datë 18.12.2003 "Për ngritjen dhe funksionimin e strukturës së sistemit kombëtar të Planifikimit dhe Përballimit të

Emergjencave Civile", në institucionin e Prefektit është ngritur dhe ka funksionuar Komisioni i Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave në nivel qarku.
Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastër në periudhën janar – dhjetor 2018 ka ndjekur dhe monitoruar të gjitha situatat emergjente të krijuara në qarkun tonë si rezultat i kushteve të vështira atmosferike të krijuara në përiudhën dimërore nentor 2017 – shkurt 2018.
Gjatë kësaj periudhe, institucioni i Prefektit të qarkut ka monitoruar situatat e krijuara si pasojë e rreshjeve në të gjithë qarkun e Gjirokastrës, në dëmtimin e ujsjellësave, rrugëve nacionale dhe rurale, banesa, përmbytje tokash bujqësore etj, dhe ka marrë drejtimin në disa situate tejet të vështira.
Situatat më të vështira kanë qënë ato të krijuara:
Në bashkinë Gjirokastër ku mund të përmendim rrëshqitjen ne Kodrën e Shtufit, rrëshqitjen në lagjen Punëtori dhe në lagjen Cfakë si dhe dalja nga shtrati i Përroit të Çullos.
Në bashkinë Dropull dëmtimi i pesë urave që lidhin fshatrat e njësisë administrative Dropull i Sipërm. Për ti ardhur në ndihmë popullatës, me angazhimin e institucionit të prefektit të qarkut u ndërtua një urë BEJL në Dropullin e Sipërm nga forcat xheniere të Ministrisë së Mbrojtjes.
Gjithashtu, forcat xheniere të Ministrisë së Mbrojtjes kanë bërë të mundur asgjesimin e një masivi shkembor mbi qytetin e Përmetit, i cili rrezikonte disa banesa në një lagje të qytetit.
Lidhur me këto situate dhe sidomos me situatën e pallatit te Kodra e Shtufit, Prefekti i Qarkut Gjirokastër ka zhvilluar një sërë takimesh me përfaqësues të Kryeministrisë, Ministrisë së Brendshme, të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, të Ministrisë së Mbrojtjes, të bashkisë Gjirokastër dhe të drejtorive rajonale për situatën e krijuar ku janë shqyrtuar dhe vlerësuar situatat hap pas hapi, raportet gjeologjike të hartuara nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar dhe marrja e masave përkatëse.
Mbas shumë pune dhe përpjekje u arrit të sigurohet fond i investimit total nga qeveria shqiptare në shumën rreth 85 milion lekë dhe sot jemi në momentin e implementimit të projektit dhe përfundimit të punimeve duke i kthyer zonës shërbimet e munguara si dhe banorëve siguri në banesat e tyre. Aktualisht është realizuar në masën 70% të projektit dhe shpresojmë që punimet pë reabilitimin e saj të përfundojë Brenda muajit janar 2019.
Prefekti i Qarkut gjatë vitit 2018 ka organizuar disa takime pune me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Drejtorisë së Rajonit Rrugor, firmave kontraktuale të mirëmbajtjes së rrugëve për:
- Dëmtimin e rrugëve nacionale dhe marrjen e masave për rehabilitimin e tyre.
- Masat e marra për rritjen e sigurisë rrugore për sezoniin turistik si dhe evidentimin e segmenteve rrugore problematike në mënyrë që nga këta drejtues të hartonin një studim të detajuar për përmirësimin e infrastrukturës rrugore në akset nacionale.
Në këto takime është diskutuar për planet e hartuara, për rehabilitimin e segmenteve rrugore më problematike, rikonstruksioni i pikave me risk dhe për masat e nevojshme parandaluese në aksidentet rrugore si plotësimi i sinjalistikës horizontale e vertikale etj.
Si rezultat i këtyre takimeve, kërkesës nga ana e institucionit tonë drejtuar ARRSH-së për ndërhyrje emergjente në prag të sezonit turistik dhe impenjimit veçantë të Prefektit të qarkut me strukturat shtetërore në nivel vendor, po bëhet e mundur që nga ARRSH-ja të vihen në efiçencë segmentet e çeduara (ulje e trupit të rrugës) në rrugën nacionale në zonën e Qesaratit – Memaliaj, rikonstruksioni i segmentit dhe i urës në zonën e Kordhocës në prroin e Gjorkanës në dalje të qytetit të Gjirokastrës, vënia në efiçencë e ndriçimit në segmentin rrugor Postbllok – Varrezat e Dëshmorëve në qytetin e Gjirokastrës dhe rehabilitimi i shkarrjes masive në rrugën nacionale Jorgucat – Qafa e Muzinës me mur mbajtës etj. Ka filluar puna për rehabilitimin e murit mbrojtës të liqenit të Viroit në segmentin rrugor Gjirokastër - Tepelenë.

Lidhur me situatën e zjarreve gjatë stinës së verës, institucioni i prefektit të qarkut Gjirokastër në bashkëpunim me NJVV dhe institucionet shtetërore vendore ka marrë të gjitha masat organizative por dhe me kontrolle në të gjithë territorin e qarkut dhe për pasojë situata ka qënë në normalitet dhe nuk kemi patur ngjarje me pasoja si për jetën ashtu edhe për bizneset. Me kët rast do të doja të falenderoja të gjitha mediate që janë bërë pjesë e sensibilizimit të komunitetit për parandalimin dhe informimin në kohë të cdo rasti të mundshëm.

Prioriteteti kryesor i punës së Institucionit të Prefektit të Qarkut Gjirokastër

Edhe pse fokusi i Institucionit të Prefektit, sikurse theksova më lart është zbatimi i ligjshmërisë, natyrisht që nuk do të mbetemi vetëm këtu. Edhe gjatë këtij viti, të gjitha strukturat që drejtohen nga prefekti i qarkut do të vazhdojnë funksionimin e tyre për plotësimin e të gjitha detyrimeve. Prioriteteti kryesor i punës së Institucionit të Prefektit të Qarkut Gjirokastër është ngritja në një shkallë më të lartë e frymës së bashkëpunimit, bashkërendimit dhe koordinimit të organeve të qeverisjes vendore, degëve territoriale që veprojnë në qark dhe institucione të tjera, drejtimin e strukturave për parandalimin, menaxhimin, rehabilitimin e pasojave në rastet e emergjencave civile, drejtimin e task forcave, kontrollin dhe monitorimin e zbatimit në nivel qarku të politikave sektoriale të Këshillit të Ministrave në bujqësi, arsim, shëndetësi, mjedis, rend publik, shërbim zjarrfikës, ndihmë dhe përkrahje sociale, turizëm dhe kulturë.
Së bashku me stafin me të cilin punoj jemi të angazhuar dhe të gatshëm që institucioni i Prefektit të qarkut Gjirokastër të ngrihet në nivelet e institucioneve homologe europiane. Gjithashtu më duhet të theksoj se institucioni i Prefektit të qarkut do të jetë derë e hapur për çdo qytetar të qarkut tonë, panvarësisht se nuk mund t'i zgjidhim drejpërdrejtë problemet e tyre.
Në bashkëpunim të ngushtë me qeverinë shqiptare do të luftojmë të sjellim investime të shumta në mirëmbajtjen e monumenteve të kulturës, në infrastrukturë, në zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm, në rritjen e aktiviteteve kulturore duke ruajtur traditat e çdo krahine si në veshje tradicionale sipas krahinave, kulinarisë deri tek objektet e sekteve fetare, e tj.
Do të jemi promotorë të sjelljes dhe zbatimit të sa më shumë projekteve që financohen nga donatorë të huaj dhe kryesisht nga Bashkimi Europian, si një nga rrugët për të sjellë zhvillimin e rajonit tonë në shumë fusha.

Me këtë rast duke qënë se së bashku kemi kaluar një vit jo të lehtë, të mbushur me sfida, me reforma të ndërmarra nga ana e qeverisë shqiptare, me arritje dhe rezultate të mira por edhe me sfida të reja që na presin përpara, dëshiroj të shpreh urimet më të mira për të gjithë komunitetin e qarkut Gjirokastër për një vit të ri plot shëndet begati dhe prosperitet.
Gëzuar Vitin e Ri 2019!